

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT I
SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 16, 17 DHE 20.11.2006

TRANSKRIPT
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 16, 17 I 20.11.2006. godine

NËNTOR – NOVEMBAR 2006

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 19 e 20 tetor, më 27 tetor dhe të seancës plenare më 3 nëntor 2006,
3. Koha për pyetjet e deputetëve,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për auditimin e brendshëm,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shndërrimin e poseduesve të paluajtshmërive private në pronar,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për noterinë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punë,
8. Shqyrtimi i Raportit për punën e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2005,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me listën e kandidatëve të propozuar për pozitën e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij,
10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për shëndetësi dhe
11. Shqyrtimi i propozimvendimit për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda;
2. Usvajanje zapisnika sa plenarnih sednica, održanih dana 19, 20, 27 oktobra i plenarne sednice od 3 novembra 2006. godine;
3. Vreme za poslanička pitanja;
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o unutrašnjoj reviziji;
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o preinačavanju posedovatelja privatnih nekretnina u vlasnike;
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o notarstvu;
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o radu;
8. Razmatranje Izveštaja o radu Regulatorne agencije o telekomunikacijama za 2005. godinu;
9. Razmatranje Izveštaja Komisije za sudska pitanja, zakonodavstvo i Ustavni okvir, u vezi liste predloženih kandidata za položaj Narodnog advokata i njegovog glavnog zamenika;
10. Razmatranje Izveštaja Komisije za zdravstvo u vezi monitoringa o primenjivanju Zakona o zdravstvu;
11. Razmatranje Predlog odluke o odobravanju službenih putovanja van zemlje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Të nderuar deputetë, i nderuari kryeministër dhe ministra, të nderuar ministra të kabinetit qeveritar. Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 88 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar me punë, andaj propozoj të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Në pajtim me rregullat 6 dhe 23 të Rregullores së punës Kryesia e Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme plenare sipas ftesës që u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Meqë Kryesia nuk ka marrë ndonjë propozim tjetër me shkrim për plotësimin e rendit të ditës atëherë në pajtim me rregullën re 23.2 konstatojë se rendi i ditës është miratuar.

Deputeti Gjergj Dedaj e ka fjalën. Koha është vetëm 2 minuta për rendin e ditës.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit shumë z. kryetar, i nderuar z. kryeministër, ministra, duhet pak më folë shpejt se vetëm dy minuta i kam, nëse e zgjat pak besoj se ma falin edhe një minutë.

Vetëm desha të ceku, se në kohën kur Serbia bëri agresion kushtetues dhe e paraqiti Kosovën si çështje të brendshme integrale të saj ky Kuvend debatoi atëherë për peshkatarinë, për peshqit, tash në kohën kur po shtyhet statusi politik i Kosovës pa një debat, pa marrë asnjë shqetësim të deputetëve të këtij Kuvendi ne normalisht që e parashohim të bisedojmë edhe për bletë një ditë do të bisedojmë edhe për insektet. Unë konsideroj se kjo është një shkelje flagrante e vullnetit të qytetarëve të Kosovës, prandaj në këtë seancë kërkoj të futet ad – hoc çështja e një debati të deputetëve të Kuvendit të Kosovës për të debatuar për shtyrjen e statusit politik të Kosovës, sepse na është premtuar më shumë se një mijë herë se nuk do të ketë shtyrje të statusit dhe se brenda vitit 2006 do të njihet vullneti politik i popullit të Kosovës për vetëvendosje dhe pavarësi.

Konsideroj se Ekipi Negociator duhet ta shpallë të përfunduar mandatin e tij për shkak të mospërbushjes së premtimit që e ka dhënë para Kuvendit i cili e ka mandatuar këtë ekip edhe pse jo d.m.th. të gjitha kompetencat t'i kalojnë Kuvendit të Kosovës, i cili është gjithëpërfaqësues. Përbëhet nga 17 subjekte të partive të ndryshme dhe të bashkësive të ndryshme etnike. Unë konsideroj se ky ekip nuk ka më as besim, as legjitimitet, as mandat të bisedojë më as për statusin, as për Kushtetutën, as për ligjin për zgjedhjet.

Domethënë Grupi Parlamentar për Integrim kërkon që ose sot të futet në rend të ditës , ose të caktohet një seancë e veçantë ku do të shprehen shqetësimet e deputetëve të grupeve parlamentare për shtyrjen e statusit dhe pse jo të shpallet përfundimi i mandatit të Ekipit Negociator të Kosovës. Ju faleminderit shumë z. kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Për një kërkesë të tillë duhet të bëhet propozimi me shkrim .Z. deputet e parashtroi kërkesën me shkrim dhe procedohet më tutje. Fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar deputetë.

Unë dalë sot me dy kërkesa që ky Parlament mendoj se në të ardhmen, jo sot, duhet t'i debatohet dhe mendoj që janë në interes për Kosovën dhe për proceset që po i kalojmë.

1. Kohë më parë Bashkimi Evropian ka kërkuar që vendet që kanë kaluar nga sistemi komunist në sistemin e ri t'i dënojnë krimet e sistemit totalitar. Mendojmë ne si parlament duhet të autorizojmë Komisionin për Çështje Juridike, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese që ta hartojë një dokument përkatës me anë të cilit ky parlament

dhe Kosova dënon ato krime. Ne duhet ta bëjmë këtë për shumë arsye, por edhe për faktin se ky sistem në Kosovë ka zgjatur nga viti 1945 deri në vitin 1999.

Unë nuk dua t'i përsëris të gjitha krimet që janë bërë gjatë kësaj periudhe, por institucionet e Kosovës kanë për obligim që në një mënyrë t'i shpërblejnë, ta japin një shpërblim moral për të gjithë ata njerëz, për ato familje që kanë pësuar nga krimet e sistemit totalitar nga viti 1945 deri më sot. Mendoj që kësaj do duhej t'i bashkëngjiten edhe institucionet e Kosovës edhe Parlamenti i Kosovës, dhe

2. Një kërkesë ,megjithatë, duhet të jetë në rend të ditës në mbledhjet e ardhshme, është raporti i Komisionit Evropian, sidomos ajo pjesa që bënë fjalë për Kosovën. Ky raport duhet të përkthehet, dhe t'u dërgohet deputetëve ,por edhe të zhvillohet një debat për këtë çështje,ngase mendojmë se janë çështje shumë të rëndësishme.

Sa i përket çështjes që ngriti më parë parafolësi, mendoj që ne duhet të kërkojmë nga Grupi Negociator që t'i prezantojë të gjitha angazhimet e tij deri më tani dhe mbi bazën e atij prezantimi që do të bëhet në Parlamentin e Kosovës, të zhvillohet edhe një debat. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, sipas rregullës 6, pika 5 dhe 32 të Rregullores së punës parashtrerasat ose propozimet bëhen me shkrim dhe procedohen. Zotëri ministër urdhëroni, Salihu,

MINISTRI JONUZ SALIHU – I nderuari kryetar i Parlamentit, kryeministër, ministra ,të nderuar deputetë.

Unë e kam një kërkesë shumë të thjeshtë për një zhvendosje të pikave të rendit të ditës pika e 6-të është: Projektligji për noterinë, dhe kisha kërkuar që kjo të jetë pika e katërt, menjëherë pas pyetjeve të deputetëve. Për arsyes se kam udhëtimi zyrtar për në Tiranë, për të marrë pjesë në një forum shumë të rëndësishëm, forumi i ministrave të Ballkanit Perëndimor - të rendit dhe të drejtësisë.

Kështu që është vetëm zhvendosja e pikave do të ishte një mundësi ma e madhe që të udhëtoj pak ma lehtë, më shpejtë të arrijë në Tiranë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - A mund të aprovohet kërkesa e Ministrit, një aprovim formal. Ju faleminderit. Kundër nuk ka. Ju faleminderit. Deputeti Xhevat Bislimi e ka fjalën.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryetar, zotërinë deputetë, unë propozoj që pikë e përhershme e rendit të ditës të jetë çështja e furnizimit të qytetarëve me energji elektrike dhe ministri i Energjetikës të raportojë në çdo mbledhje se çfarë po bënë për përmirësimin e gjendjes së rëndë energjetike. Pas standardit të parë- shpalljes së shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës dhe ndërtimin e këtij shteti ,standardi i dytë jetik për funksionimin normal të këtij vendi është energjia, prandaj unë konsideroj se KEK-u , Ministria dhe Qeveria po e shkatërrojnë shëndetin mental, shëndetin shpirtëror dhe fizik të qytetarit dhe të popullit të Kosovës, prandaj urgjentisht unë kërkoj që kjo të jetë pikë e

përhershme derisa të zgjidhet ky problem, me të cilin bota ka filluar ta kushtëzojë edhe pavarësinë e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Vlen e njëjta rregull që do të paraqitet me shkrim. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 19 e 20 tetor, më 27 tetor dhe të seancës plenare më 3 nëntor 2006

Procesverbalet e seancave plenare të datave 19,20 dhe 27 tetor dhe të seancës së datës 3. nëntor 2006 u janë shpërndarë të gjithë deputetëve. Lus deputetët që vërejtjet eventuale t'i paraqesin gojarisht ose ato t'ia adresojnë me shkrim Zyrës për Propozime dhe Parashtrës, sekretarisë së Kuvendit, me qëllim që të inkorporohen...A ka kush vërejtje në procesverbal?, Konstatohet se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të datave 19, 20 dhe 27 tetor dhe të seancës së 3 nëntorit të vitit 2006.

Kaloi në pikën e tretë të rendit të ditës

3. Koha për pyetje të deputetëve

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26 pika 1 të Rregullores së punës së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta gjithsej, në afatet e përcaktuara me Rregulloren janë parashtruar 6 pyetje parlamentare. Pyetjet i janë dërguar Qeverisë dhe u janë shpërndarë të gjithë deputetëve. Ju njoftoj gjithashtu se koha për pyetje zgjat një minutë, përgjigjja e ministrit 3 minuta, pyetja plotësuese 1 minutë dhe përgjigjja plotësuese 2 minuta.

Pyetja e parë është pyetja e deputetit Nait Hasani që i drejtohet ministrit Astrit Haraqija, i cili nuk është prezent, zëvendësi, urdhëroni. z. Hasani e kërkonte fjalën.

DEPUTETI NAIT HASANI – I nderuar kryeministër, i nderuar kryetar, unë kam bërë pyetje parlamentare për ministrin Astrit Haraqija duke pasur parasysh rrethanat politike në të cilat është Prizreni dhe mua më ka interesuar çështja e fundit që është bërë për ndërtimin dhe rindërtimin e objekteve të shkatërruara në rastin e Prizrenit. Mua më intereson renovimi i Kishës së Shen Gjergjit në Prizren, ngase financimi për renovimin kishës së Shen Gjergjit, (Sveti Savës,) gjatë renovimit është bërë zbulimi i një morie varrezash të lashta ilire dhe u ndalua punës për ndriçimin e këtyre varrezave nga ana e prokurorisë ndërkombëtare. Pyetja është:

A keni dijeni për masat e mara nga ana e prokurorisë ndërkombëtare që të ndalohet puna e mëtejshme dhe kush ka dhënë urdhëresë për këtë ndalim?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, nuk është ministri dhe në vend ministrit vjen zëvendësja e ministrit, zonjusha Krasniqi.

ZËVENDËSEMINISTERJA ANGJELINA KRASNIQI – I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, meqenëse ministri Haraqija gjendet në Paris, më lejoni që t'i përgjigjem pyetjes së deputetit.

I nderuari z. deputet Hasani, Ministria e Kulturës është në dijeni të plotë për pyetjen tuaj që e keni bërë dhe ka bërë hapa konkretë , ka marrë masa konkrete lidhur me rastin e gjetjes se eshtrave në Kishën e Shën Gjergjit në Prizren. Menjëherë ne kemi konstatuar që është e vërtetë se është bërë gjetja e eshtrave, ne kemi ndërprerë punimet në këtë kishë deri në një kohë dhe në një periudhë të caktuar gjersa ekspertët e kanë thënë fjalën dhe mendimin e vet. Ekspertët kanë bërë incizimin e gjendjes reale, kanë marrë disa pjesë të këtyre eshtrave të cilat i kemi dërguar në laboratorët për të bërë eksperimentet në vazhdim. Pastaj kemi marrë përgjigjeje nga ekspertët përgjegjës, të cilat mund t'i ofrojmë . Në to është konstatuar dhe është konstatim shumë i saktë që këta eshtra nuk kanë të bëjnë fare me varrezat Ilire. Arsyeja e parë është që eshtrat janë gjendje shumë të mirë, dhe bëhet fjalë për varrezat ilire janë shumë të vjetër. Këto eshtra u takojnë përfaqësuesve klerikë ortodoks, të cilët sipas traditave të tyre i varrosin klerikët brenda objektit të kishës.,kurse bëtet fjalë për tri varreza brenda objektit, dy që i takojnë klerikëve,kurse dhe një është në pjesën e jashtme të objektit.

Çka do të thotë që, edhe një herë po e potencojë që Kisha i takon periudhës së re, nuk i takon periudhës së vjetër është një kishë që i takon periudhës së shekullit 19. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit z. Hasani a keni diçka pyetje. Urdhëroni.

DEPUTETI NAIT HASANI – Vetëm desha ta falënderoj zëvendës- ministren për njoftimet që nuk i ka të sakta. Unë do të them që eksperti në fjalë çfarë ka thënë eksperti Kemajl Luci arkitekt, ka vlerësuar se po bëhet një krim ndaj trashëgimisë kulturore e historike të Kosovës. Sipas tij për fat të keq në raste të tilla kanë ngjarë edhe gjatë vitit e fundit në Kosovë, edhe në rastin e Kishës së Shën Gjergjit. Ndërsa Kisha e Shën Gjergjit që thotë ministresha, është ndërtuar mbi varrezat e vjetra të qytetit të Prizrenit. A është kjo e saktë?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit. A keni përgjigje tjetër? Nuk ka. Pyetja e dytë, deputeti Rifat Krasniq i drejtohet me një pyetje ministrit Qemajl Ahmeti.

DEPUTETI RIFAT KRASNIQI - Ju faleminderit z. kryetar, Kosova Yönetmeliği'nin 26. maddesinin hükümü ve 2. noktasıyla uyumlu olarak, yukarıda adı geçen Bakanlığa, daha doğrusu Bakan Çemal Ahmeti'ye bir soru yöneltip, Meclis'in ilerideki toplantısında sözlü olarak yanıt vermesini arz ediyorum.
SORU:

Sayın Bakan Çemal Ahmeti'ye bir soru yöneltmek istiyorum. Pirana-Mamuşa yolunun onarılması doğrultusunda herhangi bir etkinlik yapıldı mı? Yapılmadıysa bunun nedeni nedir?

AÇIKLAMA:

Sayın Ulaşım ve Telekomünikasyon Bakanı Çemal Ahmeti Biliğiniz gibi 21.03.2006 tarihinde Mamuşa'da 7 civar belediye başkanı ile bir toplantı düzenlenmişti. Bu toplantıda Kosova'nın genel kalkınması için büyük önem taşıyan

Mamuşa-Pirane yolunun inşaatı ile ilgili proje görüşülmüştü. Katılımcılar, diğerleri arasında, Kosova'nın büyük gereksinime duyduğu tarımcılıkla uğraşan yöreleri bağladığı için sözkonusu yolun hayati önem taşıdığını vurguladılar. Bu toplantıya Siz de katılmıştınız.

Dolayısıyla Siz, bu yıl içinde, gereken araçların olmamasından dolayı, Mamuşa-Pirane yolunun bu yıl içerisinde sadece tamir edileceğini, gelecek 2007 yıla ait Kosova'nın genel bütçesi ile söz konusu plana göre tamamıyla inşaatının kapsanacağını ve finansi araçların sağlanacağına dair ifadelerde bulunmuşunuz.

Bildiğiniz gibi o zamandan bu yana altı ay geçti ve bu konuda ileriye doğru bir adım bile atılmadı. Bu arada ise ben ve Siz birkaç defa bu konuda görüşmek üzere bir araya geldik ve siz her zaman iyimser olduğunuzu vurguladınız. Sayın Bakan, ben Türk topluluğunu bir milletvekili olarak 26 bin nüfusun soruları ve şikayetleri ile karşılaşmaktayım. Onlara gerçekten en doğru cevap vermek durumundayım. Çünkü onlar işlerini doğrudürüst yapmak için bu yol onlar son derece önemlidir.

Sayın Petersen'den başlayarak Dünya Bankası temsilciliği yetkilerine kadar bütün mercilerdeki yüksek görevliler bu yolun önemini bilmelerine rağmen biz hala beklemekteyiz. Mamuşa-Pirane yolu, Mamuşa pilot projesinin tam anlamıyla hayata geçirilmesi ve Kosova'nın genel çıkarına olan yeni projelerin hayat bulması için önemini bir daha vurgulamak isterim

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, z. ministër urdhëroni.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuar ministër, ministra, të nderuar deputetë, të nderuar edhe Grupi 6+ që e ka bërë këtë pyetje. Janë marrë veprimet lidhur me këtë. Kemi bërë parallogaritë dhe shumë shpejtë do të rinovohet kjo rrugë, pse nuk është rinovuar normalisht se është rrugë rajonale dhe do përparësi të renovimit të rrugës magjistrale, ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, keni diçka për të plotësuar. Zoti Krasniqi keni diçka për të thënë, urdhëroni

DEPUTETI RIFAT KRASNIQI – Ju faleminderit z. kryetar. Ju faleminderit z. ministër, vetëm dua të di për punimet që jemi në zor, është ai pilot projekti dhe krejt ata 26000 banorë vijnë në komunë edhe lypin atë rrugë. Besoni se edhe unë disa here me KFORI-n turk kam pruar disa here makinat dhe është rinovuar, ashtu që problemi këtë javë edhe z. Rykeri ka ardhur aty dhe është befasuar, rruga ju lutem z. ministër sivjet të rinovohet se nuk ka rrugëdalje tjetër Besoj që do të dalë edhe unë në Prishtinë me jetuar se nuk kam vend edhe aty më. Ju faleminderit z. kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, a keni përgjigjeje më, urdhëroni z. Ministër.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Unë shumë i shqetë isha, do të thotë kemi bërë parallogaritë. Unë nuk desha të ndalem në detaje sa kushton ai renovim por në këtë vit do të bëhet, vetëm dashtë zoti mos të bjerë borë sonte,

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, deputeti Kamber Kamberi ka pyetje për ministrin e Shëndetësisë Sadik Idriz.

DEPUTETI KAMBER KAMBERI – Ju faleminderit z. kryetar, pyetja ime është: meqenëse një numër i madh i banorëve shtetas të Republikës së Shqipërisë, sidomos nga rrethet Tropojë, Has, dhe Kukës për nevoja shëndetësore, për shkaqe të largësisë me Tiranën, janë të detyruar të trajtohen në spitale e Kosovës, sidomos në ato të Gjakovës, Prizrenit, por edhe të Prishtinës, dhe gjithashtu edhe pacientë të Kosovës në klinikat e Tiranës. A ekziston marrëveshje ndërministrore për një trajtim dhe participim të njëjtë të pacientëve të të dyja anëve, nëse jo, a parashihni arritje të marrëveshjes së ndërsjellë për këtë çështje.

MINISTRI SADIK IDRIZI – Poštovani g. Kamberi, angazhovanje Ministarstva zdravlja na ostvarivanju saradnje sa ministastvima iz regiona stalni je zadatak i cilj kako bi se stvorile olakšice za naše paciente, ali i za paciente iz drugih zemalja koji koriste zdravstvene usluge naše institucije. Na ovom planu sa ministarstvom zdravlja Albanije je potpisan memorandum o saradnji još u maju 2001. godine, sličan sporazum je ponovljen u aprilu 2004. godine, preko ovog sporazuma je omogućeno našem građanima kao i građanima Albanije da koriste zdravstvene usluge pod jednakim uslovima, zapravo imaju podjednak tretman imaju besplatno usluge, zamenik ministra zdravlja uz moju saglasnost je započeo direktne kontakte sa ministrijem Cikuljem i uskoro tokom nedelje naredne sednice realiziraće sastanak na kojem očekujemo potpisivanje novog sporazuma produžavanje sporazuma između naših ministarstava u oblastima zdravstvene zaštite. Takođe, zamenik ministra je započeo kontakte sa direktorom direktorata javnog zdravlja u Tropoji, doktorom Ramizem Krenajem, kojim prilikom je diskutovano o mogućnostima direktne saradnje naših bolnicama regionalne bolnice sa onom u Bajram Curiju, dok se konkretizacija saradnje očekuje nakon produžavanja memoranduma o saradnjima na nivou ministarstava. Slične ciljeve interese saradnje imamo i sa lokalnih zdravstvenih institucija u Prizrenu, Dragašu sa onima iz Kuksa i njegove okoline. Zbog toga imamo kontakte sa kompetentnima autoritetima zdravlja u Kuksu na dobrom smo putu proširenje i konkretizacije saradnje kako bi omogućili što kvalitetnije zdravstvene usluge sa obe strane granice. Tokom naredne sendice zamenik ministra Kryeziu boraviće u Tirani gde će razgovarati sa ministrijem Cikuljem, dok će nakon toga uskoro ministra zdravlja u Vladi Albanije g. Maksim Cikulji posetiti Kosovo gde ćemo potpisati nastavak sporazuma o saradnji. Takođe, imamo mogućnosti za zapošljavanje našeg radnika u Albaniji za to što imamo deficitan kadar i u Kuksu i u Bajram Curiju, a mi imamo lekara koji bi radili to je još jedna mogućnost. Hvala

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit ka për të plotësuar dikush, nuk ka . Deputeti Genc Gorani ka pyetje për ministrin e Financave dhe të Ekonomisë Haki Shatrin, por ministri nuk është këtu, dhe kjo pyetje përcillet për seancën e ardhshme. Urdhëroni zëvendës ministër.

DEPUTETI GENC GORANI – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari z. kryetar, kryeministër, zonja dhe zotërinj deputetë, të gjithë jemi dëshmitarë të faktit se praktikisht të gjithë transferët e të hollave që bëhen ndërmjet kontove tona private dhe

kontos së buxhetit të konsoliduar të Kosovës në cilindo nivel figuron një provizion sistematik që merret në emër të këtij shërbimi. Duke marrë parasysh se një numër jashtëzakonisht i madh i këtyre transaksione supozohet se ndodhin në nivel vjetor. Pyetja ime është si vijon:

Sa para u janë paguar bankave private në Kosovë, në vitin e kaluar fiskal, në emër të kryerjes së shërbimit për transferim të hollave për qytetarët e Kosovës në këto raste, në rastin e parë, për transfero të hollash nga thesari i BKK në kontot private të qytetarëve, si është rasti me transfero kur kemi të bëjmë për rrogat mëditjet apo pagesat e ndryshme dhe në rastin e dytë për transfer të hollash nga kontot private të qytetarëve ose kesh në drejtim të buxhetit të konsoliduar të Kosovës siç është rasti kur kemi të bëjmë me pagesat e ndryshme për dënime me trafikun shërbime komunale, gjykatave dhe IPVQ-ve e të tjera. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, urdhëroni z. zëvendësministër.

ZËVENDËS MINISTRI BEHXHET BRAJSHORI- I nderuari kryetarë i Kuvendit, i nderuar ministra, ministra kolegë deputetë, i nderuari kolegë deputetë Gorani. Sipas të dhënave që i kemi marrë nga thesari i ministrisë përgjigjja në pyetjen tuaj është kjo. Për çdo llogari individuale të pensionistëve asistencë sociale, invalidët e luftës, personat me aftësi të kufizuar për mirëmbajtjen e kësaj llogarie në baza vjetore i paguajmë bankave komerciale nga 5 euro, do të thotë për mirëmbajtje të llogarisë mbi këto baza, këto të dhëna përgatiten nga ministria e punës dhe mirëqenies sociale, kurse ne bëjmë transferim, autoritetet qendror dhe bankat të Kosovës për çdo transaksion financiar i bëhet pagesa në shumë prej 0,30 cent në emër të provizionit bankar, në lidhje me nënpikën e dytë, për mbledhjen e të hyrave qeveritare dhe komunale, doganave, tatimeve dënimeve të trafikut tatimit pronë etj, përmes bankave komerciale, buxheti konsoliduar i Kosovës nuk paguan provizion, provizioni paguhet nga paguesi me rastin e pagesës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, ka pyetje shtesë,

DEPUTETI GENC GORANI - Ju faleminderit zëvendësministër, megjithatë në përgjigjen tuaj mungon një e dhënë kryesore:

Sa është shuma totale e këtyre të hollave që bankat private inkasojnë me rastin e transaksioneve, në rastin e parë dhe në rastin e dytë, sa është shuma totale, sa para ata fitojnë në emër të atyre shërbimeve? Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Urdhëroni zotëri

ZËVENDËS MINISTRI BEHXHET BRAJSHORI - z. kryetar po që se është e nevojshme shuma absolute, kjo gjë është fare lehtë të bëhet mirëpo ajo është baza mbi të cilën duhet të bëhen ato transfere dhe të ruhet llogari- mbajtja. Varet prej numrit të klientëve. Si do që të jetë ajo mund të sigurohet dhe nuk është kurrfarë problemi. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Deputeti Ramadan Kelmendi ka pyetje për ministrin Agim Veliun, por ai nuk është këtu. Pyetja përcillet për seancën tjetër. Vazhdomë më tutje. Deputeti Jakup Krasniqi, ka pyetje për kryeministrin Çeku dhe ministrin Fatmir Rexhepi,

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Zoti kryetar, zotëri kryeministër. Në të përditshmin Lajm të datës 12 dhe 13 2006 me titull “Rrahje” dhe me nëntitull me shkronja të zeza ku citohen fjalët që ministrja e Shërbimeve Publike i ka thënë Ali Lajçit : “Me mua nuk të shkon se ta bëj si Smajl Hajdarajt” Pyetja: A keni marrë ndonjë masë për të verifikuar këtë deklaratë e cila hedh dritë për vrasjet politike deri më tani të pazbardhura në Kosovë?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit urdhëroni z. kryeministër.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – I nderuari z. kryetar, te nderuar deputetë. Edhe pse kemi të bëjmë me një rast që ka ndodhur në një aktivitet partiak, unë në raport kryeministër – ministër kam lypur sqarime me t’u njoftuar me rastin e ministres Tërmkollit, e cila m’i ka dhënë sqarimet, po të njëjtat të cilat i ka bërë vetë publike që e mohon në tërësi të ketë bërë një koment të tillë fatkeqësisht më njofton gjithashtu që ka pasur edhe tentim apo sulm ndaj saj që është për t’u brengosur. Më ka njoftuar gjithashtu që rastin do ta qetë para gjykatës dhe ta bëjë një padi dhe atëherë i takon hetuesisë, i takon drejtësisë, që të hedhë dritë në këtë rast dhe t’i bëjë sqarimet e nevojshme, ta presim procesin, t’i presim hetimet dhe atëherë ta dimë të vërtetën. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, keni për të plotësuar diçka Z. Krasniqi

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI –Po zoti kryetar, kam pyetje shtesë.Të gjithë e dimë që në Kosovë që nga viti 2000 e këndeje kanë ndodhur shumë vrasje, nga vrasja e Shaban Manaj në Burim dhe deri te Bardhyl Ajeti në Gjilan dhe të gjitha këto vrasje kanë mbetur të pazbardhura .Çka janë duke bërë Qeveria me ministrinë përkatëse, për t’i zbardhur këto raste që qytetarëve të Kosovës t’u tregohet e vërteta për këto vrasje që kanë ndodhur në periudhën e cekur?.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA -Ju faleminderit, nuk ka përgjigje. Deputeti Nait Hasani.

DEPUTETI NAIT HASANI – Ju faleminderit z. kryetar. Megjithëse e tejkalove radhën . më vjen mirë që u kujtuat. Unë e kam pyetjen e protokolluar më datën 25.10.2006 për kryeministrin dhe nuk di juve a ju ka mbërri a nuk ju ka mbërri, por megjithatë unë do ta vazhdoj. Unë do ta pyes kryeministrin; A ushtron pushtet politik dhe a është i fuqishëm ekskluzivisht të bëjë veprimet e veta?. Pikërisht e kam fjalën për ndalimin e punës në Kishën e Prizrenit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA -Ju faleminderit. Shpjegimi u dha nga zëvendësministrja dhe kryeministri ka të drejtë që pyetjen t'ia tregojë ministrit dhe mund të llogarisim që të marrim përgjigje në seancën e ardhshme plenare. Urdhëroni, Deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit, i nderuari kryetar, e nderuara Qeveri dhe kabineti qeveritar, unë para dy muajsh ia kam parashtruar një pyetje Ministrisë për Kthim dhe ajo ka konstatuar në atë se një kohë nuk ishte ministri, pastaj do ta marrë transkriptin dhe sot e atë ditë ajo pyetje nuk doli as në dritë dhe asnjë përgjigje. Pyetja është shumë e thjeshtë, për karshi edhe kësaj që sot shtrova, ndonëse është shtyrë zgjidhja e statusit të Kosovës, pjesa Veriore dhe qytetarët shqiptarë, boshnjakët dhe turq kanë shqetësim të madh, Atje asnjë veprim nuk është marrë nga kjo ministri për ndërtimin, kthimin, dhe krijimin e lëvizjes së lirë, vërtetë edhe një herë kërkoj që së paku me shkrim dhe publikisht të marr përgjigje: cilat janë shkaqet? Sepse problemi pas situatës së re të krijuar politike atje do të dramatizohet. Më së miri e dinë edhe kryeministri, i cili në aksionin e pyllëzimit 2006 është penguar për të marrë pjesë në një ..

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Deputeti Ymer Muhaxheri e ka kërkuar fjalën.

DEPUTETI YMER MUHAXHERI – Kuvendi i nderuar, zotëri kryetar, meqenëse u bë fjalë për një rast ku unë kam qenë në afërsi në atë trekëndëshin e këtij dialogu që është bërë,

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA -Profesor i nderuar, nuk është në rend dite kjo pikë. Për të shqyrtuar sot në rend dite është dashur të procedohet sipas Rregullores dhe vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës. Në fakt shkojmë në pikën e 6 ashtu si u morëm vesh në rendin e ditës për shkak të kërkesës së ministrit.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për noterinë

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 18 tetor 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Ftohet ministri Jonuz Salihaj që në emër të Qeverisë të Kosovës para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI JONUZ SALIHAJ – I nderuari z. kryetar i Kuvendit, kryeministër, ministra, të nderuar deputetë.

Projektligji për noterinë ka një rëndësi të veçantë. Me aprovimin e këtij projektligji krijohen institucione adekuate dhe kryhen shërbime noteriale, me anë të këtij ligji gjykatat do të lirohen nga punët joprofesionale me të cilat janë të ngarkuara siç janë punët lidhur me autorizimet e ndryshme, vërtetimi i dokumenteve, i kontratave, testamenteve, nxjerrja e ekstrakteve nga dokumentet origjinale etj. Domosdoshmëria e aprovimit të këtij projektligji shprehet edhe në faktin se kjo sferë do të rregullohet dhe të kompletohet me dispozita adekuate ligjore.

Ky projektligj ka për qëllim të ofrojë një zgjidhje praktike për të gjitha çështjet jashtë kontestimore në nivel të gjykatave komunale e cila për nga natyra janë të ngjashme për shërbimet noteriale, roli i Ligjit. Projektligji mbi noterinë së bashku me kodin noterial të etikës dhe sjelljes profesionale që do të përgatiten.

MINISTRI JONUZ SALIHAI -

Dhe të procedohet pas aprovimit të këtij projektligji do ta lehtësoj punën e gjykatave , do ta zvogëlojë në mënyrë të dukshme numrin e lëndëve të panevojshme dhe të paqartësive të cilat burojnë sidomos nga kontratat e mangëta.

Në këtë mënyrë noteri do t'u ofrojë të gjithë qytetarëve të interesuar ndihmën juridike, duke qenë i detyruar t'u ofrojë këshilla palëve për natyrën dhe efektet ligjore të transaksioneve e të veprimeve të tjera të kryera përmes shërbimeve noteriale.

Përmbajtja e ligjit

Projektligji ka gjithsej trembëdhjetë kapituj, përmban pjesën ideore, atë përmbajtjesore dhe përfundimtare. Janë propozuar gjithsej 76 nene që rregullojnë në përpikëri sistemin noterial në Kosovë.

Përputhja me përvojat dhe me standardet bashkëkohore

Projektligji mbi noterinë që nga fillimi është ndihmuar dhe mbështetur nga ekspertët ndërkombëtarë ,njëherësh edhe nga përfaqësues të Institutit për Studime të Avancuara Noteriale, me përfaqësi në Zvicër dhe në bashkëpunim të plotë me përfaqësuesit e USAID-it dhe NCSC, të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm. Prandaj, ky projektligj përmbush standardet e BE-së, kurse sa i përket kostos financiare ai do të jetë 125 mijë euro për vitin 2007, kurse pas aplikimit të Ligjit do të sigurohet vetë -financimi nga të hyrat e shërbimeve noteriale. Këto mjete do të dedikohen kryesisht për çështje administrative dhe logjistike, për mbajtjen e aftësimeve dhe të provimit të noterisë, për shtypjen e shpalljeve, broshurave etj.

Zyra zvicerane ka ndihmuar me shumë prej 90 mijë eurove të dedikuara kryesisht për aftësime ,ndërsa USAID-i nëpërmes NSCS do të mbuloj pjesën prej 25 mijë eurove nga buxheti i konsoliduar i Kosovës ,do të shpenzohen vetëm 10 mijë euro.

Prandaj, ky projektligj vlerësohet që i plotëson të gjitha standardet e parapara evropiane dhe ndërkombëtare për noterinë.

Hapat e domosdoshëm pas aprovimit të Projektligjit

Për zbatimin e këtij projektligji do të kujdeset Ministria e Drejtësisë dhe Dhe për konkretizimin e mëtejme të tij do të nxirren udhëzime administrative.

Në mbështetje të kësaj që u tha më lart, kërkojmë mbështetjen tuaj për aprovimin e këtij projektligjit shumë të rëndësishëm për sistemin e drejtësisë në Kosovë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. ministër. Në emër të LDK-ës fjalën e ka Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Faleminderit z. kryetar. I nderuari kryetar, të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, të nderuar kolegë deputetë.

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK ta paraqes vlerësimin për shqyrtimin e parë të Propozimligjit të noterisë në Kosovë, të cilin parimisht e përkrahim në aprovim të mëtutjeshëm.

Grupi Parlamentar i LDK-ës ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij propozim ligji dhe duke u mbështetur në arsyeshmërinë, qëllimin dhe rëndësinë parimisht përkrah miratimin në shqyrtim të parë duke konfirmuar angazhimin e grupit dhe të ekspertëve në grup që në komisione profesional përmes amendamenteve ta begatoj në përmbajtjen në efikasitet të zbatimit të tij.

Të nderuar deputetë, miratimi i Propozimligjit për noterinë Grupi i LDK-ës konsideroni të një rëndësie të veçantë, sepse në Kosovë deri më tani ka munguar. Në këtë drejtim shërbimi i noterisë, pra reforma e sistemit të drejtësisë po ecën ngadalë, gjykatat janë të stërngarkuara me lëndë të pazgjidhura, gjykatat duhet liruar nga punët joprofesionale, nga punët teknike dhe rutinore, andaj pikërisht këtu qëndron arsyeshmëria dhe bazueshmëria e miratimit të këtij propozimligji. Në këtë fazë të reformës së sistemit gjyqësor Grupi i LDK-ës vlerëson se gjykatat duhet të mos ngarkohen me autorizime të shumta, me vërtetime të ndryshme të dokumentacionit, me vërtetime të kontratave testamenteve, me nxjerrjen e ekstratave etj.

Andaj LDK-ja në konceptin e saj për Propozimligjin për noterinë si mundësi shumë reale dhe funksionale dhe mjaft praktike që të gjitha çështjet jashtëkontestimore të cilat deri më tani i kryejnë gjykatat tani e tutje duhet t'i kryejnë shërbimet profesionale notere. I tërë ky qëllim konsiston në paqartësinë e reformave të gjykatave, në eliminimin e mungesave të proceseve të noterimit.

Po ashtu Grupi i LDK-ës vlerëson se është e domosdoshme që Ministria e Drejtësisë të nxjerrë udhëzime administrative dhe të bëjë trajnimin e zbatuesve të Ligjit për noterinë. Pasi që shërbimi i noterisë kalon në kompetencat e drejtorisë e të shërbimit konkret në një kohë relativisht të shkurtër do të arrihet vetëfinancimi dhe nuk do t'i ketë ngarkesa buxhetore në Kosovë në këtë fushë.

Grupi i LDK-ës vlerëson se Propozimligjit për miratimin ende nuk po e kuptojmë bazën juridike të ligjit në Komizën Kushtetuese të përkohshme dhe jo vetëm në Rregulloren e UNMIK-ut, rast konkret është edhe në këtë propozimligj që nuk ishte duhur të ishte pikërisht nga Ministria e Drejtësisë. Megjithatë kjo kuptohet si punë që mund të mënjanohet. Ne mendojmë se bazuar në rolin, rëndësinë dhe përgjegjësitë e noterit në këtë propozimligj patjetër duhet të përcaktohen detyrat dhe profesionalizimi i noterit si zyrtar publik me nënshkrim dhe me vulat e autorizuara, me pamundësinë e keqpërdorimit dhe me përcaktimin e dënimeve në rastet kur dokumentet nuk mund të lëshohen të noterizuara dhe kujtoj se në këtë drejtim duhet sanksionuar me të drejtë dhe të plotësohet një parim që ushtruesi i detyrës të noterit, por jo edhe të tejkalohen kriteret për emërimin

e tij siç janë tre vjet përvojë pune, dhënia e provimit për noter, mos të jetë anëtar i ndonjë subjekti politik, të mos ketë qenë i dënuar mbi tre muaj , kriteret të cilat nuk kanë vlerë dhe nuk po vlejnë edhe për shumë funksione që ushtrohen me peshë politike dhe me profesionalizëm më të madh nëpër institucionet e Kosovës dhe jo vetëm për noterinë.

Propozimligji nuk e sqaron rolin e kompetencave dhe të funksionit se si duhet të funksionojë dhoma e noterit.

Grupi i LDK-ës vlerëson se është e arsyeshme të rishqyrtohen procedura dhe lëndët për dhënie e provimit për noter, si dhe teksti i betimit të ketë përmbajtje më bindëse të besueshmërisë në mes të deklaratimit formal dhe ndërgjegjes profesionale.

Ne vlerësojmë se me formimin e Ministrisë së Drejtësisë janë krijuar të gjitha parakushtet që të nxirret ligji i vulave, i gjykatave, i prokurorëve dhe i institucioneve penale , ai i noterit, si dhe në noteri të largohet nga puna sipas fuqisë ligjore në moshën 65 vjeçare e jo siç e parasheh ky propozim ligj në moshën 70-vjeçare. Shikoni nenin 22 pikat c, ku nuk ka arsytim, ndonëse është fjala për një propozim ligj mjaft të gjerë, por gjithëpërfshirës të fushës që rregullon këtë materie mjaft të ndjeshme Grupi i LDK-ës propozon të përkrahet në shqyrtimin e parë ,duke dhënë pëlqimin për procedim të mëtutjeshëm kuvendor dhe për angazhim maksimal, profesional për ta proceduar më tutje. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Nga PDK-ja deputetja Nerxhivane Dauti.

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë.

Ligji mbi noterinë është ligji i parë që është prezantuar sot nga ministri i Drejtësisë dhe konsideroj se do të ishte shumë më mirë që para procedimit të këtijLigji z. ministër të kishim proceduar me Ligjin mbi gjykatat e rregullta të Kosovës dhe Ligjin mbi procedurën jashtë kontestimore, ligji me të cilat është i lidhur edhe Ligji mbi noterinë.

Megjithatë përshëndes hapin të cilin e keni bërë lidhur me Ligjin mbi noterinë, meqenëse noteria në Kosovë ka munguar dhe është institucion i ri që në Kosovë nuk ka ekzistuar ndonjëherë. Miratimi i Projektligji mbi noterinë ka rëndësi të dyfishtë,

Së pari, për faktin , si theksova edhe më lart, deri më tani në Kosovë, ka munguar një institucion adekuat që do të kryente shërbimet e ndryshme noteriale,

Së dyti, gjykatat do të lirohen nga punët joprofesionale siç janë: vërtetimi i dokumenteve të ndryshme, vërtetimi i kontratave të shumëllojshme që bëhen për qarkullimin e mallrave dhe për dhënie e shërbimeve, testamenteve të llojllojshme dhe autorizimet e ndryshme ,të cilat e stërngarkojnë punën e gjykatave të rregullta në Kosovë.. Me Ligjin mbi noterinë rregullohen 1). Funksionet, 2), kushtet, 3), metodat e punës së noterëve në Kosovë dhe 4), në veçanti organizimi i funksioneve të tyre.

Qëllimi i Projektligjit të propozuar është të ofrojë zgjidhje më tepër praktike në çështjet jashtëkontestimore, për të cilat mungon Ligji mbi procedurën jashtëkontestimore, ligj i cili është zvarritur shumë z. ministër në këtë Kuvend dhe ende nuk kemi ligj për procedurën jashtëkontestimore që do ta thjeshtësonte punën dhe të bënte zgjedhje më praktike për çështjet fundamentale të praktikës gjyqësore në Kosovë.

Lidhur me këtë ligj, do të ndalem kryesisht në disa vërejtje thelbësore që i përmban .

Në nenin 2, paragrafi 3, duhet të zëvendësohen termat juridikë në gjuhë të huaja me ato të gjuhës shqipe, me qenë se gjuha shqipe është shumë e pasur me terma juridikë, sepse nuk ka nevojë që ligji të ngarkohet me terma të pazbërthyer të cilët e ngarkojnë praktikën gjyqësore dhe e bëjnë të pazbatueshëm ligjin.

Në nenin 9, paragrafi 9, në rastin e Komisionit për përzgjedhjen e noterëve , kur është fjala për profesorin e drejtësisë si anëtar i komisionit, i cili e bën vlerësimin e kandidatëve duhet të precizohet se ai duhet të jetë civilist, meqenëse provimi për noter, mbahet konkretisht nga lënda, E Drejta e detyrimeve, civile, familjare, trashëgimore dhe ekonomike apo biznesore.

Në nenin 11, paragrafi 1, duhet të hiqet "... ligji i zbatueshëm" dhe të zëvendësohet kjo fjalë "në pajtim me ligjin dhe kodin noterial të etikës që është diçka tjetër".

Në nenin 10, paragrafi 3, Ligji i propozuar i referohet Ligjit mbi gjykatat e rregullta, ligji i tillë ende nuk është shqyrtuar dhe miratuar në këtë Kuvend.

Në nenin 12 paragrafi 3 në vend të "presidentit të gjykatës së qarkut," duhet të jetë:" kryetarit të Gjykatës së qarkut." në po të njëjtin nen, paragrafi 4, në vend të "palës së tretë" duhet të jetë "personi i tretë".

Në nenin 13 paragrafi 5, duhet të jetë " veprimet zyrtare të ndërmarra në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni do të konsiderohen nule dhe të pavlefshme", e jo ashtu ,siç figuron në nenin 13 paragrafi 5.

Në nenin 21 paragrafi 7, formulimi duhet të jetë adekuat "noteri që mungon apo që është suspenduar mund të mbahet përgjegjës si debitor solidar ..." ndërsa fjalia vazhdon më tutje ,siç është paraparë në ligj.

Në nenin 29 pika i. Formulimi juridik duhet të jetë "nënshkrimin dhe vulosjen e AKTIVES e jo ashtu siç figuron në ligj që do të ndahen në kontekst të procedurave trashëgimore dhe të falimentimit", ne i kemi nxjerrë ligjet përkatëse, Ligjin për trashëgimi dhe Ligjin e falimentimit ,të cilat shumë hollësisht e rregullojnë çështjen e solidaritetit aktiv të debitorit .

Ekzistojnë edhe vërejtje të tjera, të cilat do t'i parashtroj në Komisionin Funkcional ,anëtare e të cilit jam.

Marrë në përgjegjësi, duke marrë parasysh vlerën dhe rëndësinë e veçantë të këtij ligji për praktikën gjyqësore në Kosovë dhe faktin se për herë të parë në Kosovë bëhet

institucionalizimi i këtij institucioni ligjor. Konsideroj se Projektligji duhet të miratohet në shqyrtim të parë. Në emrin tim dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, mendoj se Ligji duhet të miratohet, ndërsa kontributin rreth amendamentimit të këtij ligji, do ta shprehim në komisionin adekuat parlamentar.

Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit në emër të AAK-ës deputeti Naim Maloku.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Faleminderit z. kryetar, të nderur ministra kolegë deputetë.

Konsiderojmë se mungesa e këtij projektligji ka shkaktuar stërngarkim të madh në gjykatat komunale gjatë periudhës së pasluftës në Kosovë, miratimi i këtij projektligji do të lironte gjykatat nga këto punë siç quhen në projektligj joprofesionale, me të cilat janë marrë gjerë më tani dhe do të bëheshin gjykatat më efikase në kryerjen e punëve në lëndët me të cilat janë të mbuluara gjykatat tona.

Grupi Parlamentar i AAK-ës konsideron se Projektligji duhet të kalojë në procedim të mëtejshëm. Ftojme deputetë që ta miratojnë këtë ligj në parim dhe do të marrin pjesë si grup parlamentar në fazat e mëtejshme të shqyrtimit. Ju faleminderit z. kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit në emër të ORA-s Teuta Sahatqija

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit z. kryetar. I nderuari kryetar, e nderuar Qeveri të nderuar kolegë deputetë.

Noteria deri tash në Kosovë nuk ka qenë e njohur si praktikë dhe pikërisht mosekzistimi i kësaj praktike ka sjellë një stërngarkim të gjykatave, të cilat kanë rezultuar si jo funksionale për shkak të një numri shumë të madh të lëndëve. Ky shërbim profesional i noterisë do të ndihmojë në funksionalitetin dhe në efikasitetin e punës së gjykatave. Sidomos në këtë ligj mosngarkimi i buxhetit, por përkundrazi mbushja e tij prej punës së noterëve, si dhe punësimi janë në favor të miratimit të këtij ligji, por gjithsesi pajtohemi me kolegun e LDK-ës, i cili tha se viti deri kur duhet të ushtrohet kjo detyrë do të duhej të zvogëlohej në mënyrë që t'u jepet shansi edhe të rinjve të punësohen dhe të ushtrojnë këtë aktivitet. Por, gjithsesi do të duhet të kemi parasysh se noterët duhet të jenë persona të përgjegjshëm dhe profesionalizmi do të duhej të rregullohej me ligj dhe të sanksionohet çdo keqpërdorim i mundshëm i kësaj detyre të rëndësishme.

Përsëri pajtohemi që ky ligj ndoshta do të duhej të paraprihej me ligje të tjera, të cilat do të rregullonin këtë çështje, por pasi veç e kemi këtë projektligj përpara, ne si Grup Parlamentar e përkrahim miratimin e këtij ligji dhe kontributin tonë përmes amëtarëve tanë në Komision do të japim gjatë punës së Komisionit funksional. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. para se do t'ia jap fjalën diskutuesit tjetër, ftoj deputetët që nuk gjenden në sallë të kthehen sa më shpejt, përndryshe duhet të votojmë. Fjalën e ka deputeti Mahir Jagcilar në emër të Grupit 6+.

DEPUTETI MAHIR YAGCILAR - Faleminderit z. kryetar.

Sayın Başkan, Başbakanlar ve saygıdeğer milletvekilleri

6+ Parliamenter Grubu, Kosova Kamu noterliğine ait Yasa'yı görüştü.

Biz grup olarak, bu Yasa'nın kabul edilmesiyle, Mahkeme çalışmalarının daha verimli olacağına ve onların çalışmalarının daha etkili olmasına yardımcı olacağına inanıyoruz. Bundan başka, bu Yasa'nın, vatandaşlara hukukî ve adil yardımın sağlanmasına da katkı sunacağına inanıyoruz. Bundan dolayı Adalet Bakanlığı tarafından bu Yasanın hazırlanması girişimini de selamlıyoruz.

Prensipde, yasayı hazırlayan Komisyonun yapısı konusunda uyarımız var, çünkü çalışma grubunda, Türk veya Boşnak topluluğundan hiçbir üyemiz bulunmuyor.

Diller konusundaki 35. madde üstüne de uyarımız var, düşüncemize göre bu maddede, Diller Yasasına uyumlu olarak Türk ve Boşnak dillerinin de yer alması gerekir.

Ayrıca bazı maddelerin gereğinden daha uzun olduğunu da düşünüyoruz.

Grup olarak biz prensipde, Yasa Önergesini kabul ediyoruz ve Komisyonlarda görüşüldükten sonra bu Yasa'nın nihai ve en adaletli şeklini alacağına inanıyoruz.

Dikkatinize teşekkür ederim

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Edhe një herë ftoj deputetët që nuk gjenden në sallë të kthehen sa më parë, në mënyrë që të votojmë për Ligjin në parim. Ka një sqarim ministri Salihaj.

MINISTRI JONUZ SALIHAIJ – Po shfrytëzoj kohën deri sa të vijmë deputetët në sallë, plotësisht bindja ime është se do të duhej të ishte një herë Ligji për gjykata, mandej Ligji për noteri, me gjithë atë z. Dauti edhe të tjerët e dini me siguri që Ligji për gjykata e prek Komizën Kushtetuese. Unë takimet që i kam pasur me z. Petersen sa ka qenë kryeadministrator e në takime të tjera praktikisht kam pasur pengesë që ndoshta të vijmë deri tek Ligji për gjykata e rregullta para se të shkojë noteria dhe për të pasur ngecje në proces, është mirë një herë ta eliminojmë noterinë e të shkojmë me pako tjetër ligjore. Megjithatë unë do ta shfrytëzoj rastin tash t'ju them se jam shumë i bindur që ligji për gjykata do të duhej të harmonizohej me parimet në bazë të Kushtetutës së Kosovës dhe këtë punë po e bëjmë, sepse ai Ligj po ashtu e prek Kushtetutën dhe ne duhet ta zgjedhim sistemin gjyqësor çfarë e dëshirojmë.

Po ashtu e dini se e kemi në proces riemërimin e gjykatësve, të prokurorëve që është një proces shumë i rëndë dhe shumë i rëndësishëm për ne, sepse çdo gjyqtar dhe prokuror do t'i nënshtrohet një komisioni profesional nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Në lidhje me moshën 65 apo 70 vjeçare, jam shumë i bindur që ka prokurorë dhe gjykatës që i kanë mbushur 65 vjet, por i nevojiten shumë sistemit të drejtësisë deri në moshën 70- vjeçare. Një gjykatës dhe një prokuror nuk mund të krijohen lehtë- po flas për gjykatës dhe për prokurorë dinjitozë që ne kemi mjaftë.

Prandaj besoj se do të ishte zgjidhje e mirë që Ligji për noterinë edhe për gjykatat t'u mundësohet atyre njerëzve ,disave, po them që edhe moshë 70 vjeçare të mos jetë problem, por kjo është çështje e Kuvendit dhe Kuvendi do të vendosë sigurisht në të ardhshmen për këtë proces. Ky është veç propozim për noteri edhe në Ligjin për gjykata. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Ramadan Kelmendi, urdhëroni.

DEPUTETI RAMADAN KELEMNDI – Z. kryetar ,unë nuk kam ndonjë reagim, por dua ta bëj një arsyetim shumë të bazuar.

Universiteti i Prishtinës aq ka nevojë për profesorë që kanë mbushur moshën mbi 65 - vjeçare dhe të tillët unë nuk do të hy prapë në atë proces janë larguar nga procesi edukativo -arsimor, për gjyqtarë dhe prokurorë nuk është problem me krijua deri në moshën 65- vjeçare e 70. Ministër kërkoj falje, por vërtet kjo moshë është shumë e shtyrë dhe joadekuate për funksionin e noterit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Nerxhivane Dauti, replikë sigurisht.

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI – Faleminderit z. kryetar, nuk kam replikë, por pajtohem me arsyetimin të cilin e dha ministri i Drejtësisë lidhur me gjykatat e rregullta, një fakt po e theksoj se nuk jam kundër Ligjit mbi noterinë ,sepse është shumë i rëndësishëm për Kosovën edhe në mandatin e kaluar në legjislaturën e kaluar kur kam punuar në Kodin civil të Kosovës në Ligjin e detyrimeve, në Ligjin e trashëgimit, në Ligjin e familjes, unë kam kërkuar që të shkruhet edhe Ligji mbi noterinë ,sepse është shumë i domosdoshëm për Kosovën, Shtetet e tjera e kanë këtë ligj dhe jam në dakord për miratimin e këtij ligji, por korniza adekuate kërkon të kemi edhe Ligjin mbi gjykatat e rregullta ,sepse do ta lehtësonte punën e zbatimit të këtij ligji që e kemi tani, por nuk e kam një pyetje të qartë që unë e kam menduar ta shtroj në formë të pyetjes parlamentare për ministrin e Drejtësisë ,sepse jam anëtare e Komisionit për Legjislacion, Po e shfrytëzoj rastin tani deri sa të mblidhen deputetët për votim të Projektligjit në fjalë që të parashtrij dy pyetje njëkohësisht .

Se çfarë është duke bërë Ministria e Drejtësisë lidhur me Ligjin për procedurën kontestimore dhe me Ligjin për procedurën jashtëkontestimore, dy ligje,të cilat ky Kuvend i ka kthyer, sepse arsyetimi ka qenë se ishin kopje të Ligjit të Serbisë dhe nuk ka pas teknikë juridike adekuate për hartimin e ligjit, dhe nuk ka qenë kompatibil me standardet ndërkombëtare. Kjo për mua është shumë me rëndësi , sepse Kosova është në hendikep, gjykatat janë në hendikep ,nuk mund të zbatohen më ligjet e Serbisë . Më intereson nga ministri i Drejtësisë t'i theksojë disa fjalë lidhur me këto dy ligje, po që se

nuk e ka fjalimin të përgatitur, me qenë se këto duhet të shtrohen në pyetje parlamentare, mendoj se ministri duhet të na sjellë përgjigjen adekuate për Ligjin për procedurën kontestimore dhe jashtë kontestimore në një seancë të radhës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka z. ministër.

MINISTRI JONUZ SALIHAI – Unë tash nuk e kam përgjigjen e saktë për këto dy ligje që i përmendi z. Dauti. Me gjithë atë po ju them se problem në Kosovë nuk është mungesa e ligjeve, problem është aplikimi i ligjeve. Do të kisha dëshiruar shumë që të mos aprovojmë ligje pa politika gjegjëse legjislative. Ne s'kemi pasur politika efikase legjislative, prandaj shumë ligje nuk aplikohen në praktikë, shembull konkret Ligji për vlerat e luftës, kostoja 22 milion euro, ose Ligji për punën -kostoja 20 milion euro, çka na duhen ligjet kur nuk i zbatojmë në praktikë?

Nuk dua të ndodhë kjo „do t'i aprovojmë këto ligje dhe do t'i korigjojmë k, e kemi një problem kyç. Ju do të debatonim për buxhetin 2007 që është kyç, ne kemi më se 420 gjyqtarë e prokurorë, nuk mjaftojnë, na nevojiten më së paku edhe 100 të tjerë dhe do të kemi një mori ligjesh, por ne s'kemi njerëz ende në këtë sistem, do të thotë s'kemi energjinë në sistem. Ne duhet patjetër të shtojmë numrin e gjykatësve, sepse i kemi nivelit të viteve 70-ta, atëherë kemi më shumë lëndë. Nëse ky Parlament dhe Qeveria nuk bëjnë presion të madh që të kemi paga më dinjitoze më shumë prokurorë, më shumë gjykatës, më shumë efikasitet ne s'kemi shansin në sundimin e ligjit. Këtë e dimë të gjithë, se kurri i sistemit janë drejtësia dhe rendi dhe këtë s'kam nevojë me ja shpjeguar dhe nuk është sistemi i drejtësisë sistemi i arsimit me 20 mijë të punësuar, janë 420 njerëz, vetëm një milion e gjysmë euro në vit mjaftojnë ta rregullojmë çështjen e gjyqësorit në Kosovë, që është plotësisht i pavarur dhe menaxhohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Pyetjen e saktë rreth afateve sigurisht do ta keni në mbledhjen tjetër. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – I nderuari kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë, këtu kemi dalë jashtë temës, por prapëse prapë, meqë u hap kjo çështje, do të diskutoj.

Në Kosovë ekziston Ligji për procedurën jashtëkontestimore, të cilin e ka miratuar Kuvendi i Kosovës diku në vitin 1984. Unë e kam hartuar atë ligj dhe pse nuk po zbatohet unë nuk di, ndoshta ka nevojë ai ligj të dalë tash si ligj i ri për të krijuar një diskontinuitet midis ligjeve të mëparshme dhe ligjeve të tashme dhe nuk është e vërtetë se punohet me Ligj të Serbisë të procedurës jashtë kontestimore, por është Ligji i Kosovës.

Sa i përket moshës së gjyqtarëve dhe të prokurorëve, përkatësisht Ligji për gjykatat ekziston edhe Ligji për gjykatat e rregullta, sipas atij ligji gjyqtari mund të ushtrojë funksionin e vet nëse është psikofizikisht i aftë deri në moshën 70- vjeçare që do me thanë se ky ligj special dhe për gjyqtarin nuk vlen Ligji për punën, sepse ai ligj e

parashih pensionimin me 65 vjet ,kurse Ligji për gjykatat e parashih pensionimin për 70 vjet moshe, e nëse nuk është në gjendje psikofizikike me ushtrua atë profesion, atëherë ai mund edhe përpara me u shkarkua.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Me qenë se nuk ka tjetër të interesuar për diskutim ju njoftoj se në sallë momentalisht janë 68 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim.

Për votimin e ligjit në parim.

Votojmë tash:

Për..... 64;

Kundër..... 3.

Kalon ligji. Konstatohet se aprovohet në parim Projektligji për noterinë.

Kalojmë në pikën e katër të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për auditimin e brendshëm

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 27 prill 2006. Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raport dhe rekomandimet me amendamente.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa ,si dhe të Komisionit Funkcional dhe raportues në vijim jepet radhitja dhe rekomandimet e amendamenteve në tekstin e Ligjit për auditimin e brendshëm si vijon.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për auditimin e brendshëm ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për auditimin e brendshëm dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për auditimin e brendshëm dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kalojmë në amendamentin e parë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Kërkoj falje se duhet të ndërpritet votimi për shkak se nuk e kemi kuorumin.

Lus deputetët, të cilët nuk janë në sallë le të kthehen të votojnë për ligjin.

Momentalisht kemi vetëm 58 deputetë.

Edhe një herë lus deputetë që nuk gjenden në sallë të kthehen sa më parë.

Aktualisht tani i kemi 64 deputetë dhe mund të votojmë.

Votojmë tash:

Për..... 57;

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti numër 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për..... 53;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti numër 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për..... 57;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti numër 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Për..... 55;

Kundër..... 3.

Kalon amendamenti numër 4.

Amendamenti 5

Aktualisht kemi 69 deputetë në sallë.

Votojmë tash:

Për..... 59;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti numër 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Për..... 55;

Kundër..... 4.

Kalon amendamenti numër 6

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Për..... 57;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti numër 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Për..... 59;

Kundër..... 5.

Kalon amendamenti numër 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Për..... 61;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti numër 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Për..... 62;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti numër 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Për..... 61;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti numër 11

Shkojmë në miratimin e tekstit në tërësi.

Votojmë tash:

Aktualisht në sall janë 73 deputetë

Për..... 69;

Kundër..... 2.

Miratohet Projektligji për auditimin e brendshëm.

Mund të marrim një pauzë deri në orën 12,00.

Ju faleminderit.

Shkojmë në pikën e pestë të rendit të ditës

5. Shqyrtimi i parë i Projektligji për shndërrimin e posedueseve të palujtshmërive private në pronar.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 12 tetor 2006, dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Ftoj ministren Melihate Tërmkollin ta prezantojë Projektligjin.

Aktualisht nëse seancë janë 70 deputetë. Urdhëroni!

MELIHATE TËRMKOLLI – MINISTRE -Ju faleminderit z. kryetar! Të nderuar deputetë. Arsye për hartimin e këtij projektligji është rregullimi në mënyrë të drejtë dhe sipas standardeve bashkëkohore i regjistrimit të së drejtës mbi pronën e paluajtshme. Ky projektligj adreson çështjet të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin, procedurat dhe me rregullimin e të drejtës për shndërrimin e poseduesve të pronave të paluajtshme private në pronarë sipas standardeve universale për pronën dhe posedimin me të. Me këtë ligj do t'u garantohen dhe do t'u precizohen të drejtat mbi pronën e paluajtshme pronarëve të provave private. Qëllimi i projektligjit është që të bëjë shndërrimin e poseduesve në pronarë për pronat, ku tipi i pronës është private dhe si dokument kryesor merret fleta poseduese e mbajtësit të pronës, pasi që fleta poseduese është dokumenti më i besueshëm për të vërtetuar të drejtën mbi pronën e paluajtshme.

Deri më tani ndërrimet në regjistrat e kadastrave janë bërë në bazë të ligjeve në fuqi siç janë: Ligji mbi matjen dhe kadastrën; Ligji mbi qarkullimin e pasurisë të plujatshme; Ligji mbi trashëgimisë dhe ligjeve të tjera dhe vendime mbi njohjen e të drejtave të pronësisë nga organet kompetente gjyqësore. Të gjithë mbajtësit e të drejtës mbi pronën e paluajtshme nuk kanë mundur të regjistrohen si pronarë për shkak të mungesës së librave të tokave në Kosovë ose mungesës së regjistrave publik për regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme. Andaj, të nderuar deputetë pra paraqesim para jush për aprovim Projektligjin për shndërrimin e poseduesve të paluajtshmeve private në pronarë. Ky Projektligj është aprovuar nga ana e Qeverisë së Kosovës më 27.09.2006, dhe sipas procedurës, pra i është, i parashtrohet Kuvendit të Kosovës për miratim. Ndikimi i këtij ligji pas aprovimit do të jetë shumë i madh në praktikën e zbatimit dhe të interpretimit të të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

Rregullimi i kësaj sferë në këtë ligj do të mundësoj siguri më të madhe për pronarët dhe për institucionet e tjera ku të gjithë do ta kenë të qartë Raportin e titullarit në pronën e vet. Kjo do të ketë rëndësi edhe më të madhe në zhvillimin e tregut të tokës, dhe zhvillimit të biznesit duke ofruar siguri mbi pronat. Për zbatimin e këtij Projektligji do të ketë shpenzime shtesë nga ato të veprimtarisë së rregullt të Agjencisë Kadastrorë të Kosovës dhe zyrave kadastrorë komunale, por të cilat shpenzime do të mbulohen nga mjetet buxhetore të Agjencisë Kadastrorë dhe të zyrave komunale, pra nga buxheti i komunës përkatëse.

Të nderuar deputetë. Propozoj që ta aprovoni këtë projektligj në mënyrë që kjo çështje të vihet në suazat e kornizës ligjore adekuate. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA -Ju faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të LDK-së – Nekibe Kelmendi

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – I nderuari kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje këtë projektligj dhe ju them të vërtetën se kemi qenë në dilemë a ta tërheqim tërësisht apo të shkojmë në miratim në parim, në lexim të parë. Ky projektligj përfshinë apo rregullon tri materie, çështjen e posedimit, çështjen e pronës dhe çështjen e regjistrimit. Çështja e regjistrimit të pronave tanimë është e rregulluar me një ligj ekzistues, të cilin e ka nxjerrë Kuvendi i Kosovës, ky është Ligji për themelimin e regjistratit të të drejtave të pronës së paluajtshme nr. 2002/5. Mandej është nxjerr edhe një ndryshim i ligjit që e citova me Ligjin 2003/13. Pastaj është edhe Ligji për kadastrë, i cili gjithashtu, merret me çështjen e regjistrimit e pronave në operativë kadastrorë, e tani

na paraqitet ky ligj me të cilin titulli është jashtëzakonisht domethënës dhe shpresëdhënës për qytetarët, mirëpo në praktikë kjo nuk mund të shkohet kështu dhe nuk mund të zbatohet sipas kësaj. Kjo në fakt po ua njeh të drejtën poseduesve të patundshmërive në pronën, kurse e drejta e posedimit prej të drejtës së pronës kanë dallim si nata me ditë ndërmjet tyre. Pra, e drejta e posedimit është ushtrimi i pushtetit faktik dhe në çka, nëse ai ushtrim i pushtetit faktik bëhet në mënyrë të ligjshme, d.m.th. e atyre që kanë ardhur deri në posedim në mënyrë të kundërligjshme po i legjitimojmë si pronarë, nga ana tjetër dihet se si mund të fitohet e drejta pronësore. Pra këto janë dy çështje reale, nuk janë çështje administrative, siç pretendohet të paraqitet në ligj. Megjithatë, ndoshta Qeveria ka menduar të përmirësojë diçka me këtë ligj ani pse nuk kuptohet se çka përmirëson nga ligjet që i përmenda më parë. Por, megjithatë kemi vendosur që si grup parlamentar këtë ligj ta mbështesim në parim, por do të ketë shumë punë në amendamentimin e tij dhe do të na dalin ndoshta dyfish më shumë amendamente se sa që ka vetë ligji.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Në emër të PDK-së deputetja Nerxhivane Dauti.

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI - Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë Në Kosovë pas luftës janë nxjerrë ligje të rëndësishme, siç janë: Ligji për matjen dhe kadastrin; Ligji mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme; Ligji mbi trashëgimin, që kanë rregulluar çështje relevante edhe për të drejtat pronësore, por titullari i së drejtës së pronësisë nuk ka pasur mundësi ligjore të regjistrohet si pronar mu për shkak të mungesës së librave të tokave në Kosovë, ose mungesës së regjistrave publik për regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

Duke marrë parasysh faktin e përmendur, rregullimi ligjor i statusit të titullarëve të paluajtshmërive në status juridik të pronarit sipas standardeve universale për pronësi dhe posedimin me te, me ligj të veçantë është i domosdoshëm dhe imperativ i kohës. Edhe pse ligji i propozuar nuk është voluminoz që gjithsej përmban 9 nene, për nga materia dhe përmbajtja që rregullon është me rëndësi të madhe. Projektligji ka për qëllim që t'i rregullojë të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin, me procedurat dhe rregullimin e së drejtës për shndërrimin e poseduesve të pronave të paluajtshme private në pronarë, pra rregullimin ligjor të statusit të titullarëve të paluajtshmërive në status juridik të pronarit sipas standardeve universale për pronën posedimi apo posesiv është ushtrim i pushtetit faktik i një apo më shumë personave mbi një pronë, kështu e precizon edhe Ligji i propozuar. Sipas Ligjit të propozuar posedim është zotërimi i ligjshëm, pra fjala është për posedimin **bonatidës** me mirëbesim. Këtu situata është shumë e pastër, nuk flasim për keqpërdorime kur është posedimi me keqbesim, prandaj kjo është çështje të cilin mendoj se ligji e ka precizuar në strukturën e vet kur i jep definicionet e ato janë të rregulluara si për pronësi, ashtu edhe për posedim që në fillim të projektligjit të propozuar.

Posedimi është zotërim i ligjshëm i pronës që është regjistruar në kadastrë në bazë të kontratës kontaktuese, në bazë të ligjit **ekslege** ose të aktit administrativ, siç është fjala për komasacionin.

Ligji i propozuar autoritet kryesor e konsideron Agjencionin Kadastral të Kosovës, pra barra i bie Agjencionit Kadastral të Kosovës, si agjencion qendror përgjegjës për

regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme dhe për punët e kadastrit. E theksova çështjen e posedimit për ta lidhur me faktin se tani me ligjin e propozuar bëhet shndërrimi i poseduesve të pronave të paluajtshme private në pronarë, të cilëve u njihet e drejta e pronësisë mbi pronën private të evidentuar në bazën e të dhënave kadastrorë të Kosovës, pra këto të dhëna janë në bazën e Kadastrit. Kjo që theksove u njihet të gjithë mbajtësve të fleteve poseduese mbi pronën e paluajtshme. Fleta poseduese në Kosovë është dokument zyrtar më i besueshëm për të vërtetuar të drejtën mbi pronën e paluajtshme.

Përmbajtja dhe qëllimi i projektligjit janë të qarta që duke definuar në mënyrën më të mirë pronën private në Kosovë të krijojë një sistem më të favorshëm kadastror në Kosovë. Ky Projektligj ka lidhje edhe me Ligjin për të drejtat sendore dhe si udhëheqëse e Grupit punues për këtë ligj. Të nderuar kolegë deputetë, ju informoj se jemi duke punuar në drejtim të harmonizimit të komenteve të Zyrës Ligjore të UNMIK-ut që ky Ligj të nënshkruhet sa më shpejtë edhe pse është miratuar në legjislaturën e kaluar dhe me anë të këtij ligji do të eliminoheshin shumë zbrazësira ligjore dhe do të lehtësohej puna e gjykatave në praktikë. Nga kjo do të lehtësohet puna drejt zbatimit edhe të këtij ligji që e sot në shqyrtim. Kjo do të ketë rëndësi edhe më të madhe në zhvillimin e qarkullimit të mallrave duke ofruar dhe siguruar një siguri më të madhe ligjore mbi pronat private, sepse vetëm kësaj kategorie apo tipit të pronës i referohet Projektligji i propozuar. Ligji pra krijon një stabilitet legjislativ të dëshiruar dhe një sistem të favorshëm kadastror në Kosovë.

Unë me ju thënë të drejtën më vjen mirë se si eksperte ligjore e lëmisë civile konsideroj se është ligj shumë i rëndësishëm dhe e kompletton sferën e legjislacionit civil në këtë aspekt. Në cilësinë e ekspertës ligjore për materien civile-juridike i paraqes tri vërejtje thelbësore për këtë Projektligj. Vërejtja e parë ka të bëjë me nenin 5.7, kurse e dyta në nenin 6.1. Afati i paraparë i nenit 5.7 për paraqitjen e vërejtjeve në fletën poseduese është 24 muaj prej momentit të shpalljes. Ky afat është mjaft i gjatë dhe amendament i veçantë duhet ndryshuar. Pas kalimit të këtij afati Agjencioni Kadastror i Kosovës eksoficio në bashkëpunim me Zyrën Kadastrorë do ta bëjë shndërrimin e poseduesve në pronarë për pronat private në regjistrin mbi të drejtat në pronën e paluajtshme.

Vërejtja II. – ka të bëjë me nenin 6. Sipas këtij neni për gabimet (?) në të dhënat mbi pronën e paluajtshme mund të paraqiten vërejtje dhe ankesa. Ankesa mund të paraqitet në afatin prej 24 muajve prej momentit të shpalljes së fletëve poseduese. Afati për paraqitjen e ankesës prej 24 muajve është shumë i gjatë. Vërejtja e tretë ka të bëjë me nenin 5.5.

Në nenin 5.5, theksohet se kundër vendimit të Agjencionit Kadastral të Kosovës mund të ushtrohet ankesë. Pala e pakënaqur me vendimin e Agjencionit i drejtohet gjykatës kompetente. Në këtë nen duhet të precizohet afati i paraqitjes së ankesës, sepse mungon afati i paraqitjes që mendoj se do ta lehtësonte punën në praktikën gjyqësore. Një vërejtje do të jetë e përgjithshme. Në vend të shkurtesave që përmenden në Ligj për shembull: AKK, ZKK në tërë tekstin ligjor pra duhet të theksohet emri i autoritetit përkatës, me qëllim që zbatuesi i ligjit ta ketë më lehtë zbatimin në praktikë.

Në emër timin dhe të Prupit Parlamentar të PDK-së konsideroj se ligji mund të miratohet në shqyrtim të parë, kurse vërejtjet që kanë të bëjnë me këtë ligj mund të përmirësohen në fazën e amendamentimit të tij.

Ju falënderoj për vëmendje!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA -Ju faleminderit! Në emër të AKK-së,
deputeti Ymer Halimi

DEPUTETI YMER HALIMI - Ju faleminderit z. kryetar Berisha! Të nderuar ministra
dhe deputetë.

Në përpjekjet e Qeverisë për të pasur infrastrukturë ligjore të mjaftueshme në Kosovë
bën pjesë edhe Projektligji për shndërrimin e poseduesve të paluajtshëm privat në
pronarë. Ky Projektligj është mjaft i rëndësishëm në fazën e zhvillimit që ne jemi.
Projektligji ka gjithsej 9 nene dhe është i ndërlidhur me ligjet e tjera, e veçmas me
Ligjin për kadastrë.

Mendoj te emërtimi i titullit është më e drejtë që në vend të fjalës: "palujtshmërive" të
zëvendësohet me fjalën: "patundshmëri" që është e përdorshme dhe e saktë në gjuhën
shqipe e veçmas për rastin tonë konkret. Një vëllim kaq të pakët të tekstit të këtij
Projektligjit nuk zë vend të rëndësishëm ndonjë gabim gjuhësor apo ndonjë termë
joadekuate.

Me thënë të drejtën kur në Komision ku edhe unë jam aty kemi diskutuar për këtë ligj
paraprakisht dhe për shumë çka që thanë dy parafolësit e mi, jemi dakorduar mirëpo,
megjithatë e kemi parë shumë të udhës që këtij ligji t'i japim mbështetje, prandaj Grupi
Parlamentar i AKK-së jep mbështetje që Projektligji në fjalë të kalojë në procesin e
scancës së Kuvendit dhe si grup parlamentar do të japim një kontribut të rëndësishëm
gjatë shqyrtimit në Komision. E përgëzojmë hartuesen për punën e bërë në këtë
Projektligj dhe besoj se ne do të kompletojmë edhe më shumë po qe se ka nevojë. Ju
faleminderit për vëmendje!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA -Ju faleminderit! Në emër të ORA,
deputetja Teuta Sahatqija

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA -Ju faleminderit z. kryetar! Duke pasur parasysh
që në kohërat të mëparshme, prona private nuk e ka pasur një trajtim adekuat dhe se
pronarët sot e kësaj dite të quhen posedues, mendojmë se përmes këtij ligji do të duhej
që prona private të ketë një qasje më serioze dhe të trajtohet në mënyrë të veçantë.
Gjithsesi pajtohemi me parafolësit që gjatë shndërrimit të poseduesve në pronarë do të
duhet të kihet një kujdes i veçantë dhe para se të bëhet shpallja e pronarit, të kalojë në
një procedurë pak më serioze dhe të definohet se ajo pronë, ajo palujtshmëri apo
patundshmëri të shikohet se a është fituar në mënyrë legale apo jo dhe pas saj të
shkohet me shndërrimin e posedimeve në pronësi.

Ne mendojmë si grup parlamentar që këtij Projektligji t'i jepet vija të vazhdon në
procedim në Komisionin FunkSIONAL dhe të gjithë kontributin dhe punën tonë do ta
japim përmes përfaqësuesit tonë në Komision FunkSIONAL. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA -Ju faleminderit! Në emër të Grupit 6+
deputeti Xhezair Murati

DEPUTETI, XHEZAIR MURATI - Dëpëzvolite da vas pozdravim g. Pëdседниçe, kao i prisutne ministre i kolege poslanike.

Poslanici Parlamentarne grupe 6+ su razmotrili Nacrt zakona o postavljanju posednika privatne nekretnine na vlasnike, prije svega raçunajuçi da će se u praksi eliminisati dosadašnje slabosti koje su nasljedjene iz prethodnog sistema i da će se konstituisati realno stanje prava nad nepokretnom imovinom na Kosovu, a koji je neophodan i za pravilno i potpuno sprovođenje Zakona koji regulišu ovu materiju, ako muzmemo u obzir činjenicu da su u ovom nacrtu inkorporirani i principi, odnosno propisi po savremenim standardima Evropske zajednice.

Poseban znaçaj i uloga ovog Zakona će biti u tome, što će na osnovu propisa istog zakona svi nosiosci prava na nekretninama moçi registrovati kaoa vlasnici u svim slučajevima u kojima to do sada nisu mogli da učine u nedostatku zejlišnih knjiga i javnih registara na Kosovu.

Parlamentarna grupa 6+ ima primedbe na ovaj Nacrt, ali ukoliko smo mi propustili da iste te nedostatke, ja se nadam da će poslanici iste uviditi i izvršiti sugestiju na njihvu obeveznu ispravku. Ovaj Zakon će za gradjane Kosova imati veliki znaçaj, jer će se konstituisati njima pravo svojine kao najvašnije stvarno pravo koje predstavlja najpotpuniju pravno vlast nad stvarnima i da će nesmetano moçi da iste poseduju, koriste i raspolazu njima bez obzira na razlike po bilo kom osnovu. Medjutim, postavlja se dilema da ukoliko sugestije i amandmani budu brojni i sadržajni od samog Nacrta zakona, kako već je i ovdje reçeno usvojiti ga ili dograditi, to je jedana dilema koje mi postavljamo. Havalava Vam na pažnji!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Në emër të Grupit Për Integrim – Gjergj Dedaj

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit shumë z. Kryetar! Padyshim se çështja e pronës, krahas së drejtës për jetë dhe të drejtave të tjera elementare, është një e drejtë e pazëvendësueshme e cila duhet të respektohet, prandaj edhe Grupi Parlamentar për Integrim në parim i jep mbështetje leximit të parë të këtij Projektligji me shpresë që Komisioni Funkcional do t'i marrë parasysh vërejtjet që i dhanë përfaqësuesit e grupeve të ndryshme parlamentare dhe leximin e dytë do të na vijë i kompletuar me të gjitha këto vërejtje. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Meqenëse nuk ka tjetër të paraqitur për diskutim, lus regjinë dhe deputetët të përhatitemi për votim. Në sallë janë momentalisht 81 deputetë.
Votojmë, tash!

Për..... 73 dhe
Kundër 2.

Miratohet Projektligji në parim.

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Punën

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 19 tetor 2006 dhe janë përmbushur të gjitha kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin Ibrahim Selmanaj ta paraqesë Projektligjin.

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë, më lejoni ta paraqes Projektligjin e punës në Kosovë, sponsorues i të cilit është Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale. Do të përpiqem që para jush të paraqes një ekspozitë të shkurtër, që mendoj që do të jetë e nevojshme me ca shpjegime që të ofrojë mundësi të njihemi më për së afërmi.

Aktualisht në Kosovë është në fuqi Rregullorja nr. 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës, përmes së cilës rregullohen çështjet e punësimit në Kosovë, marrëdhëniet e punës dhe raportet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, në procesin e punës.

Rregullorja e cila është në fuqi nr 2001/27 ka gjithsej 28 nene, në të cilën ekzistojnë zbrazëtira juridike .Kjo rregullore është e mangët në rregullimin e shumë çështjeve nga e drejta e punës dhe krijon probleme praktike në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të punëtorëve. Për shkak të rëndësisë së marrëdhënieve të punës dhe mbrojtjes në punë, Ligji duhet t'u përshtatet kushteve në tregun e punës, politikës sociale e ekonomike të Kosovës dhe standardeve evropiane.

Kontestet e shumta nga marrëdhënia e punës u shkaktojnë dëm punëtorit dhe punëdhënësit, prandaj, mospërmbushja e kushteve ndaj punëtorit, mos përmbushja e kërkesave të tij ,krijojnë pakënaqësinë e tyre e cila shkakton në shoqëri probleme të shumta. Për shkak të këtyre mangësive në MPMS, kanë ardhur një numër i konsideruar i kërkesave nga ana e punëmarrësve dhe punëdhënësve si dhe organizatave të tjera të interesit që kërkojnë ndihmë për interpretimin dhe sqarimin e dispozitave juridike nga Rregullorja në fuqi.

Duke pasur parasysh kërkesat e shumta dhe nevojën emergjente për nxjerrjen e një Ligji bazik që rregullon marrëdhëniet e punës, mbrojtjes dhe sigurisë në punë, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, doli iniciativa legjislative për hartimin dhe procedimin e këtij Ligji në Qeveri i cili më pastaj u përfshi në strategjinë legjislative të Qeverisë së Kosovës për vitin 2006.

Kosova po kalon nëpër një periudhë mjaft të rëndësishme transformuese, prandaj për një kohë të caktuar duhet të krijohet infrastrukturë ligjore bazike në marrëdhëniet e punës, mbrojtjes dhe sigurisë në punë, të mbrojtjes sociale ,shoqërore dhe ekonomike për punëmarrësit dhe punëdhënësit.

Nuk mund të këtë demokraci të vërtetë dhe nuk mund të këtë zhvillim ekonomik –social në një vend nëse mohohen të drejtat e punëtorit. E drejta në punë dhe mbrojtja në punë është e drejta e secilit, parim i cili mbrohet edhe me konventat ndërkombëtare duke përfshirë këtu edhe Organizatën Ndërkombëtare të Punës – ILO-së.

Të nderuar deputetë,

Ligji i propozuar përbëhet prej 13 kapitujve që gjithsej kanë 124 nene ;

Dispozitat e dhëna në Projektligjin e punës në tërësi, ofrojnë qasje të përshtatshme nga marrëdhënia e punës dhe mbrojtjes në punë, duke pasur parasysh situatën e përgjithshme sociale e ekonomike në vend. Lidhur më këtë ekziston edhe vlerësimi i ekspertëve të ILO-së, të cilët Projektligjin e kanë vlerësuar shumë lartë,

Qëllimi i këtij Projektligji është të rregullohen të drejtat ,detyrat dhe përgjegjësitë e punëdhënësve dhe të të punësuarve nga marrëdhënia e punës dhe të sigurojë:

- Zbatimin e drejtë të konventave dhe rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës .
- Forcimin e punës së shërbimit të inspektoratit të punës për eliminimin e tregut ilegal të fuqisë punëtore, respektivisht punën jo formale,
- Krijimin e baraspeshës për sigurimin e të drejtave dhe interesave në mes të punësuarve dhe të punëdhënësve.
- Evitimin e dukurive negative nga marrëdhënia e punës, dhe eliminimin e shume padrejtësive në proceset e punës, veçmas në sektorin privat,
- Kushtet optimale për krijimin e organizatave të interesit për të punësuarit dhe punëdhënësit e tyre ,
- Si dhe avancimin e të drejtave dhe beneficioneve të tjera nga marrëdhënia e punës.

Duke pasur parasysh qëllimin e Ligji të punës si ligj bazik ai krijon, mundësinë e krijimit dhe zbatimit të ligjeve detyruese siç janë: Ligji për Inspektoratin e Punës, Ligji për siguri dhe Mbrojtje në Punë, Ligji për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen e të papunësuarve, Ligji për Greva, Ligji për të drejtat dhe liritë e organizimit Sindikal, Ligji për evidentimin e të punësuarve, Ligjin për punësimin e shtetasve të huaj si dhe ligjet tjera që rregullojnë segmente të caktuara nga fusha e punës dhe punësimit.

Të nderuar deputet[ë

Siç thamë më lartë Projektligji i punës është i strukturuar në 11 kapituj të përfshirë me 124 nene,

Në këtë strukturë përmbajtësore të Projektligjit janë paraparë të rregullohen çështjet më të rëndësishme nga puna dhe punësimi , siç janë: dispozitat themelore nga marrëdhënia e punës, mënyrat e themelimit të marrëdhënies se punës, orari i punës, punësimi dhe mungesat në punë, mbrojtja dhe siguria e të punësuarve në pune, ndërprerja dhe përfundimi i punësimit, proceduarat administrative për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia dhe shume çështje tjera të cilat janë të domosdoshme për rregullimin e raporteve në mes të punëdhënësit dhe të punëmarrësit,

Nëse e keni parasysh këtë përmbajtje të Projekt-ligjit, lirisht mund të vlerësojmë se Projekt-ligji për punë, i cili është para jush për shqyrtim, është në harmoni me zgjidhjet më të reja konceptuale dhe aktualisht të zbatueshme në vendet në transicion si dhe në përputhje më nivelin e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe social të vendit tonë. Duke miratuar Projekt-ligjin për Punë në Kosove, në do të krijojmë një baze solide ligjore edhe për shume aspekte tjera të nevojshme të kësaj fushe, e cila më akte nënligjore të cilat do të hartohen më pas e bëjnë plotësisht të implementueshëm.

Duke pasur parasysh strukturën përmbajtësore të këtij Projektligji ,si dhe vlerësimet e bëra në debatet e zhvilluara, Projektligji i cili sot gjendet para jush mendojmë se do të jetë një ligj i qëndrueshëm, funksional, i arritshëm dhe i zbatueshëm në praktikë ,

Të nderuar deputetë ,

Në hartimin e Projektligjit për punë , përveç zyrtarëve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kanë marrë pjesë edhe partnerët socialë përkatësisht, përfaqësuesit e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Odes Ekonomike të Kosovës si dhe zyrtaret tjerë qeveritarë, të cilët duke përfaqësuar qëndrimet e grupeve të tyre të interesit në mase të konsiderueshme kanë ndikuar në cilësinë e Ligjit ,

Në fund shpresoj se ky Projektligj do të begatohet dhe pasurohet më tepër, pas diskutimit, më rekomandimet tuaja të cilat janë të mirëpritura për çka paraprakisht ju falënderoj .

Ju faleminderit për vëmendje .

KRYESUESI , GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit z. ministër ! Në emër të Grupit Parlamentar LDK – deputetja Nafije Berisha le te përgatitet Flora Brovina

DEPUTETJA NAFIJE BERISHA - I nderuari kryesues, të nderuar qeveritarë dhe kolegë të nderuar.

Projektligjin e punës Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës le që e ka shqyrtuar me vëmendje, por edhe e ka mirëpritur.

Ne jemi të vetëdijshëm, por edhe ju z. ministër, në pjesën hyrëse të Projektligjit e keni pranuar dhe e keni cekur se ka shumë probleme në terren, në raportin në mes punëdhënësit dhe punëmarrësit , sidomos në sektorin e ekonomisë së vogël dhe të ekonomisë së mesme dhe në sektorin privat. Pra, puna është një e drejtë themelore e çdo njeriu. Pse është aq e rëndësishme për të pasur punë, puna na jep të ardhura dhe kjo na jep të ardhura dhe kjo na bënë të pavarur nga të tjerët. Prandaj, puna na jap edhe lirinë. Në punë ne i përdorim aftësitë tona dhe merremi me diçka për të cilën jemi të interesuar. Në këtë mënyrë, pra ,puna na zhvillon. Kur punojmë ndihemi të dobishëm, sepse ne krijojmë diçka që u duhet të tjerëve. Puna na jap të drejtë përderisa i japim diçka shoqërisë, ndiejmë se kemi të drejtë edhe të kërkojmë nga ajo. Nëpërmjet punës hyjmë në lidhje me shoqërinë dhe me të tjerët. Provojmë të ndiejmë ndjenjën e respektit që kanë ata për ne, dhe se i përkasim një grupi. Përderisa është kaq e rëndësishme të kesh punë, që të jep të ardhura, është shumë e natyrshme kërkesa e punëmarrësve dhe e punëdhënësve nëse që çrregullimi i marrëdhënieve të punës të bëhet me ligj si e drejtë e domosdoshme e zhvillimit të demokracisë dhe zhvillimit ekonomiko-social.

Projektligji i cili është sot në shqyrtim dhe titullohet diku- diku gjatë tekstit si Ligj për punë, diku ligji mbi punën ngërthen në vetvete të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga puna dhe marrëdhënia e punës në Kosovë dhe i vë në funksion ligjet e tjera nga kjo fushë siç janë: Ligji i grevës, Ligji për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal, Ligji për nxitjen e punësimit , për mbrojtjen e të papunësuarve, si edhe ligjet e tjera, si dhe e vënë në funksion vetë Inspektoratin e punës, i cili është themeluar në fillim të mandatit të krijimit të institucioneve vetëqeverisëse në Kosovë, por deri më sot ai ka nuk ka funksionuar pa një Ligj të punës.

Në 120 nene të këtij ligji, në të cilin ka vend që disa çështje të sqarohen dhe të përcaktohen më mirë, kryesisht janë në pajtim me konventat ndërkombëtare dhe me parimet themelore që janë objekt i këtyre konventave siç është: liria e asociimit, njohja

efektive e të drejtës për bisedime kolektive , eliminimi i çdo forme të punës së detyruar, zhdukja efektive e punës së fëmijëve dhe eliminimi i diskriminimit në punë dhe në profesion.

Të drejtat , detyrat dhe përgjegjësitë nga pika dy e këtij nenit, të cilat përcaktohen përmes këtij ligji ose ligjeve të tjera të veçanta, kontratës kolektive, akteve të brendshme të organizatave si dhe kontratës së punës, këto janë të gjitha akte shumë të rëndësishme, sidomos për punëmarrësin e domosdo se ky Ligj duhet të reflektoj bazën e këtyre akteve në vetë Ligjin e punës.

Ne si grup parlamentar kemi disa vërejtje për nene të ndryshme të këtij Projektligji dhe kontributin tonë do ta japim përmes amendamenteve në Komisionin Funkcional dhe për ta kursyer kohën tuaj si dhe për t'u dhënë mundësi deputetëve të tjerë që edhe ata të shprehin amendamentimet dhe plotësimet e këtij Projektligji.

Grupin parlamentar, gjithashtu e shqetëson fakti sepse në deklaratën financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ceket se, në projektbuxhetin e vitit 2007 nga Ministria e Punës nuk ka kërkesë për implementim të këtij Projektligji. Gjithashtu, edhe kostoja e Projektligjit diku prej 24 milion €, kurse nga disa bisedime dhe që i kemi bërë ne si Komision me Ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale ai deklaroi se diku kostoja e implementimit të këtij Projektligji është diku është 12 milion €. Kështu që nuk kisha dashur që kostoja shumë e lartë ta bëjë të pa implementueshëm këtë Projektligj edhe nëse ky kalon edhe në lexim të dytë në këtë Parlament. Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah këtë Projektligj dhe do të bëjë çmos që ky sa më shpejt të përfundoj dhe të amendamentohet konform të drejtave të punëmarrësve sidomos. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI - Në emër të Grupit Parlamentar Zahrije Jusufi, le të përgatitet Fatmire Mulhaxha-Kollçaku

DEPUTETJA ZAHRIJE JUSUFI – I nderuari kryesues, të nderuar ministra dhe deputetë.

Projektligji për punë është projektligj i vonuar. Ky Projektligj është bazik për rregullimin e të drejtave dhe përgjegjësi të të punësuarve dhe të punëdhënësve. Projektligji është i domosdoshëm ngase Rregullorja në fuqi mbi Ligjin themelor të punës nr. 2001/7 ka zbrazëti të shumta dhe nuk i zbaton dispozitat ligjore të punësimit, marrëdhëniet e punës dhe raportin punëdhënës i punësuar.

Sipas deklaratës së Ministrisë së Financave, Ekonomisë , Projektligji ka implikime të mëdha financiare me një kosto të lartë për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenës Sociale nuk i ka paraqitur vlerësimet për kostot e disa neneve që do të shkaktonin rritjen e kostos totale të Projektligjit dhe se pa përlogaritjen reale nga ekspertët e Ministrisë se Ekonomisë dhe Financave dhe të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, të implikimeve buxhetore , të zbatimit të Projektligjit, Projektligji mund të pësojë fatin e Projektligjit për Sigurime Shëndetësore. Në përgjithësi bazuar në situatën ekonomike dhe sociale Projektligji do të sigurojë mbrojtje dhe siguri më të madhe për punonjësit dhe punëdhënësit sesa Rregullorja në fuqi. Për të qenë Projektligji i zbatueshëm dhe funksional kërkon interpretim dhe sqarim të disa dispozitave nga se disa dispozita mund të kenë interpretim të dyfishët. Mendojmë se disa nene të Ligjit kanë mangësi dhe se duhet të plotësohen. Do t'i veçoja disa nene:

Nenit 4,2 për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë, duhet t'i shtohet: " Femrat e punësuarra kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë gjatë kohës së shtatzënësisë, lindjes dhe gjidhënies"

Nenit 39.1 duhet t'i shtohet dhe kohëzgjatja e mungesës nga puna pa shpërblim .
Nenet 42.7 dhe 9 duhet të sqarohen, se janë të paqartë.

Në nenin 44. 3 duhet të specifikohen të drejtat e femrës për punë gjatë gjidhënies si dhe ndalesat absolute të ekspozimit ndaj agjentëve kemikë dhe nga ndalesat e tjera për marrëdhënie të punës

Neni 49.3 për të punësuarit me gjysmë orari të punës, për gjysmën tjetër të orarit të plotë të punës bëhet në pajtim me dispozitat e veçanta, në mungesë të fondit për sigurimet shëndetësore dhe në mungesë të fondeve sociale. Kjo dispozitë është e pamjaftueshme për të siguruar mbrojtje dhe siguri për punëtorët dhe se duhet të përshpejtohet Ligji për sigurime shëndetësore dhe për sigurime sociale.

Neni 56.3, duhet të hiqet

Neni 60 është i mangët. Me këtë dispozitë i punësuarit ka të drejtë për kompensim të pagës gjatë kohës së mungesës nga puna për shkak të paftësisë së përkohshme dhe në rast të fatkeqësisë në punë ose të sëmundjes profesionale deri 30 ditë brenda një viti. Në mungesë të Ligjit për sigurime sociale dhe të Ligjit për sigurime shëndetësore, por as këtu nuk sigurohet mbrojtja e punëtorëve kur paftësia zgjat më shumë se 30 ditë.

Neni 70 për lëndimet në punë ose lidhur me punën, nëse i punësuarit pëson lëndime në punë, punëdhënësi është i obliguar t'ia kompensojë dëmin. Ky nen duhet të plotësohet dhe qartësohet. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, Projektligjin e miratojmë në parim, në shqyrtim të mëtejshëm do ta plotësojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit! Kërkoj falje Fatmire radhën e ka deputetja Zylfije Hondozi në emër të Aleancës, mandej Ju.

DEPUTETJA ZYLFIJE HONDOZI - z. Kryesues, z. ministër, deputetë të nderuar.

Ky ligj është i domosdoshëm për rregullimin e sferës së punësimit e cila gjer më tani është rregulluar me Rregullore, që ka pasur mangësi të shumta. Mangësitë juridike të këtij ligji kanë mundësuar të bëhen diskriminime të llojllojshme të punëtorëve në Kosovë duke i dëmtuar ata në çdo aspekt. Pas një kohe të gjatë Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e ka hartuar Projektligjin për punë, i cili rregullon në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjet në sferën e punës.

Raportet ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, kushtet e sigurta dhe mbrojtja e punëtorit në punë, eliminimi i diskriminimit të çdo lloji dhe shumë çështje të tjera me rëndësi të kësaj sfere.

Shumë me rëndësi është se me këtë projektligj rregullohen edhe pushimet e lehonisë, çështje të cilat gjer me tani nuk i ka rregulluar asnjë ligj dhe me këtë po përmbushen premtimet e dhëna shumë herë nga Qeveria për rregullimin e kësaj çështjeje. Ky projektligj është ndër projektligjet më të mira, të cilat kanë kaluar nëpër Komision dhe Mirëqenie Sociale, ndoshta një vështirësi në zbatimin e tij do të paraqitet për shkak të kostos së lartë, mirëpo Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale duhet ta ketë

prioritet zbatimin e këtij ligji, se paraqet investim të mirë për të ardhmen e Kosovës. Është shumë me rëndësi të rregullohet puna dhe çështjet e punësimit në mënyrë të duhur se puna është ajo që duhet krijoj prosperitet ekonomik dhe mirëqenie sociale. Të gjithë e kemi kuptuar dhe shumica e popullatës Kosovare e ka përjetuar se çka do të thotë të jesh pa punë, për individin dhe shoqërinë në përgjithësi pas dëbimit masiv nga puna, të gjithë shqiptarë dhe në vitet e '90-ta. Pasojat e atij diskriminimi vërehen edhe në ditët e sotme. Po kam pyetje për ministrin dhe mbetet e paqartë, një pjesë e deklaratës financiare, ajo e pikës 6 ku thuhet: "Meqenëse jemi në fazën e paraqitjes së buxhetit të Kosovës për vitin 2007-2009, në fazën përfundimtare të dëgjimeve buxhetore për këtë projektligj nuk kemi kërkesa për financim as nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo nga ndonjë organizatë tjetër buxhetore". Tash çka do të thotë kjo, a ka Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale të holla të mjaftueshme për implementimin e këtij ligji apo d.m.th duhet të shpjegoj pse janë nuk është parashtruar kërkesë për mjete financiare. Pas përgjigjes së Ministrit, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do të tregojë a është për miratim në parim apo jo. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHETI - e ka fjalën Ministri

IBRAHIM SELMANAJ, ministër – Ju faleminderit z. kryesues. Jam i obliguar të bëjë sqarime pse nuk ka paraqitur Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale një kërkesë që të financohet ky ligj dhe të fillojë së zbatuari. Në radhë të parë është shqyrtimi i parë i Projektligjit dhe si procedurë nuk e kemi pasur edhe një mundësi tjetër që të bëjmë një paraqitje, sepse nuk e dimë se si do të jetë rrugëtimi tutje për Projektligjin. Kjo është e para dhe çështja e dytë është se me sugjerimet që dalin nga partnerët që janë Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore e shohin si ligj i cili ka implikime të larta buxhetore dhe në fakt edhe të mos procedohet deri këtu ku ka ardhur Projektligji. Prapëseprapë, e përkrahjen që të tria prej deputetëve, Ministria e Punës së Bashkuar me Ministrinë e Financave, do të bëjë të pamundurën të fillojë së zbatuari Projektligj, d.m.th. nuk ka pare realisht.

KRYESUESI – GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit zotëri ministër për këtë shpjegim. E ka fjalën deputetja Fatmire Mulhaxha – Kollçaku, le të përgatitet deputetja Shpresa Murati në emër të Grupit 6+.

DEPUTETJA – FATMIRE MULHAXHA – KOLLÇAKU,

Ju faleminderit zoti kryesues!

Pas fjalës së ministrit gjithmonë të përfundojmë sa shpresëdhënës është miratimi sot këtu i këtij ligji. Gjithashtu edhe puna që na pret në Komision, dhe në fund të na ndodhë ajo që, po ndodh edhe tani me ligjet e tjera. Kemi ligje në letër, por ligje që nuk janë të implementuara. Megjithatë unë i falënderoj Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie për përpjekjet e veta, për hartimin e këtij projektligji, se kjo ishte edhe një shtytje edhe nga Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie, ku ne nuk i kemi proceduar dy projektligje që kanë qenë: Projektligji për të drejtat e organizimit sindikal dhe për greva, duke kërkuar nga Ministria që paraprakisht ta paraqesë këtu në Kuvend Ligjin për punë. Tanimë e kemi këtu këtë ligj.

Në Kosovë, siç është e njohur deri tani, në fuqi është Rregullorja mbi Ligjin themelor të punës, e cila jo vetëm që nuk e rregullonte sa duhet këtë problematikë, por edhe nuk zbatohet.

Sa i përket asaj se nuk zbatohet që vetëm një vendim t'ju sjellë këtu para gjithë qytetarëve të Kosovës, ta shihni, prej 1 janarit të vitit 2003. deri në këtë kohë 5 vendime u janë lëshuar një mjek në spitalin regional "Isa Grezda" në Gjakovë, i cili punon aty prej vitit 1988 dhe shumë vite më parë është diskriminuar nga ish-regjimi, ndërsa sot diskriminohet nga drejtoresha aktuale, e cila çdo 6 muaj ua përtrin kontratat specialistëve që janë edhe deficitarë për Kosovë.

Prandaj, një arsye më tepër që me gjithat ta votojmë në parim. Kjo nuk është kontratë e vetme, këso kemi iks(x) në Kosovë, këtë e kam parashtruar edhe para kryeministrit. Fillimisht kur e kam marrë detyrën, se nuk shkelet vetëm rregullorja, po Rregullorja për shërbyes civilë, udhëzimet e administrative, etj. do të thotë se është e nevojshme që kjo problematikë të rregullohet më në fund. Megjithatë, zotëri ministër, këtu e shohim një grup punues, ku vetëm tre emra figurojnë për tjerë përfaqësues thonë. Ndoshta, meqenëse keni thënë se është model slloven, por e kam pasur edhe kopjen e modelit kroat, në duar dhe të mos them se është kopjuar, por pjesa më e madhe është marrë nga ligji kroat dhe ndoshta edhe arsyeja për mos i cekur emrat, shtrohet dilema a kanë qenë ata të inkorporuar në grupin punues, se është shumë e vlefshme t'i kemi emrat e individëve të cilët i kanë përfaqësua institucionet që këtu përmenden Atëherë e dimë a është përfillur edhe fjala e sindikatave, d.m.th. se ky ligj nuk ka implikime, ka për punëdhënës, por shumë më tepër ka edhe për ata që kërkojnë dhe që sot janë aktualisht të punësuar, që t'u mbrohen të drejtat e tyre.

Ligji me të vërtetë pretendon ta rregullojë një problematikë dhe ka vend që Komisioni funksional të intervenojë mjaft. Për këtë i kemi modelet siç i përmenda, sepse shumë gjëra janë larguar, të cilat shkojnë në favor të njerëzve që punojnë sot në Kosovë dhe nuk do të jetë ndoshta problem i madh që të inkorporohen. Megjithatë shtrohet pyetja, siç e përmendëm edhe në fillim, implikimet buxhetore. Neve na nevojiten ligjet që do të jenë të implementueshme. Prandaj, ne të gjithë duhet të shikojmë më në fund që të jetë ministri i Financave, së paku prezent kur votohen ligjet siç është ky dhe të na i jep përgjigje siç e cekëm për fondin për sigurim shëndetësor e shumë fonde të tjera që sot në Kosovë nuk mund të formohen, sepse nuk kemi marrë asnjëherë përgjigje zyrtare nga numri një sot në Kosovë, që duhet të na thotë, kur dhe si do të krijohen fondet në Kosovë, sepse ato është pikëpyetje për të gjithëve neve, pengesat të cilat ne sot vetëm mund të dyshojmë edhe cilat janë ato?

Zotëri ministër, ne e përsërisim, megjithatë, përpjekjen tuaj ne si Komision do t'ju ndihmojmë ta kalojmë edhe pse ndoshta fillimisht në letër, ndërsa si grup parlamentar ORA, duke i pasur parasysh të gjitha këto mangësi që sot janë dhe që nuk respektohen as ligjet dhe rregulloret që janë në fuqi, megjithatë përsërisim votimin në parim dhe të shohim për më tutje. Ju faleminderit!

KRYESUESI – GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit! Fjalën e ka fjalën deputetja Shpresa Murati në emër të Grupit 6+, le të përgatitet deputetja Sanije Alijaj.

DEPUTETJA – SHPRESA MURATI

Hvala! pozdravljam predsednika i sve poslanike, poznavanje osnovnih prava radnika i poslodavaca, i je preduslov za regulisanje radnih odnosa, sloboda rada je pravo svakog, na čelo kojeg se brani Međunarodnom konvencijom rada. Nacrt zakona o radu kao osnovni zakon zajedno sa Nacrtom zakona o štrajku i Nacrtom zakona o Pravima i slobode organizovanog sindikata, koji su na čelu suvojeni i nalazi se u Skupštinskoj proceduri, kao i drugi zakoni koji regulišu određene segmente iz oblasti zapošljavanja, popuniće zakonsku prazninu u oblastima koji ovi zakoni pokrivaju.

Nacrt zakona o radu reguliše prava, obaveze i odgovornosti poslodavca i radnika. Odredbama ovog predloga zakona zabranjuje se svaka vrsta diskriminacije na radu, zabranjuje se nasilni ili prinudni rad, pojedinim odredbama reguliše se i zasnivanje radnog odnosa raspored rada odmor i zastanci, zaštita na radu, zaštita žena mladih i osoba sa ograničenim sposobnostima, odnosno kategorije koje imaju pravo na posebnu zaštitu. Moramo naglasiti kao veoma važne odredbe koje se tiču žena tokom trudnoće, u porodiljskom odmoru, ili žena koje imaju decu ispod 3 godine, koji imaju sva prava koje su u skladu sa međunarodnim standardima.

Treba naglasiti i poglavlje 12, koim se u ređuje nadzor za sprovođenje odredaba ovog zakona, koji se vrši od strane izvršne agencije inspekcije rada. Dakle radi se o predlogu zakona koji je sveobuhvatan, koji detaljno reguliše pitanje iz ove oblasti, i koji se zbog svoje važnosti mora prilagoditi uslovima na tržištu rada i socijalno ekonomskoj politici Kosova.

Parlamentarna grupa 6+, unafelo podržava ovaj predlog Zakona, i ako je po prilično obiman, sadrži 124, člana, nadam se da neće zahtevati previše vremena i angažovanje funkcionalne Komisije, u toku njegovog daljeg razmatranja, do usvajanja s obzirom na značaj i neophodnost ovog zakona, koji, a cilj svih nas je usvajanje zakono sprovodljivo u praksi. Hvala!

KRYESUESI – GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit! E ka fjalën deputetja Sanije Alijaj, le të përgatitet deputetja Flora Brovina,

DEPUTETJA – SANIJE ALIAJ

I nderuar zotëri kryesues, i nderuar ministër, të nderuar kolegë deputetë!

E drejta për punë në rrethanat e reja të neveçanërisht në kushtet kur Kosova ndodhet nën administrimin ndërkombëtar, po kalon nëpër një krizë e cila jo vetëm që është rezultat i mungesës së një legjislacioni të mirëfilltë, nga fusha e marrëdhënieve të punës, por është edhe rezultat i ndryshimit të vetë konceptit të marrëdhënies së punës.

Ky koncept i ri këto pikëpamje të reja dhe çështjet e tjera, që janë lidhur me marrëdhënien e punës, përkatësisht me ndryshimet që janë bërë në sistemin e marrëdhënies së punës, siç janë: themelimi i marrëdhënies së punës, mbrojtja e punëtorëve në punë, përgjegjësia e punëtorëve, mbrojtja e të drejtave të punëtorëve etj., janë objekt trajtimi i këtij projektligji, që i referohet një grupi të veçantë të marrëdhënies shoqërore, përkatësisht të marrëdhënies së punës.

Rregullorja për Ligjin themelor të punës 2001/27, ka qenë e mangët në rregullimin e çështjeve nga e drejta e punës dhe krijonte probleme praktike në mbrojtjen dhe në realizimin e të drejtave të punëtorëve.

Prandaj neni 4. i këtij projektligji, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarit, garanton të drejtën për pagë, mbrojtje, siguri në punë, sigurimin pensional e invalidor,

sigurimin shëndetësor në pajtim me Projektligjin dhe kontratën kolektive, gjë që sipërfaqësisht realizohej deri më tani.

Duke u nisur nga fakti se e drejta për punë dhe liria në punë janë të garantuara me konventat e organizatës ndërkombëtare të punës, Projektligji u është përshtatur kushteve të tregut të punës, politikës sociale ekonomike në Kosovë, mbrojtjes të të drejtave përmes organizimit sindikal, në harmoni me standardet evropiane, duke e ndaluar diskriminimin në punësim dhe në profesion, qoftë i drejtpërdrejtë, apo i tërthortë, ndaj të punësuarit e në veçanti ndaj femrës shtatzënë, apo pas lindjes.

Vlen për të theksuar se me këtë projektligj ndalohet puna e dhunshme, apo e detyruar e të punësuarit, në veçanti tek fëmijët që është pasqyrë e zymtë e realitetit tonë. Që fëmijët në vend që t'i rrekën mësimin apo të gëzojnë fëmijëri të mirë, detyrohet të bëjë lloj - lloj punë për t'i siguruar kushtet elementare për vete, por ndoshta edhe për familje. Në rrugën e zhvillimit të saj, puna është trajtuar si pjesë e përgjithshme e gjendjes së vështirë, të shumicës së njerëzve, burim i mundimeve, tensioni shpirtëror. Mirëpo në kushtet bashkëkohore të punës, puna i humb elementet e presionit dhe gjithnjë e më shumë bëhet pjesë qenësore e personalitetit të njeriut, e sidomos kur plotësohen standardet, për funksionim të mirëfilltë të infrastrukturës ligjore, duke krijuar kushtet e mira për punë.

Prandaj dispozitat e kapitullit të dytë, të këtij projektligji i trajtojnë të analizojnë problemet kyçe dhe çështjet themelore të lidhura me marrëdhënien e punës, duke filluar nga lidhja e kontratës së punës, karakteri i punës, punësimi dhe puna provuese. Me këtë rast, do të theksoja se verifikimi paraprak, nga Komisionet i aftësive të punës përmes punës provuese, mendoj se rritë konkurrencën e mirëfilltë, dhe përgjegjësinë e të punësuarit dhe punëdhënësit.

Kapitulli 4, pushimet dhe mungesat, është pjesë thelbësore e këtij projektligji, sepse në fazën e parë të privatizimit, shumë afaristë janë pasuruar, duke e shfrytëzuar në mënyrë të pakontrolluar mundin dhe dijen e punëtorit, pa e shpërblyer në mënyrë të merituar punën e tij.

Një fjalë thotë: "ujku do mjegull"! Por miratimi i këtij projektligji do të rregullonte në thelb këtë çështje.

Me nenin 47.2. pushimi i lehonisë, femra i gëzon pushimin prej 6 muajsh, dhe paguhet 3 muajt e parë nga punëdhënësi, e tre muajt tjerë nga buxheti i Qeverisë, së Kosovës 70% të pagës. Propozoj, që këtë të drejtë ta gëzojë nga punëdhënësi, njëkohësisht nëna, pas përfundimit të pushimit të lehonisë, ta gëzojë punën me orar të shkurtuar deri sa fëmija t'i mbush 1 vit se të gjithë e dimë se prioritet është të rrisim fëmijë e shëndoshë.

Në fund të do theksoja, nëse punëdhënësi dhe punëmarrësi e zbatojnë ligjin me përgjegjësi, si dhe inspektori i punës duke bërë dhe duke i zbatuar dispozitat e këtij ndëshkimore të këtij projektligji, e bënë kontrollimin dhe plotësimin e kriterëve, të kërkuara me këtë ligj, lenë shpresë se në Kosovë, do të zhvillohet një ekonomi e tregut të lirë, ku respektohen të drejtat, të detyrat dhe detyrat e punëtorit. Projektligji mbi punën është ligj bazë që së bashku me ligjet e tjera të kësaj lëmie që do të hartohen, do të plotësojnë komizën ligjore në këtë lami shumë të domosdoshme. E përkrah në parim në radhë të parë se rregullon të drejtën në punë që është burim për një jetë më të mirë, por edhe se është në harmoni me ligjet e BE-së.

Projektligjin e përcjell një kosto e lartë financiare, por duke e ditur rëndësinë e madhe të këtij projektligji, Qeveria duhet krijuar kushtet për implementimin e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI – GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit! E ka fjalën deputetja Flora Brovina, le të përgatitet deputi Ramadan Kelmendi.

DEPUTETJA- FLORA BROVINA

Ju faleminderit, e drejta e punës është një e drejtë elementare e njeriut dhe këtë të drejtë sigurisht që duhet mbrojtur edhe me ligj. Deri tani, në mungesë të këtij ligji, kjo çështje nuk është rregulluar për 7 vite, pas luftës dhe Rregulloren e UNMIK-ut, për punën. Dhe kujtoj se ka qenë presioni i të punësuarve dhe i anëtarëve të Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi, që kemi bërë në Ministrinë për Mirëqenie Sociale, që të nxjerrë më në fund ligjin për punën. I falënderoj ministrin dhe Ministrinë që ligji është para nesh, sepse në kundërtën, dihet se Komisioni ka bërë presion duke mos e aprovuar dhe mos e proceduar më tutje shumë ligje të aprovuara në fazën e parë në këtë parlament, e të cilat ligje kanë qenë realisht ligje gjuxhe, që duhet të dilnin nga ky ligj bazik. E kam fjalën për ligjin e organizimit sindikal, për ligjin për të drejtat në protesta, pastaj dhe ligje të tjera.

Sigurisht që ato ligje nuk mund të funksionojnë, pa aprovimin këtij ligji. Është fjala edhe për Ligjin për familjen, Ligjin për pushimin e shtatzënisë, pastaj për inspektorin sanitar, etj.

Ky fakt flet se sa i rëndësishëm është ligji i punës. Ky ligj thashë, jo vetëm që rregullon këto marrëdhënie, shumë të rëndësishme në mes të punëmarrësit dhe punëdhënësit, por në rend të parë rregullon çështjen e të drejtave të njeriut. Mirëpo, doli duke qenë se Parlamenti i Kosovës, ka aprovua disa ligje të cilat tanimë janë në funksionim, atëherë sa ky ligj është kompatibil me ato ligje, konkretisht do të përmend ligjin për diskriminimin, të cilin në mandatin e parë e kemi aprovua dhe prandaj duhet korrigjua edhe ky ligj për marrëdhëniet e punës. neni 6 pika 9. kur p.sh. thuhet se është e dënueshme ngacmimi në punë, i gjinisë femërore, dhe nuk thotë se është edhe ndalohe ngacmimi dhe nuk thotë se është edhe i dënueshëm. Kështu thotë dhe Ligji për diskriminim gjinor dhe normalisht kemi edhe relacione të tjera, që duhet proceduar në Komisionin për Çështje Sociale. Mirëpo, mbi të gjitha edhe pse ky ligj rregullon shumë mirë edhe çështjen e të drejtave të fëmijëve të moshës më se 15-vjeçare për punë, duke e ndaluar nën këtë moshë punën natën. Sidomos për këtë është i rëndësishëm, sepse për herë të parë rregullohet edhe pushimi i lehonisë dhe pikërisht ashtu sikur është kërkuar në debatet e shumta nga ana e shoqërisë civile. Edhe për këtë duhet përgëzuar. Mirëpo dilema mbetet te fakti se sa do të jetë i realizueshëm ky ligj, nëse mungojnë dy ligjet bazike që e mbështesin. Prandaj edhe sot kam një dilemë se, a duhet të votojmë për ligjin në mungesë të ministrit për çështje të financave, pasi që Ligji për sigurimin shëndetësor pësoi një fat shumë të keq, sepse nuk mund të realizohet dhe ai mbeti në një farë amullie.

U tha se në mungesë të fondit për shëndetësi, ai nuk mund të shkojë në procedurë më tutje.

Prandaj, pyetja ime dhe për ministrin që të dijë se a do të votojë apo jo, është njësoj sikur e kolegeve që diskutuan më para meje, është si mund të funksionojë ky ligj, nëse nuk kemi ligjin për sigurimin shëndetësor. Po ju kujtoj kur flas për sigurimin shëndetësor e kam fjalën për pushimin e lehonisë, për invalidët e punës e tutje dhe si mund të funksionojë ky ligj nëse parashihet se mbi moshën 65- vjeçare, ose invalidët e punës duhet të pensionohen. Nëse ekziston ligji për pensionet dhe nuk ekziston fondi për pensionet.

Prandaj, thashë se shumë e vështirë të votosh për një ligj i cili do të jetë vetëm në letër dhe nuk do të jetë funksional nëse nuk e kemi përgjigje nga, për këto dy fonde. Pa këto dy fonde, ky ligj edhe pse e ka një bazë shumë të lartë materiale, nuk është funksional, unë kam qejf ta kemi një përgjigje nga ministri. Pa këto dy fonde a është e mundur që ligji të jetë funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI – GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit! zonja deputete, ka fjalën deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputetja Naxhije Doqi,

DEPUTETI – RAMADAN KELMENDI

I nderuari kryesues, i nderuari ministër, deputet të respektuar!

Vlerësoj angazhimin dhe kontributin e Ministrisë së Punëve dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me hartimin e propozim – ligjit për punën dhe prezantimin e tij në shqyrtimin të parë në Kuvend. Shikuar nga këndi juridik, vlerësoj se është një ndër ligjet solide i punuar mirë dhe nuk mund të vërehen kritika aq të mëdha për aplikimin e tij në praktikë. Këtë e them se vij nga baza dhe pikërisht nga aty ky fillon të zbatohet ky ligj.

Ky propozim është i bazuar në rregullin dhe në përcaktimet në fushën shumë të rëndësishme dhe me interes të përgjithshëm. Ky propozim-ligj duhet të definohet drejt juridikisht si ligji i punës dhe si i tillë të përkrahet në shqyrtim të parë, sa më shpejt të nxirret. Kjo ka të bëjë me shumë shkaqe dhe arsye të cilat do t'i them shkurtimisht.

Nën 1. Rregullorja mbi ligjin themelor të punës, 2001/27, nuk i plotësonte kriteret as për së afërmi për ta rregulluar këtë fushë të rëndësishme të jetës në Kosovë, kur dihet se shkeljet në punësim, padrejtësitë dhe diskriminimi që bëhet të punësuarve në sektorin publik dhe në atë privat. Në tërësi, gjitha këto paligjshmëri ka shans dhe mundësi të eliminohen me këtë propozim-ligj.

E dyta, urgjentisht, duhet të aprovohen Ligji mbi nxitjen e punësimit si ligj me rëndësi, Ligji mbi inspeksionin e punës, Kodi i mirësjelljes të të punësuarve, është më se e domosdoshme të rregullohen të gjitha marrëdhëniet, raportet, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që dalin dhe ato materiale në mes punëmarrësit dhe punëdhënësit. Nëse në këta dy sektorë për të mos u krijuar pakënaqësi, padrejtësitë, grevat dhe forma e tjera të palejuara, ligjërisht. E drejta e punës është kategori themelore, fundamentale, e së drejtës së njeriut, në këtë ligj është përkufizuar drejtë e mirë. Është mirë që është bërë kalkulimi i shpenzimeve për koston e pushimit të lehonisë, për 3 muajt e dytë dhe vlerësoj se kjo nuk është dhe nuk duhet të jetë pengesë, sepse mbi të gjitha fëmija ka vlerë të paçmuar dhe është shumë mirë, të investohet në përkujdesjen për fëmijët, sepse kjo është kujdes për ardhmërinë tonë.

Ne jemi në gjendje ekonomike jo të mirë, por është fakt që nuk stimulojmë, lindjen si shtetet e tjera për ta ulur këtë si çështje kombëtare. Përkrahja e këtij propozim-ligji është e arsyeshme, por me arsyetimin se preambula, po ashtu duhet të fillojë me parimin e kushtetutshmërisë duke u mbështetur në Kornizën Kushtetuese dhe jo në rregulloren siç është rasti konkret. Vlerësoj që pasi Rregullorja për shërbimin civil është tejkaluar, ky projektligj duhet të rregulloj të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë në puna dhe në marrëdhënie pune në Kosovë.

Në sektorin publik dhe privat, në pajtueshmëri të plotë, ashtu siç edhe e ka përcaktuar me kontratën kolektive, ku mund të gjenden rastet, ligjet e veçanta, aktet e brendshme, kontratën e punës dhe të gjitha këto të kenë dallime, nuk mund të kemi përjashtime dhe nuk mund të vijmë në kundërshtim me këtë ligj, si ligj parimor dhe bazik i rregullimit të marrëdhënieve të punës. Përkufizimi i të punësuarit vlerësoj se duhet të plotësohet dhe të definohet mirë. Me përkufizimin e nocionit i punësuar, a konsiderohet i punësuar në punë ditore, disaditore, me kontratë të shkurtër, për kohë të caktuar dhe të gjitha format e tjera. Propozimligji në përcaktimin e drejtë të punësuarit lë zbrazëtira, pikërisht në nenin 4 pika 1. nuk përcakton të drejtën e punës 40 orë në javë, apo 8 orë në ditë, për disa pushime të obliguara të punës në ditë dhe kjo duhet të jetë obligim edhe për sektorin privat.

Propozimligji duhet të përcaktojë afatet më të larta në muaj se kur duhet t'i bëhet pagesa punëtorit dhe jo ajo të bëhet pas dy tre e më shumë muajsh, sipas aftësive ekonomike apo vullnetit të punëdhënësit. Propozimligji nuk përcakton përgjegjësinë e punëdhënësit kur kërkon dhe detyron punën shtesë, në kundërshtim me ligjin dhe me kontratën e punës, si mundësi e organizimit të procesit të punës, por shkelen të drejtat e mbrojtjes nga marrëdhënia e punës. Vlerësoj se në disa raste, në disa aline të nenit 6, mbi diskriminimin në punë, nuk duhet të vlejë dhe nuk duhet të kenë vende për këtë propozimligj. Puna e dhunshme dhe e detyruar përveç se është e ndaluar nuk është specifikuar p.sh. shitësja nuk mund të obligohet të punojë në ngarkim dhe shkarkim, ose pas orës 23 dhe të gjitha këto dispozita në procedurën e mëtutjeshme duhet ose përcaktuar ose mënjeluar.

Themelimi i marrëdhënies së punës është bazë dhe shumë i rëndësishëm, mund të bëhet sipas kriterëve të caktuara. Me aktin e brendshëm, por domosdoshmërisht duhet përcaktuar me këtë ligj me konkursin publik, i cili do të publikohet në mjetet e informimit, në qendrat rajonale, të punësimit dhe në zyrat komunale për punësim. Për t'u ikur të gjitha formave juridike, të paligjshmërisë së punësimit pa kriterë, pa konkurs, familjarizimit, mitos dhe formave të tjera të punësimit. Propozimligji duhet të përcaktojë përqindje të pagës, në vend të punës ku paguhet punëtori për punën provuese, e cila nuk është definuar deri në fund. Vlerësoj se Propozimligji i punës duhet të zbatohet edhe për kompensimin material, nga punëdhënësi për largimin nga puna për shkaqe të cilat janë krijuar raportet në vendet e punës.

Mendoj se përcaktimi i punës, më të gjatë se orari i punës, në propozimligj për shkak të shkaqeve të problemeve të mëdha, keqpërdorimit dhe rritjes së papunësisë, për këtë duhet të kemi kujdes të sanksionojmë. Është mirë që java e punës është 5 ditë, por do të ishte mirë që kjo të vlejë edhe për punëtorë në sektorin privat, të cilët punojnë për çdo ditë, të shtunë dhe të diele, dhe mbi 10 orë punë dhe patjetër duhet përcaktuar që e diele së paku të jetë ditë pushimi, për të gjithë dhe obligim për mospunë, vetëm në vendet emergjente shëndetësore.

Puna e natës është kristalizuar dhe përcaktuar, që na sillte problem, mbrojtja dhe siguria në punë duhet llogaritur edhe kohën e shkuarjes dhe kthimin nga puna, në një kohë të kuptueshme, sepse gjatë kësaj kohe ndodhin fatkeqësi dhe punëtorët nuk realizojnë të drejtat. Pa përcaktueshmëri humbin të drejtat e punëtorit.

Kompensimi i dëmit, të shkaktuar nga punëtorët, duhet të bëhet në mënyrë proporcionale, me përgjegjësitë, vendin e punës, por edhe me një komision, i cili vlerëson në bazë të ekspertëve dhe jo vullnetit të punëdhënësit, apo të drejtorit. Propozimligji nuk sqaron procedurat e mbrojtjes së tjetërsuar nga marrëdhënia e punës në raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës pa arsye dhe në kundërshtim me kontratën kolektive dhe me format e konkursit të punësimit.

Propozimligji parasheh një obligim shumë të madh, posedimin e librezës së punës, me çka do të përcaktohen shumë gjëra rreth statusit të punëkërkuësve dhe është dokument i rëndësishëm dhe pa të nuk mund të lëvizim më tutje. Në tërësi zbatimi i këtij propozimligji do të arrijë në efekte pozitive dhe unë personalisht përkrahu që për krahas ligjeve të tjera bazike, ta miratojmë në parim dhe të paraqesim amendamente. Kontributin tim do ta jap në vërejtjet e parashtruara, dhe vlerësoj se ky ligj patjetër do të ketë një mbështetje nga të gjithë ata që e kuptojnë rëndësinë e miratimit të tij, në dy faza, në te parë dhe atë përfundimtare, ju faleminderit!

KRYESUESI – GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Naxhije Doçi, le të përgatitet deputeti Milazim Haliti.

DEPUTETJA – NAXHIJE DOÇI

Ju faleminderit zotëri kryesues, i nderuari zotëri ministër, të nderuar kolegë deputetë dhe të gjithë ju, të pranishëm në sallë!

Në këtë kohë 7-vjeçare të pasluftës së rëndë Kosova po kalon nëpër një periudhë shumë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik të saj, si dhe nëpër një periudhë të vlerave të veçanta, të kultivimit të një demokracie të dalluar, ndoshta edhe të asaj demokracie të nivelit të tejkalimit, të përmasave të vendeve të përparuar në zhvillim. Duke u nisur nga një realitet i tillë, Kosova ka një domosdoshmëri të përshpejtuar, për t'u pasuruar me ligjslacion të funksionalizuar, të përpunuar dhe të diskutuar nëpër të gjitha instancat institucionale, si dhe të plotësuara dhe të miratuara edhe në institucionin më të lartë të saj, në Kuvendin e Kosovës, e jo që këto ligje të mbesin nëpër sirtarë. Projektligji për punë ka një rëndësi shumë të madhe, sepse njih dhe mbron të drejtat themelore të punëtorëve dhe të punëdhënësve në Kosovë, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Krijon kushte dhe standard më të mirë të punës dhe sistem të mbrojtjes sociale, ekonomike dhe profesionale dhe punëtorëve. Përmes dispozitave të caktuara ky projektligj parasheh eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të punëtorëve në Kosovë.

Duke shkuar nga ajo, eliminimin e diskriminimit gjinor, kulturor, të përkatësive politike, etnitetëve etj. do të kisha thënë se, për dallim nga shumë projektligje të tjera, të vlerësuara në këtë Kuvend, projektligji për punën është i përgatitur mirë, i kuptueshëm dhe konceptualisht edhe gjuhësisht i një niveli të lartë. Është projektligji i bazuar në ligjet evropiane, që zbatohen në vendet në transicion, si dhe i bazuar në konventat ndërkombëtare të organizatës ndërkombëtare të punës i përshtatur mirë, për kushtet e zhvillimit ekonomik dhe social të Kosovës.

Projektligji për punën pas vlerësimit dhe plotësimit në këtë Kuvend do të plotësojë mangësitë dhe zbrazëtitat e Rregullores mbi themelimin, mbi ligjin themelor të punës, 2001/27, që është në funksion, që nga paslufta në Kosovë, qëllimi i paqësor i projektligjit për punë, është sigurimi i kornizës ligjore të ne. Ku përfshihen dhe të tjera, edhe sigurimi i kushteve për funksionimin e ndërmarrjeve të vogla, dhe të mesme, siguria materiale dhe sociale e punëtorëve, sigurimi shëndetësor dhe pensional, kriteret për lidhjen e marrëdhënies së punës, kriteret e orarit të punës, të mbrojtjes në punë, të pagës dhe të të ardhurat e tjera të punëtorit si dhe shumë të drejtat e tjera, të përfshira në gjithsej 12 kapituj dhe në 120 nene që ka ky Projektligj. Krahas vlerësimeve të përgjithshme, kryesisht pozitive në këtë Projektligj, do të bëja edhe disa vërejtje të veçanta, p.sh. në nenin 1. paragrafi 3. ku theksohet citoj: marrëdhënia e punës në UNMIK, KFOR, etj. kujtoj se duhet të jetë marrëdhëniet e punës në organet apo institucionet e përkohshme.

Në nenin 4 pas paragrafit 2. ku bëhet fjalë, për mbrojtjen e femrës, gjatë kohës së shtatzënisë, dhe të lindjes, mendoj se duhet shtuar në vijim edhe një paragraf i radhës, paragrafi 3. ku është mjetet e Kosovës, citoj për një vend të punës ku konkurrojnë me kushte të barabarta, për praninë, një mashkull dhe një femër, ti jepet për përparësi femrës, mbaron citati sepse ende ka shumë pak femra në punë në Kosovë, në krahasim me meshkujt.

Është mirë dhe shumë inkurajuese, por edhe për çdo lëvdatë, në këtë projektligj që në nenet 45 dhe 49, bashkë dhe me paragrafët e tyre është trajtuar ligjshmërisht, por edhe njerëzisht çështja e punës dhe kushteve të punës së të rinjve, të femrave dhe të personave me aftësi të kufizuara. Konfuziteti i gjertanishëm rreth të drejtës dhe kushteve për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë, ka bërë që shumë femra të punësuar në Kosovë ta hamenden për shtatëzani dhe për vazhdimësi të jetë së re, dhe kjo është e dëmshme për Kosovës. Trajtimi i mirë në këtë projektligj i të drejtave të grave shtatzëna në orar të punës në ndërrimet e punës por edhe caktimi i afatit deri iku të kënaqshëm të paraparë për pushim të lehonisë, si dhe që është 3 muaj punëdhënësi dhe tre muaj Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me mbi 70 dhe nën 70% të pagës, si dhe trajtimi i mirë për krijimin e kushteve për përkujdesjen ndaj fëmijëve, të cilit do prind apo të adoptuesit në raste të veçanta, është një inkurajim për rritjen e numrit të lindjeve të Kosovë.

Ky projektligj që është edhe ligj bazik, parasheh edhe lëvdata dhe shpërblime, por edhe ndëshkime si për punëmarrësin ashtu edhe për punëdhënësin. Në raste kur bëhen lëshime dhe kur shkelen rregullat e parapara në këtë projektligj dhe mendoj se kjo krijon kulturë dhe obligim për përfillje dhe për zbatim të ligjshmërisë tek ne.

Megjithatë, në dispozitat ndëshkimore neni 118, kur flitet për gjobat për punëdhënësin, për moszbatueshmëri të neneve të caktuara mendoj se shkallshmëria e ngritjes së gjobës mbërrin në fundin shumë lart që, kujtoj se një harmonizim më i mirë dhe më i përafërt i gjobës do të jetë më i kapshëm dhe nuk do të lë hapësirë manipulimit të mundshëm. Në fund po theksoj edhe një herë se Projektligji për punë në krahasim me projektligjet e mëparshme të vlerësuara në këtë Kuvend të nderuar, mendoj se është i përpunuar mirë, dhe se nuk ka gabime gjuhësore sintaksore, dhe për këtë e përkrahë në parim.

Ju faleminderit!

KRYESUESI – GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit! e ka fjalën deputeti Milazim Haliti,

DEPUTETI-MILAZIM AHALITI

I nderuari zotëri kryesues, zoti ministër, të nderuar deputetë,
Projektligji për punë i propozuar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, rregullon çështjet e rëndësishme për themelimin e marrëdhënies së punës, si dhe raportet që krijohen në mes të punëdhënësit, dhe punëmarrësit. Me këtë krijohen edhe kushte edhe standarde për punë, si në mbrojtjen e të drejtave ekonomike – profesionale, sociale për punonjësit, po ashtu edhe për eliminimin e formave të diskriminimit. Ky projektligj do të zëvendësoj ë Rregulloren mbi ligjin e punës, 2001/27, që ishte me 28 nene, dhe me mangësi të shumta, e me këtë do të plotësohet vakumi ligjor që ka ekzistuar në këtë lëmi. Me këtë projektligj mundësohet njohja e të drejtave themelore, detyrave dhe përgjegjësisë dhe punëdhënësvë dhe punëmarrësve, si dhe liria për punë që është e drejtë themelore, e secilit dhe mbrohet me Konventën ndërkombëtare të punës.

Projektligji parashih koncepte të reja, që zbatohen në vendet e transicionit si dhe ligjeve, më të avancuara dhe është harmonizuar me legjislacionin e Unionit Evropian. Me këtë projektligj, parashihet mosha minimale për punë, lidhja e kontratës së punës, pushimi gjatë orarit të punës, pushimi javor, vjetor, pushimi i lehonisë, pastaj mbrojtja e të rinjve femrave, dhe personave më aftësi të kufizuar, Gjithashtu parashihen edhe përcaktimi i pagës dhe pagës minimale pastaj rrethanat për shkëputjen e kontratës, organizimi sindikal, me ç'rast të punësuarve u garantohet kjo e drejtë, dhe e drejta për grevë, si dhe në fund janë parapa procedurat sipas ankesës, si dhe dispozitat ndëshkimore.

Projektligji ka një kosto të artë, gjatë implementimit sepse parashihen që të mbulojnë shpenzimet pushimit të lehonisë, shpenzimet e udhëtimit për të punësuarit, që janë të domosdoshme. Ky projektligj nuk është pa vërejtje, ku disa janë dhënë edhe në shpjegimet e projektligjit, këtyre vërejtjeve mund t'i shtohen edhe disa të tjera të neneve siç janë ato të jenë më të kuptueshme si neni 10 paragrafi 5. pastaj neni 49 paragrafi 3. neni 31 ku parashihet pushimi vjetor në kohëzgjatje prej më së paku 20 ditë pune, por nuk definohet saktë kohëzgjatja, varësisht nga stazhi, kushtet e punës dhe kriteret tjera.

Te dispozitat ndëshkimore, neni 118 paragrafi 4. ku parashihet që punëdhënësi të gjobitet në shumë prej 500 deri 35.000 €, që është një diferencë e madhe e gjobës për shkelje të neneve nga 42 deri në 52, si dhe neni 92 i cili parashih të drejtën në grevë. Mendoj se këto vërejtje të theksuara dhe të tjera që ka ky projektligj do të plotësohen, korrigjohen në procedurën e më tutjeshme, dhe në parim e mbështes miratimin e këtij Projektligji.

Ju faleminderit!

KRYESUESI – GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit! Votojmë për miratimin në parim të këtij projektligji, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, dhe të votojmë tash, prezent janë 71 deputetë!

PËR.....	63
KUNDËR.....	4
ABSTENIM.....	1

Konstatoj se Projektligji në parim është miratuar. Ngarkohet Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision funksional dhe referues, Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj, nga shqyrtimi i parë i këtij projektligji ti raportoj Kuvendit me rekomandime.

E japim një pauzë deri në ora 3,00 apo ka edhe një kërkesë e cila duhet të bëhet me gojë prej dikujt,

Fjalën e ka deputeti Alush Gashi

DEPUTETI - ALUSH GASHI

I nderuari zotëri kryesues, pikat që tash vijnë në rend të ditës janë me rëndësi të posaçme dhe kemi interes një numër sa më i madh i deputetëve të jetë i pranishëm, andaj në marrëveshje me Grupin Parlamentar të PDK-së dhe AAK-së, ju propozojmë që seanca të vazhdojë nesër në orën 10.00.

KRYESUESI – GAZMEND MUHAXHERI

Është propozim për shtyrje të seancës. Ju lus që me një votim formal të deklarojeni.

Ju faleminderit. Seanca shtyhet për nesër në orën 10,00. Ju faleminderit! Seanca vazhdon nesër më 17.11.2006, në orën 10,00.

Vazhdimi i seancës plenare më dt. 17.11.2006 në orën 10,00

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Të nderuar deputetë. E vazhdojmë punën e seancës së djeshme.

Pika e parë e rendit të ditës është pika 8.

8. Shqyrtimi i raportit për punën e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2005.

Konstatimet hyrëse.

Në pajtim me nenin 5.7 të Ligjit për telekomunikacionin, Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka dorëzuar raportin vjetor të punës për vitin 2005.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Telekomunikacion si komision funksional e ka shqyrtuar këtë raport dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimet.

Komisioni për Buxhet dhe Financa rekomandon që debati për këtë raport të zhvillohet në seancë plenare.

Ftoj kryesuesin e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit z. Anton Berisha ta paraqesë raportin.

ANTON BERISHA - Duke pasur parasysh nevojën për përmirësimin e sektorit të telekomunikacionit në Kosovë, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin për telekomunikacionin, duke themeluar Autoritetin e Pavarur Rregullator, i cili do të jetë përgjegjës për licensimin, rregullimin dhe menaxhimin e ofruesve të shërbimeve të telekomunikacionit në Kosovë; inkurajimin e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe konkurrencën lojale në përputhje me dispozitat në fuqi, rregullimin e standardeve unike për të gjithë ofruesit e shërbimeve në Kosovë dhe mbrojtjen e konsumatorëve të këtyre shërbimeve:

Në bazë të Ligjit për telekomunikacionin neni 5(7) dhe neni 13(7), më 10 mars 2006, ART i ka dorëzuar Komisionit për Buxhet dhe Financa, raportin vjetor për vitin 2005 që përmban detaje financiare që i përkasin aktiviteteve të ART; përkatësisht raportin vjetor mbi punën e ART-it për vitin 2005.

Më 19.06.2006, në cilësinë e përfaqësuesit të ART, para Komisionit Funksional përgjegjës për sektorin e telekomunikacionit kam paraqitur një raport përmbledhës dhe në një diskutim konstruktiv dhe të dobishëm të anëtarëve të Komisionit jemi dakorduar për vazhdimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe për marrjen e detyrës në zbatimin e rekomandimeve të Komisionit.

Në seancën plenare, më 14 shtator 2006, është kërkuar nga ART t'i dorëzohë Kuvendit raport shtesë, ndërsa në mbledhjen e Komisionit Funksional, të datës 16.10. 2006 kam

shpalosur punën dhe përparimet e dukshme që janë bërë në Autoritetin Rregullator nga periudha e raportimit paraprak në qershor 2006
Komisioni Funkcional ka pasur mundësi shqyrtimi të dokumentacionit shtesë që ia kemi dorëzuar Kuvendit të Kosovës:

Raporti vjetor

- Raportin e plotësuar financiar 2005
- Raportin për kompletimin e legjislacionit sekondar
- Raportin për ristrukturimin e brendshëm të ART
- Raportin për angazhimin e ekspertëve të ART në hartimin e politikave strategjike
- Raportin për konformitetin me BE 2006
- Raportin për heqjen e barrierave në tregun e telekomunikacioni 2006 • Dhe, dokumente të tjera

Objektivat kryesorë të ART në vitin 2005 ishin vazhdimi i ngritjes së institucionit, në mënyrë të veçantë organizimi i brendshëm konform praktikave dhe standardeve evropiane.

Në rrafshin juridik, përpilimi dhe aprovimi i rregulloreve (legjislacionit sekondar), përmes të cilit në mënyrë precize konkretizohen veprimtaritë në sektorin e telekomunikacionit. Një rëndësi të veçantë ka aprovimi i tipeve (nëntë prej tyre) të autorizimeve/licensave të shërbimeve të telekomunikacionit.

Në aspektin rregullator, veprimtaria përmbledhet në proceset e reja licensuese, monitorimi i përmbushjes së kushteve të licensave si dhe sigurimi i vendosjes së ligjshmërisë në sektor. Në mënyrë të veçantë janë me rëndësi oferta referente për interkoneksion, heqja e lakut lokal dhe ribalansimi i tarifave.

Aspekti i ligjshmërisë ka qenë i ndërlikuar edhe me instucionet e tjera, ndonëse ART në praktikë ka marrë masa konkrete të çkycjes dhe të blombimit të antenave dhe të pajisjeve të paligjshme.

Në aspektin e strukturës së brendshme organizative, ART ka filluar procesin e ristrukturimit në bashkëpunim me ekspertë të BERZH, TAIEX (Komisionit Evropian) që ka rezultuar në një model organizativ modern, të bazuar në praktikat rregullatore ndërkombëtare dhe në Ligjin për telekomunikacionin.

Sa u përket aspekteve financiare dhe buxhetore, në vitin 2005, ART ka hyrë në periudhë kalimtare nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, ashtu siç është e paraparë me ligj, në buxhet vetëfinancues, që ka rezultuar në fund të vitit me të hyra prej 10,067,890€ dhe shpenzime në vlerën 504,895.46€. Shuma e mbetur është derdhur në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Në kontekstin e bashkëpunimit ndërinstucional në raport me organizmat vendorë dhe ndërkombëtarë duhet veçuar bashkëpunimin me Komisionin Evropian, përkatësisht me Drejtoratin e Përgjithshëm për Shoqëri Informativë dhe Media, në kuadër të projektit të sponsoruar nga ky institucion, që ka rezultuar me monitorimin e sektorit të shërbimeve telekomunikuese dhe të aspekteve përkatëse në Evropën Juglindore, në të cilin ART ka tretman të barabartë me rregullatorët e vendeve të tjera

Të nderuar deputetë,

Meqenëse tani jemi në fund të muajit të dhjetë të vitit tjetër, me kënaqësi konstatoj, se të gjitha projektet e filluara në vitin 2005 janë duke vazhduar në vitin 2006 dhe ART është në proces të zbatimit të punës së vet, që është theksuar edhe në rekomandimet e Komisionit 04.07.2006, qoftë në procesin e tenderit për operatorin shtesë mobil, në kompletimin e legjislacionit sekondar që nënkupton parakushte për investime praktike .

Ekspertët e ART kanë kryer një punë të shkëlqyeshme në hartimin e parimeve (politikave) zhvillimore të sektorit, dokumente të punuara me ekspertë ndërkombëtarë dhe të dorëzuara ART dhe Qeverisë së Kosovës.

Ju falënderoj për vëmendje tuaj!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ju informoj se në sallë janë të pranishëm 66 deputetë. Ftoj kryesuesin e Komisionit funksional z. Ibush Jonuzin që para deputetëve t'i paraqesë rekomandimet e Komisionit.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Faleminderit I nderuari kryesues, të respektuar deputetë dhe ministra. Unë do të përpiqem shumë shkurt që t'i them disa çështje meqë rekomandimet ne ua kemi dërguar zyrtarisht të gjithë deputetëve. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për periudhën 2005. Komisioni parlamentar e ka shqyrtuar sipas Ligjit për telekomunikacion dhe Rregullores së punës së Kuvendit. Raporti pasqyron pjesën e realizuar të objektivave të këtij subjekti të cilin edhe e përkrah, por në anën tjetër evidentohen edhe vërejtjet për mungesën e disa aktiviteteve të rëndësishme për realizimin e të cilave e ka mandatin ART-*ja, me gjithë atë unë do të ndalem shkurt në disa çështje që ART-në e obligon Ligji për telekomunikacion. Sipas nenit 3 pika (b), ART është themeluar në bazë të Ligjit për telekomunikacion është trup i pavarur brenda institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e politikave të Qeverisë dhe të ministrisë përkatëse, udhëhequr nga ligji dhe pjesë të tjera legjislative në pajtim me këtë. ART është kompetente dhe e obliguar me ligj për të nxjerrë rregullore dhe udhëzime administrative që e sigurojnë zbatimin e ligjit, sipas asaj që kryesuesi i ART-së ka raportuar në Komision Parlamentar e që edhe tani raportoi që e përshëndes, por del se ART është në rrugë të mbarë për kryerjen e këtyre obligimeve, d.m.th për nxjerrjen e udhëzimeve për mbarvajtjen e punëve të ART-*së.

Sipas nenit 7.4 kërkohet që ART të mos ketë asnjë aktivitet afarist privat, apo aktivitete të tjera financiare në ndërmarrjet që janë nën juridiksionin e bordit. Në të kundërtën bie në kundërshtim me ligjin. ART sipas Ligjit të telekomunikacionit neni 15.1 emëron inspektorët për të vërtetuar ekzekutimin e ligjit sipas kushteve të licencave, këtë ART duhet ta zbatojë gjithsesi. Tani shihet, në kohë të fundit, kur edhe është marrë një aksion mjaft i rëndësishëm në këtë lëmi. Janë bërë shumë fjalë, shumë komente edhe për tenderin, prandaj neni 50 përcakton format e tenderit për shërbimet fikse. Pika 1 e nenit 50 thotë se ART do të bëjë koncesione për shërbime fikse në pajtim me procedurat për tenderim publik. Sipas ligjit Ministria duhet të përgatisë dokumentin e tenderit, ndërsa ART ta zbatojë dhe të gjitha procedurat e tenderimit duhet të jenë transparente. Në si komision parlamentar kemi trajtuar vetëm ato çështje që jemi të obliguar t'i prekim me rregullore të punës së komisionit parlamentar, ndërkaq për çështje të buxhetit ka kompetencë Komisioni për Buxhet e Financa, por sipas nenti 5 të Ligjit ART vetëm vitin e parë duhet të financohet nga Qeveria e më pastaj duhet të vetëfinancohet.

Neni 5.7 kërkon që jo më vonë se pas mbylljes së secilit vit fiskal ART do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Kuvendit raportin vjetor me detaje financiare lidhur me aktivitetet e saj dhe planin e punës për vitin vijues.

Neni 16.1 thotë se jo më vonë se 9 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ART duhet t'i dorëzojë Kuvendit një raport në të cilin identifikohen dhe lehtësohen lëvizjet dhe

barrierat për hyrjen e sipërmarrësve në treg dhe bizneset e tjera të vogla për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese.

Të gjitha vërejtjet e cekura më lartë duhet t'i ketë parasysh ART-ja ashtu që të vihet në zbatim ligji prej nga dalin detyrat dhe obligimet e këtij subjekti aq të rëndësishëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së fjalën e ka z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues, znj. dhe z. deputetë.

Grupi Parlamentar I LDK-së, raportin e punës dhe raportin financiar të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit e ka shqyrtuar me kujdes dhe duke i kuptuar vështirësitë me të cilat është përballur ky institucion i rëndësishëm, të cilit për të qenë i suksesshëm i duhet pavarësi dhe mbështetje institucionale. Ne e pranojmë raportin dhe e inkurajojmë në intensifikim të angazhimeve në kuadër të kompetencave dhe të rekomandimeve të Komisionit funksional të Kuvendit të Kosovës.

Z. kryesues, kërkojmë nga Qeveria që ART –së t'i japë mbështetje institucionale në realizim të kompetencave me respektim të pavarësisë së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit të Kosovës.

Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të PDK-së z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI - Z. kryesues, të nderuar deputetë. Fillimisht më duhet të them, më vjen keq, por raporti që ne e kemi marrë më së paku është raport i ART-së dhe ART-në nga fillimi deri më tani e kanë përcjellë dobësi të mëdha dhe ndoshta dobësia më e madhe është te Ligji për telekomunikacionin i cili nuk ofron konkurrencë të mirëfilltë të tregtisë së lirë mobile për faktin se kërkohen vetëm dy operatorë dhe aty ku janë vetëm dy operatorë nuk mund të flitet për një konkurrencë të mirëfilltë, aty nuk mund të themi se na ofrohen shërbime të mirëfillta në telefoninë mobile dhe si rezultat dëmtohet xhepi i qytetarëve të Kosovës. Pse dy operatorë lehtë mund të merren vesh dhe të krijojnë monopol mbi hapësirën e Kosovës, ky është defekt te ligji që unë e kam thënë me kohë në Qeverinë e kaluar dhe e përsëris edhe sot para jush . Nëse flasim për konkurrencë të lirë ne e dimë çka është konkurrenca e lirë. Në anën tjetër ne e dimë se kërkesa përveç valës 900 të ketë një operator tjetër, në një mënyrë ka qenë paracaktim se kush mund ta fitojë tenderin për telefoninë mobile dhe ju e dini se si është zhvilluar çështja rreth përzgjedhjes në telefoninë mobile dhe vetëm ky rast që ka ndërhyrë UNMIK-u për ta anuluar përzgjedhjen që është bërë nga ART-ja ,është edhe ka qenë fakt i mjaftueshëm që ART-ja me dhanë dorëheqje dhe ky Parlament me ia marrë mandatin ART-së se në fund të fundit që me detyrën e tyre kryesore ART-ja ka bërë gabimin e saj, gabim që është anuluar vendimi. Gjatë gjithë kohës prej vitit 2004 dhe 2005 në Kosovë ka pasur dhe kanë vepruar operatorë ilegalë të egër dhe nuk e dimë asnjë veprim të ART-së kundër këtyre operatorëve ilegalë që kanë vepruar në Kosovë edhe kjo ka qenë dhe vazhdon të jetë përgjegjësi e ART-së. Ne jemi në fund të vitit 2006, ne po e shqyrtojmë një raport të vitit 2005 edhe kjo është domethënëse. Ne në fund të këtij viti është dashur të debatojmë për raportin e vitit 2006 në fakt ne po merremi me raportin e vitit 2005 dhe gjendja në telefoninë e sotshme mobile në Kosovë përsëri është një përgjegjësi e ART-

së dhe në si grup parlamentar do të ofrojmë edhe dëshmi të tjera të bollshme që ky Parlament t'ia marrë votëbesimin ART-së, ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - I nderuari z. kryesues, e nderuara ministre, z. ministër, të nderuar deputetë.

Mundësia e komunikimit me teknologji moderne është çështje e pjesëmarrjes në shoqërinë e sotme globale të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies. Krijimi i një sistemi modern të komunikimit na siguron mundësinë të jemi në hap me zhvillimet e fundit të teknologjisë, shkencës dhe të vetëdijes politiko-sociale, pra kur flasim për telekomunikacionin kemi të bëjmë me një resor tejet të rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës. Po ashtu ky resor ka reflektim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e popullatës së Kosovës, qasje në shërbimet kualitative telefonike dhe nga aspektet financiare tejet të volitshme, sot është një standard i vetëkuptueshëm jo vetëm në shtetet e Evropës Perëndimore, por edhe në shtetet e rajonit. E njëjta gjë vlen edhe për qasjen në shërbimet kualitative dhe të volitshme të internetit. Përkundër sukseseve deri më sot nuk kemi arritur që popullatës tonë t'jua sigurojmë këtë standard në nivel të duhur. Ne kemi themeluar Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit, si organ të pavarur, megjithatë ende nuk janë arritur rezultatet e pritura. Do të isha e njëanshme po të pohoja se Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit është fajtor për këtë. Në këtë kontekst duhet t'i kemi parasysh vështirësitë në të cilat ka hasur ky autoritet, duhet të theksohet që ky autoritet e ka përfunduar fazën e parë të hapjes së tregut të telekomunikacionit për dhënie të licencës së parë të telefonisë mobile dhe licencës për shërbime të internetit. Sa i përket liberalizimit të tregut të telefonisë mobile e inkurajojmë ART-së në zhvillimin e proceseve dhe procedurave përkatëse.

Të nderuar deputetë ART-ja është organ i krijuar nga Kuvendi i Kosovës dhe sot për herë të parë i raporton Kuvendit. Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar me vëmendje të posaçme raportin e ART-së, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që ka ky autoritet në rregullimin e sektorit të telekomunikacionit në Kosovë dhe nevojën për zhvillimin e këtij sektori. Raportin e paraqitur nga ART-ja për punën gjatë vitit 2005 dhe raportin financiar Grupi Parlamentar i Aleancës i përkrah edhe pse konsiderojmë se do të ishte më i plotë po të pajisej me më pak informata teknike lidhur me punën, të arriturat dhe vështirësitë në ushtrimin e përgjegjësisë së veta. Në përgjithësi ne e mbështesim punën e ART-së dhe në punën e mëtejme i propozojmë këto rekomandime:

Qeveria të propozojë anëtarin e bordit rregullator,

Kërkojmë nga ART ta ruajë edhe më tej pavarësinë dhe objektivitetin,

Kuvendi i Kosovës është themelues i ART-së dhe është organ i vetëm që e mbikëqyr, prandaj i përkrahim rekomandimet për punën e ART-së të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe kërkojmë që ART-ja në punën e mëtejme t'i ketë parasysh.

Mbështesim veprimet e dëritashme të ART-së në shkyçjen e operatorëve ilegalë të telefonisë mobile serbe Mobtel me prefiksin 063 dhe të telefonisë mobile të Serbisë me prefiksin 064, të cilat i kanë shkaktuar humbje të mëdha buxhetit të Kosovës. Po ashtu e inkurajojmë të vazhdojë me identifikimin e mëtejme të operatorëve të tjerë ilegalë dhe shkyçjen e tyre.

Tanimë është shpallur tenderi i ri për telefoninë mobile dhe presim interesimin nga investitorë seriozë. I vetmi grup i cili duhet të përfitojë nga ky tender duhet të jenë konsumatorët e Kosovës, pra qytetarët e Kosovës. Në përzgjedhjen e kompanisë ART-ja duhet të përqendrohet thellësisht në këtë kriter se cila kompani mund t'u ofrojë konsumatorëve shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe nga aspekti financiar të volitshme për xhepin e qytetarëve të Kosovës dhe natyrisht t'i aplikojë me përpikëri procedurat transparente të tenderimit,

Ftojme ART-*në që në të ardhmen t'i drejtohet këtij Kuvendi me rastin e vështirësive në zbatimin e përgjegjësive dhe njëkohësisht presim një bashkërendim më të ngushtë me Kuvendin përmes Komisioneve funksionale të Kuvendit. Art-ja këtu do ta gjej partnerin i cili është i përkushtuar që t'i thyejë monopolin në Kosovë dhe të krijojë bazë ligjore dhe infrastrukturë për shërbime më të mira për qytetarët e Kosovës.

Të nderuar deputetë ju ftoj që raportin e ART-së, rekomandimet e Komisionit dhe rekomandimet e Grupit Parlamentar të AAK-së t'i mbështetni dhe t'i votoni. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar të Orës e ka fjalën deputeti Genc Gorani.

DEPUTETI GENC GORANI – Z. kryesues, të nderuar ministra, znj. dhe z. deputetë.

Themelimi dhe funksionimi i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit është njëra prej bazave të funksionimit me standarde evropiane në këtë resor kaq të rëndësishëm të telekomunikacionit. Këtë pak a shumë e dimë të gjithë. Funksionimi dhe fuqizimi i një autoriteti në këtë resor është një proces i cili kërkon një periudhë relativisht të gjatë, duke iu referuar shembujve të ngjashëm në shtetet që janë shumë më të zhvilluara se Kosova dhe po ashtu me një status, pa dyshim, shumë më të qartë në kuptojmë se një funksionim me të gjitha prerogativat të presupozuara të një autoriteti rregullativ në telekomunikacion kërkon kohë që është rreth 2 apo 3 ose edhe më shumë vjet. Në rastin tonë në Kosovë ky është një minimum për arsye të cilat pak a shumë të gjithë i dimë. Tregu i telekomunikacionit praktikisht nuk ka ekzistuar para 99, madje edhe pas 99 është diçka që është administruar pak a shumë artificialisht nga disa rregullatorë, më tepër të lidhur për UNMIK-un. Unë kisha dashur të koncentrohem në faktin se shumë kompetenca në Ligjin për telekomunikacionin nuk janë mirë të ndara dhe të sqaruara. Në përgjithësi kisha dashur të them se çështja është në ligj. Apeloj që në të ardhmen gjatë plotësimit dhe ndryshimit të këtij ligji të kihet parasysh se duhet të ndahen qartë kompetencat që kanë të bëjnë me politikë bërje dhe në ato kompetenca, duke i implementuar këto politika, ART-ja të mos jetë në pozitë të merret me politikë bërje, por anasjelltas të mos jetë Ministria për Telekomunikacion, e cila merret ose ndërhyr në implementimin një herë që politikat të jenë të miratuara në çfarëdo niveli e më së shumti në nivelin e Kuvendit. Grupi parlamentar Ora i përkrah në përgjithësi funksionimin, veprimin e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit. Edhe ne, po ashtu, kishim dashur të theksojmë se është një mangësi e madhe fakti se bordi i këtij autoriteti ka mbetur i pakompletuar për një arsye të thjeshtë, sepse Ministria nuk e delegon ose nuk e propozon anëtarin, i cili është në kompetencë të Ministrisë. Po ashtu vërejmë se Ministria ose ka mbajtur distancë tepër të lartë ndaj çështjeve në telekomunikacion, ndërkaq është marrë më tepër me kritika prej së largu ose atëherë ka ndërhyrë kur faktikisht nuk është dashur, sepse nuk është kompetencë e ministrive të ndërhyjnë në disa prej çështjeve të

procese në telekomunikacion. Nga aspekti i tenderimit dhe nga aspekti i skemës, sa i përket prezencës në tregun e komunikimit me mobil, është fakt se vetëm dy operatorë nuk sigurojnë konkurrencë të vërtetë dhe pa dyshim se dy operatorë në shumë raste nuk e kanë arritur shkallën e konkurrencës e cila mund të vërtetohet de fakto në teren. Besoj se kjo së shpejti do të vërtetohet me nevojën për lejen e tretë të mobilit të një operatori të tretë dhe është çështje e tregut nëse do të kemi nevojë për 3 apo më shumë operatorë.. Duhet të jetë një obsion i lirë dhe të mos jetë politika ajo që do ta caktojë se sa operatorë na duhen realisht. Nga aspekti i bashkëpunimit me komisionin funksional, besoj se Autoriteti i Rregullatorit të Telekomunikacionit **duhet patjetër të vijë më shpesh në komision, gjegjësisht komisioni është ai i cili inicion këtë bashkëpunim më të thellë dhe më të shpeshtë.** Nuk është çështja në atë që komisioni të ndërhyjë, por duhet që komisioni të jetë i informuar drejt nga burimi dhe ne besojmë se së shpejti duhet të fillojmë amendamentimin e ligjit, që të gjitha këto gjëra të mjerren parasysht në frymën më liberale dhe më efikase të funksionimit të një autoriteti rregullativ për telekomunikacion. Si duket çështja e përzgjedhjes së ofertuesit të ardhshëm ne të gjithë pak a shumë e dimë se sa është ndërhyrja e politikës në këtë sferë. Pretendimi që autoriteti rregullativ të jetë një trup i pavarur është praktikisht diçka që nuk funksionon së paku sot për sot. Nga ana tjetër duhet t'i krijojmë parakushtet që ky kompeticion të zhvillohet në kushte sa më reale, më të barabarta për ofertuesit e ndryshëm. Është e vërtetë që oferta duhet të zgjidhet në bazë të përfitimit maksimal nga aspekti i konsumatorit, por të mos harrojmë se po ashtu duhet të zgjidhet nga aspekti i stabilitetit, qëndrueshmërisë së funksionimit të tregut të telekomunikacioneve dhe po ashtu apeloj që mos të ketë mister në telekomunikacion që patjetër duhet të jetë një operator jashtëzakonisht i madh botëror etj, etj. Teknologjitë kanë avancuar mjaft që edhe në forcat tona, kuadrot tona, kompanitë tona të marrin pjesë në operim në një masë më të madhe sesa ajo presupozohet.

Është shumë me rëndësi nga ky aspekt të thellohem dhe të inkurajojmë ART-në që t'i marrë hapat e duhur në aspektin e rregullimit të frekuencave, rregullimit të mediave, aty ku është kompetenca e ART-së dhe veçanërisht në aspektin e rregullimit të tregut i cili krijohet nga ardhja e teknologjive të reja. Ne jemi dëshmitarë në atë se shumë teknologji që nuk janë edhe aq të reja, faktikisht zbatohen nga kompanitë e veçanërisht ato vendore, mirëpo jemi ne prapa me rregullativën tonë dhe në këtë rast edhe ART-ja e cila nuk i siguron kushtet optimale që këto aktivitete ekonomike të zhvillohen në kushte sa më të mira dhe në konkurrencë të drejtë.

Grupi Parlamentar ORA shumë shpesh i ka përkrahur të gjitha institucionet tona e në veçanti ART-në sa i përket shkyqjes së antenave ilegale dhe veprimet ekonomik ilegal në këtë fushë. Ne e përkrahim këtë vendosmëri të ART-së veçanërisht në kohë të fundit dhe shpresojmë e kjo do të jetë sinjal shumë i mirë për operatorët të cilët veprojnë në mënyrë legale dhe po ashtu një sinjal shumë i vendosur për ata të cilët kanë vepruar në mënyrë ilegale ose tentojnë ende të bëjnë këtë. Definitivisht e përkrahim këtë veprim, aktivitetin e ART-së, mirëpo mendojmë se duhet të fuqizohet më tepër, duhet të bazohet në ligjin i cili do të jetë i ndryshuar në këtë aspekt dhe duhet patjetër të bashkëveprojë në bashkëpunim me komisionin funksional përkatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit, në emër të Grupit Parlamentar 6+ ,deputeti Mahir Jakcilar.

DEPUTETI MAHIR JAKCILAR - Sayın Meclis Başkanı, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri ve Sayın ART Başkanı

6+ Parlamento gurubu, 2006 yılına ait Düzenli Telekomunikasyon Acentasının Raporunu özel ilgiyle görüşmüştür.

Parlamento gurubu olarak herşeyden önce, sözkonusu Acenta ile onun müdürünün bu Raporu Meclise sunmaları için seferber olduklarını selamlamak istiyoruz. Bu gibi pratiğin, buna benzer Acentalar tarafından raporların sunulmasıyla devam edeceğine umut etmekteyiz.

Bilinen bir gerçektir ki, geçen yıllar içerisinde, daha doğrusu kuruluşundan beri bu Acenta, kendi yetkileri ile olanakları çerçevesinde, Telekomunikasyon alanındaki bileşik ilişkileri düzene koymaya çaba sarfetmiştir ve bu gün sözünü ettiğimiz alanda düzen sağlamaya hazırdır. Aynı zamanda, Parlamento gurubu olarak bizler, ART bütçesinin yönlendirilmesi ve Kosovadaki telekomunikasyon hizmetlerinin ilerideki gelişme stratejisi siyasetinin önerilmesiyle ilgili gereken katkıyı sunmaya hazır olduklarını selamlıyoruz. Anlaşılan, bu Acenta, mevcut anlaşmazlıklar ile Yasal engellerin saptanması ile ortadan kaldırılmasına hazırdır.

Rapor sözkonusu olduğunda, Parlamento gurubu olarak bizler, etnik mensubiyet açısından çalışanlar strüktürü ile Yönetim Kurulu üyeleri hakkında daha ayrıntılı bilgi edinmek istiyoruz. Somut olarak, bu Acenta ile Yönetim Kurulunda, Türk ile Boşnak mensubiyetine sahip herhangi birinin varolup olmadığını öğrenmek istiyoruz.

Bununla birlikte, Bakanlık, ART Ve UNMIK Bürosu arasındaki daha iyi koordinasyonu kısıtlayan politik ya da somut sorunların neler olduğunu bir kez daha işitmek istiyoruz.

Örneğin, VALA 900 hizmetlerinden yararlananların haklarının korunması, kötü, pahalı ve kaybolan hatların, daha doğrusu bu hatlardan faydalananların paralarının yitirilmesi ya da Ramazan Bayramının ilk gününde olduğu gibi hatların olmamayışi yönünde, bu Acenta ne gibi önlemler almıştır diye sormak istiyoruz. Azınlıklar topluluklarının yaşadıkları yerlerde /Jupa, Gora vb/ hatların düzelmesi doğrultusunda neler yapıldı?

Sonunda bir kez daha bu Raporu Meclise sunan ART yetkililerini kutluyoruz ve aynı zamanda bu günkü tartışmalardan sonra Telekomunikasyon alanında durumun düzeleceğine ve Kosova yurttaşlarının istemlerinin başarıyla yerine getirileceğine umut etmekteyiz.

İlginize teşekkürler!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI - E ka fjalën deputeti Demir Limaj.

DEPUTETI DEMIR LIMAJ – I nderuar z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë. Agjension i ART-së është bërë temë e përditshme dhe brengë për shkak të mosfunksionimit të duhur dhe joprofesional. Unë nga disa diskutues të mëhershëm që i dëgjuam dhe që shfaqën vendosmërinë për këtë agjencion, me të drejtë i pyes dhe them se ne nuk dëshirojmë me qëllim të shohim realitetin tonë dhe ne nuk jemi të përgjegjshëm edhe moralisht edhe politikisht që t'i qartësojmë gjërat dhe t'i shohim me të vërtetë ashtu

siç janë. Unë ndihem personalisht shumë mirë, sepse nuk u takoj grupimeve të ndryshme që janë duke lobuar për operatorin e dytë të telefonisë mobile dhe disa grupimeve që i shohin interesat e veta në dëm të qytetarëve të Kosovës.

Si mund të lavdërohet dhe të jepet vendosmëri e madhe këtij agjensioni kur me miliona e miliona euro është i dëmtuar buxheti i Kosovës nga operatorët ilegalë, përkatësisht nga operatorët serbë.

Të nderuar kolegë deputetë, para jush do t'i paraqes disa pyetje që i drejtohen ministrit Qemajl Ahmeti, në veçanti kryetarit të këtij Agjensioni. I nderuari z. ministër edhe pse nuk gjendet këtu që shpesh herë ndodh të mos jetë kabineti qeveritar në seanca parlamentare, sepse kanë punë më të mençura dhe më të mëdha, por sidoqoftë unë dua ta pyes përmes Parlamentit ministrin se a është në dijeni për punën e ART-së dhe a bashkëpunon me këtë agjension ministri i Posttelekomunikacionit. Nuk e di se z. Qemajl Ahmeti a e di se operatorët ilegalë operojnë në Kosovë që sa vite, me çka janë blerë pronat nacionale të Kosovës, kurse i vetmi operator Vala 900 paguan licencë. Pse e lejoni këtë dhe çfarë keni bërë lidhur me këtë? Mendoj se përgjigjen do ta marrim nga vetë ministri Ahmeti ose nga kryetari i këtij agjensioni. Operimi i operatorëve ilegalë ka dëmtuar dhe po dëmton në vazhdimësi buxhetin e Kosovës me miliona euro. Operatorët ilegalë që sa vite veprojnë në Kosovë nuk paguajnë TVSH, nuk paguajnë tatim në fitim dhe nuk paguajnë për përdorimin e frekuencave. Këto veprime dhe këta operatorë dëmtojnë buxhetin e Kosovës dhe për këtë janë përgjegjës institucioni i ART-së dhe Ministria, sepse lejuan operatorët të veprojnë në Kosovë ilegalisht. Përkundër masave që janë marrë kohëve të fundit për shkyçjen e tyre kjo nuk i mbulon dhe nuk i arsyeton aspak miliona euro që janë humbur me vite dhe që nuk janë derdhur e që kanë pasur mundësi të derdhen në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

UNMIK-u me anë të një letre u ka kërkuar të mos ndërpriten antenat e Mobtelit në zonat ku jetojnë serbët, por operatorët tash kanë zgjeruar rrjetin në zona ku serbët nuk jetojnë fare. Pyes pse nuk bëhet shkyqja totale edhe nga Ministria në këtë rast, pse lejohet kjo? Licenca për operatorin e dytë e anuluar nga UNMIK-u me akuzë se ka pasur korrupsion si mund të na bindni që kësaj radhe do të bëni një vlerësim të drejtë dhe të paanshëm për operatorin e dytë? Kryetari së bashku me bordin e ART-së kanë konsideruar se zgjedhjen që e kanë bërë ART-ja për fituesin e dytë të telefonisë Mobitel, Mobikos ka qenë e drejtë, përkundër vendimit të UNMIK-ut dhe kërkesës së Qeverisë së Kosovës për anulim. Po që se i njëjti operator prapë konkurren pyes, a mendoni se do t'i trajtoni njëjtë si të gjithë të tjerët kur dihet fakti se sa keni luftuar që Mobiteli, të cilit edhe i keni dhënë licencë, të fillojë operimet përkundër ndalesës së UNMIK-ut. Sa mendoni që do të jetë licenca për operatorin e dytë të telefonisë mobile me cilat institucione të Kosovës do të konsultoheni për vendosjen e çmimit, kur dihen se frekuencat janë resurse të limituara të një vendi dhe buxheti ka nevojë për para. Telenori prej 1 shtatorit që aksionari kryesor i Mobtelit operon në Kosovë pa regjistrim me zyre në Prishtinë, pa adresë, pa paguar taksa dhe parashihet që këta do të konkurrojnë në operatorin e dytë. Pyes përgjegjësin e ART-së a duhet të eliminohet 600.000€ iu kanë dhënë ART-së si ndihmë për themelimin, ato para që janë marrë si ndihmë nga PTK-ja, nuk janë kthyer, përkundrazi ART ka kërkuar mjete shtesë. A do t'i merrni parasysht këto dhe kur do t'ia ktheni PTK-së ato mjete. 2 milion e 900.000 € është bërë licencimi i telefonisë fikse të Posttelekomit të Kosovës që nuk ka pasur nevojë për këtë, por kjo ka ndodhur, kurse për licencim për kompaninë e Ipkonetit që aksionarët e të cilës nuk i dimë as ne se nga janë dhe kush janë, ART ka marrë 90.000 €. Dua të pyes se çfarë kriteri është përdorur për telefoninë fikse e çfarë për Ipkonetin, Ky është një dallimi i madh, të nderuar kolegë deputetë, në mes të

këtyre dy shumave. Shtrohet pyetja ku janë gjetur të gjitha ato mjete, çka është bërë me ato mjete, pse për telefoninë fikse 2 milion 900.000€, kurse për Ipkonetin 90.000€. Përgjigjen për këtë do të na japin përgjegjësi i ART-së dhe ministri i Transportit.

Pse nuk bëjnë ftesë publike për ofertim dhe licenca të telefonisë fikse, ekziston ligji i cili e rregullon se si licencat të lëshohen, a është përcjell ky ligj, absolutisht jo, ART-ja kohën e fundit ka lëshuar licenca pa ftesë publike për ofertim, në këto licenca nuk është cekur, përkatësisht as dhënë obligime në mbulueshmërinë e rrjetit që do të garantonte qasje jodiskriminuese për të gjithë qytetarët e Kosovës. Kjo nuk ka ndodhur dhe pyes pse. Kryetari i bordit të ART-së ka sabotuar licencat ekzistuese dhe duke u mbështetur nga të gjitha këto që i ceka më lart. Kërkoj që i gjithë bordi së bashku me kryetarin e këtij agjensioni të shkarkohen menjëherë dhe në të njëjtën kohë të fillojnë procedurat e auditimit dhe inspektimit për punën e këtij agjensioni dhe bordit së bashku me kryetarin e ART-së. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Fjalën e ka deputetja Brikenda Kryeziu, kurse le të përparitet deputeti Naim Maloku.

DEPUTETJA BRIKENDA KRYEZIU – Ju faleminderit z. kryesues, e nderuara znj. ministre, të nderuar kolegë deputetë.

Fillimisht falënderoj z. Berisha për raportin paraqitur dhe gatishmërinë e tij që të ofrojë informata dhe pranë Komisionit për Tregti, Ekonomi, Telekomunikacion në të cilin edhe unë jam pjesëtare. Bazuar në Ligjin e telekomunikacionit në të cilin përcaktohet autoriteti dhe kompetencat, Ministria e Transportit dhe telekomunikacionit aplikon hartimin e politikave të cilat duhet t'i implementojë ART-ja si trup i pavarur brenda institucioneve të pavarura dhe përmes përfaqësuesit special në të cilin sipas kornizës kushtetuese po mban përgjegjësinë e rezervuar. Në kuadër të aktiviteteve ky organ raporton për veprimtarinë e vetë që përfshinë menaxhimin e mjeteve publike të telekomunikacionit, menaxhimin e radiofrekvencave të cilat gjithashtu menaxhohen nga zyra e menaxhimit të frekuencave pranë UNMIK-ut. Rregullimin e industrisë së transmetimit të cilat ekzekutohen nga Komisioni i përkohshëm i mediave. Në raportin e ART-së janë përfshi raportin financiar ashtu siç u cek edhe nga parafolësi z. Berisha, aktivitetet e deritanishme dhe objektivat të cilat ky organ i ka në aspektin afatgjatë.

Raporti financiar i bazuar në nenin 5 të ligjit të telekomunikacionit bartë të dhëna mbi aktivitetet financiare të cilat janë realizuar gjatë periudhës të vitit 2005, për të cilën fillimisht komisioni për buxhet dhe financa i ka shqyrtuar dhe vlerësimin përfundimtar do ta jep vetë Kuvendi.

Komisioni për Tregti, Ekonomi dhe Telekomunikacion ka pasur rastin ta shqyrtojë dhe t'i paraqes rekomandimet e veta lidhur me aktivitetet e punës së ART-së. Fillimisht do të vlerësoj se problem kryesor i ART-së dhe moszbatueshmërisë së plotë të ligjeve të plotë dhe detyrave dhe obligimeve që ka ndaj çështjeve esenciale është sepse përcaktimi i detyrave që janë parashtruar me ligj dhe mungesa e instrumenteve që e përcjellin këtë institucion për zbatimin e plotë të ligjit. Shembull konkret kemi çështjen e operatorëve ilegal dhe shfrytëzimin e frekuencave e cila është kompetencë e rezervuar e zyrës së menaxhimit të frekuencave pranë UNMIK-ut dhe e cila deri më tani ka shpreh një interferencë sa i përket pengimit të operatorëve ilegal nëpërmes infrastrukturës ilegale frekuencore të cilat kanë ndikuar negativisht edhe në ekonominë e gjithmbarshme të vendit, duke humbur miliona euro të buxhetit të Kosovës. Kjo njëkohësisht ka ndikuar edhe në dobësimin e Autoritetit Rregullator dhe në marrjen e masave të duhura.

Në bazë të dokumentacionit që posedoj shihet qartë se problemet e tilla janë adresuar edhe në nivele të larta të UNMIK-ut dhe shtyllës IV, në të cilën potencohet edhe kërkesa e ART-së për përfshirjen e UNMIK-ut në zbatimin e ligjit dhe përkrahjen e largimit sa më të shpejtë të operatorëve ilegalë. Përfshirja e Zyrës së menaxhimit të frekuencave konform kërkesës deri kohë më parë nuk ka dhënë shenja inkurajuese. Në periudhën e fundit kjo është vërejtur një bashkëpunim ndërinstytucional në neutralizimin dhe pengimin e operatorëve ilegalë në mbarë territorin e Kosovës. Ndikimet negative në rritjen e të hyrave për shfrytëzimin e frekuencave gjithsesi paraqesin edhe licencimin e brezit publik mobil, point – point dhe point – multipoint për të cilat Zyra e menaxhimit nuk i ka përcaktuar tarifën e këtij spektri dhe njëkohësisht ka ndikuar në zvogëlimin e buxhetit të Kosovës. Problemi i theksuar i këtij institucioni është edhe struktura joadekuate, organizative e stafit dhe mungesa e plotësimin me anëtarin e bordit. Bashkëpunimi i kënaqshëm me Komisionin e Pavarur të Mediave të cilat gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm në aktivitetin e këtij organi. Pjesë e këtij raporti janë edhe objektivat e ART-së dhe aspekti kohor i përmbushjes së obligimeve në harmoni me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane. Sa i përket raportit të konformitetit, legjislacioni i Kosovës në aspektin e telekomunikacionit është në harmoni të plotë me ligjet e Bashkimit Evropian dhe në praktikën aktuale të cilat aplikohen këto ligje. Ligji i telekomunikacionit është i harmonizuar me kornizën e Bashkësisë Evropiane të vitit 98 dhe shprejsojmë se Ministria e Transportit Postës dhe e Telekomunikacionit, në bashkëpunim me ART-në do të arrijë ta harmonizojë me kornizën e Bashkësisë Evropiane të vitit 2003. Ministria gjithashtu, përcakton edhe detyrën e ART-së në harmonizimin e Kornizës së BE lidhur me licencimin.

Kohë më parë është diskutuar mjaft në media dhe publik. Licencimi i Ipkos ashtu siç u cek edhe nga parafolësi im. Shërbimet fikse për të cilat tarifën janë të parashikuara në bazë të vlerësimit të Rregullores mbi licencat dhe autorizimet. Tarifën të cilat janë përfshirë në tarifën e Kosovës pranë Komisionit Evropian.....i cili gjendet në Bruksel. Ky shërbim licencohet në bazë të tarifave për shfrytëzimet e limituara kohore në të cilën nuk përfshihen frekuencat dhe enumeracioni, për të cilat do të nevojitej një tenderim në formë tjetër. Në bazë të raporteve të paraqitura, të arriturat e ART-së pasqyrojnë një intensifikim të aktiviteteve premtuese. Mirëpo , gjithsesi, duhet të merren edhe disa hapa për avancimin e përgjithshëm me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme në aspektet të cilat ky organ i mbulon, andaj duke e përkrahur raportin në tërësi, më lejoni që t'i paraqes disa rekomandime lidhur me këtë raport:

ART t'i intensifikojë çështjet me interes nacional ,të cilat nevojiten duke i aplikuar politikën afatshkurta me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga ligji.

Një angazhim më të madh për bashkëpunim të ngushtë me zyrën e menaxhimit të frekuencave dhe në bartjen sa më të shpejtë të kompetencave tek vendorët, faktikisht tek autoriteti rregullativ.

Një bashkëpunim të ngushtë me Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

Vazhdimësi në përmbushjen e politikave afatmesme dhe afatgjata në krijimin dhe mundësinë e investimeve të jashtme.

Duke u bazuar në iniciativën e fundit për largimin me sukses të operatorëve ilegalë, një angazhim të shtuar për vëzhgimin permanent dhe për parandalimin me kohë të aktiviteteve të tilla ilegale.

Zgjedhjen sa më të shpejtë dhe licencimin e operatorëve mobilë të cilët do të mundësojnë një treg të lirë dhe jodiskriminues, gjithashtu një konkurrencë lokale,

Duke u bazuar në të gjitha këto të cilat u cekën edhe nga parafolësi shpresoj që autoriteti rregullativ do t'i marrë parasysh rekomandimet e tilla dhe në bashkëpunim me Komisionin e Telekomunikacionit do të arrijë t'i përmbushë të gjitha obligimet. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Naim Maloku, kurse le të përgatitet deputeti Zef Morina.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Faleminderit z. kryesues. Të nderuar ministra kolegë deputetë. Edhe unë u bashkangjitem parafolësve të mi në lidhje me raportin që sot po e shqyrtojmë. Më lejoni të vlerësoj punën e Komisionit funksional dhe angazhimin e të gjithë anëtarëve të tij ,të cilët para nesh kanë sjellë këto rekomandime nga një punë jashtëzakonisht me përkushtim. Vetë fakti që disa herë Komisioni ka kthyer raportin e ART-së për plotësimet e nevojshme dhe për plotësime shtesë, tregon një përkushtim të komisionit funksional që e ka pasur në lidhje me vlerësimin e punës së ART-së. Ftoj edhe komisionet tjera dhe agjensionet e tjera që t'i raportojnë Kuvendit të Kosovës në këtë mënyrë dhe komisioneve funksionale. Mbështes edhe një herë rekomandimet e Komisionit funksional të plotësuara me rekomandimet e tjera që dalin nga këto diskutime dhe një herë potencoj se duhet t'u japim afat të caktuar Ministrisë dhe Qeverisë për hedhjen në votim në Kuvend edhe të anëtarit të pestë të bordit të ART-së në mënyrë që bordi të kompletohet sa më parë. Vlerësoj angazhimet e ART-së në zbatimin e ligjit në Kosovë në lidhje me operatorët ilegalë dhe me ngushtimin e fushëveprimit të tyre në territorin e Kosovës. Vlerësoj bashkëpunimin e ART-së me UNMIK-un dhe mekanizmat e tjerë për të rregulluar çështjen e operatorëve ilegalë për të ngushtuar veprimtarinë e tyre në territorin e Kosovës. Më lejoni t'i ftojë afaristët kosovarë, kompanitë kosovare që qoftë vetë ose së bashku me partnerë të jashtëm, të konkurrojnë në tenderin për operatorin e dytë të telefonisë mobile. Mendoj se kyçja e afaristëve vendorë do ta pasuronte konkurrencën dhe kishte me qenë mirë edhe për Kosovën që përqindja të jetë sa më e madhe për afaristët vendorë në fitimin e licencës së telefonisë së dytë mobile. Përkrah iniciativën që u tha nga përfaqësuesi i Grupit Parlamentar Ora për ndryshimin e Ligjit për Telekomunikacionin ,në mënyrë që ne të kemi edhe operatorin e tretë të telefonisë mobile dhe për t'u rritur konkurrenca në Kosovë , me siguri do të çon nga përsosshmëria më e madhe, shërbimet më kualitative dhe normalisht të çmimet më të ulëta dhe krejt në fund duke e përkrahur edhe një herë rekomandimet e Komisionit funksional më lejoni që të mbështes punën e ART-së dhe normalisht që t'i japim mbështetje për punë të mëtutjeshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Fjalën e ka deputeti Zef Morina, kurse le të përgatitet deputetja Hatixhe Hoxha.

DEPUTETI ZEF MORINA – Faleminderit z. kryesues, të nderuar znj. dhe zotërinj. Nga përfaqësuesi i ART-së dëgjuam raportin e punës që ART-ja gjatë këtyre tri viteve është përpjekur për të realizuar, duke u bazuar në kompetencat që i jep Ligji mbi telekomunikacionin. Në materialin e fundit që na është dërguar me shkrim nga ART-ja pas vërejtjeve që janë bërë nga komisioni funksional dukshëm vërehen ndryshime në krahasim me raportin që na është dërguar më herët, që shihet se sa me seriozitet është marrë detyrimi ligjor që ART-ja ka sipas ligjit për t'i raportuar Kuvendit. Në raport

rëndësi e veçantë i është dhënë çështjes financiare ,duke lënë anash çështjen financiare dhe atë kruciale, raportin e punës të këtij agjensioni gjatë këtyre tri viteve. Mendoj se për të konstatuar efektshmërinë e punës së ART-së duhet në mënyrë të veçantë të vlerësohen veprimet pozitive dhe negative të punës, gjegjësisht rezultatet dhe dështimet, kështu që nga vlefshmëria e këtyre veprimeve është lehtë të konstatohet suksesi apo mospuksesi i ART-së. Në këtë muaj bëhen 3 vite që kur ka filluar punën ART-ja e votuar nga Parlamenti i Kosovës, ndërsa është hera e parë që i raporton Kuvendit për punën e kryer,duke u bazuar në obligimet dhe kompetencat që i jep Ligji mbi telekomunikacionin. ART-ja është dashur, së paku një herë në vit t'i raportojë Kuvendit të Kosovës, por në mungesë të punës është e kuptueshme se për këto tri vite ART-ja nuk ka pasur kohë t'i raportojë Kuvendit përpos dështimeve në punën e saj. Në dhjetor të vitit 2003, nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit është shpallur tender ndërkombëtar për operatorin e dytë të telefonisë mobile dhe i është dorëzuar ART-së, që në mënyrë profesionale duke u bazuar në Ligjin mbi telekomunikacionin dhe në Rregulloren e prokurimit të bëjë përzgjedhjen e kompanisë me referenca të mira, e cila i plotëson kriteret më së miri.

Edhe pse ishte rasti i parë i një projekti madhor, me rëndësi nacionale, ART-ja nuk ishte e përgjegjshme, duke mos marrë punën me seriozitet dhe që nga fillimi bëri shkelje të ligjit ,duke bërë ndryshimin e kriterëve, nga materiali tenderues, të përcaktuara nga Ministria, gjegjësisht Qeveria, kështu që gjithë puna në vazhdim, është përcjellë me shkelje të njëpasnishme. ART-ja që në fillim ka bërë shkeljen e Lgjit të telekomunikacionit neni 36. i të cilit thotë se ART-ja është e obliguar që në koordinim të ngushtë me PSSP, të lëshojë të drejtën për shfrytëzimin e radiofrekuencës për GSM, që me sjelljen e saj jokorrekte dhe është konfrontuar me UNMIK-un ,duke u munduar ta bind se, kanë të drejtë dhe se nuk duhet të ndërhyjnë në punën e ART-së, pasi sipas tyre janë krejtësisht të pavarur.

Shkelje tjetër që i është bërë ligjit ,bazuar në po këtë nen dhe shkeljes së vendimit mbi kriteret e materialit tenderues, të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit është se, për arsye të njohura, i ka mundësuar pjesëmarrjen dhe më vonë edhe licencën kompanisë e cila në Kosovë operonte ilegalisht. Ndërsa ligji në mënyrë të prerë, i përjashton nga pjesëmarrja në tenderim kompanitë të cilat vepronin në Kosovë, kurse njëri nga kriteret në materialin tenderues ka qenë që: kompanitë të cilat kanë vepruar në Kosovë, e nuk i kanë paguar obligimet tatimore vendit sipas ligjit, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në tender.

Edhe përkundër vërejtjeve të bëra nga Ministria, Qeveria dhe UNMIK-u, vërejtjet të konstatuara nga raporti vlerësues i kompanisë profesionale, kombëtare HELN, për lëshimet e bëra nga komisioni vlerësues. ART-ja ishte këmbëngulëse për rregullsinë dhe përzgjedhjen e kompanisë më të mirë. Edhe pse e dinim edhe vetë se nuk ishte ashtu. Si është e mundur që një material profesional voluminoz, i përgatitur në gjuhën angleze, të vlerësoj aq drejtë dhe pa lëshime nga Komisioni vlerësues, ku nga 5 anëtarët, e komisionit 4 prej tyre, nuk kuptonin as pjesërisht gjuhën angleze, në të cilën ishte përgatitur materiali. Për shkak të papërgjegjësisë totale të ART-së, është dashur të kalojnë më shumë se dy vjet e gjysmë për të rifilluar çdo gjë nga e para,pa qarë kokën për dëmet që i kanë shkaktuar buxhetit të varfër të qytetarëve të Kosovës. Përveç kësaj, ne si institucione vendore dhe si Kosovë, fituam një imazh të keq karshi investitorëve dhe

donatorëve të huaj, të cilët dëshirojnë të investojnë në Kosovë, duke u dhënë me kuptuar se këtu nuk respektohet ligji.

Po të bëhet një vlerësim analitik dhe të përcaktoheshin humbjet që kanë pësuar qytetarët e Kosovës gjatë këtyre viteve të shkuara, në këtë sektor analizat tregojnë se për mungesë të operatorit të dytë, qytetarët kanë humbur rreth 50 milion €, vlerë që për standardin tonë do të ishte e barabartë me 1 miliardë € në humbjet e SHBA, ose në Zvicër. Më lejoni të them se jo të gjithë anëtarët e ART-së janë përgjegjës për atë që ka ndodhur në sektorin e telekomunikacionit, sepse gatishmëria për të ndihmuar profesionalisht nuk është përfillur nga bordi i ART-së.

Ministria e Transportit, me ekspertët vendorë dhe të UNMIK-ut, gjatë përgatitjes së materialit të parë tenderues, i ka kursyer buxhetit të Kosovës, mbi 150 mijë €, ndërsa për përgatitjen e materialit tani Qeveria është dashur t'i shpenzojë 150 mijë €, për të kontraktuar një kompani të huaj, vetëm për përgatitjen e materialit tenderues. Mendoj se për dëmet e shkaktuara duhet kërkuar përgjegjësi dhe të merren masa ligjore ndaj personave përgjegjës, në mënyrë që kjo të mos përsëritet më në vlerësimin e tenderit të rishpallur.

Shikuar në përgjithësi situata në fushën telekomunikuese është kaotike. Nga kjo gjendje janë duke pësuar qytetarët e Kosovës, të cilët përveç që, paguajnë tarifa shumë të larta dhe kualitet të dobët nga operatori i vetëm legal, vala 900, janë të detyruar që pa fajin e tyre, të gjobiten me tarifa shumë më të larta, nga ndërhyrjet e operatorëve ilegalë, të cilët veprojnë në Kosovë pa pengesa, duke shkaktuar kaos të vërtetë në telekomunikacion. Numri i tyre mund të jetë deri në 10 operatorë.

ART-ja në këtë drejtim ka qenë tërësisht neglizhente, dhe e pa përgjegjshme, duke mos marrë masa konkrete në eliminimin e kësaj gjendje, por më tepër është orientuar në veprimet deklarative, duke u arsyetuar nëse nuk ka mbështetje, nga institucionet më të larta. Është dashur të pritët që nga Kosova të vilen rreth 150 milion €, prej veprimeve të operatorëve ilegal nga Serbia, për të filluar këto ditë me shkyçjen e pajisjeve të këtyre operatorëve, që do të thotë se, nuk ka munguar mbështetja institucionale, por ka qenë neglizhenca dhe jo-gatishmëria e ART-së, për të vepruar.

Mendoj se është koha e fundit që Parlamenti i Kosovës, i cili e ka votuar këtë bord, të thotë fjalën e vetë, në mënyrë që situata në këtë fushë, të ndryshoj për të mirë. Në të kundërtën, përgjegjësia do të bie mbi anëtarët e këtij parlamenti, dhe se, deputetët nuk mund të arsyetohen para qytetarëve, për atë që po ndodhë në këtë sektor shumë të rëndësishëm ekonomik dhe strategjik të vendit.
Ju faleminderit!

KRYESUESI – GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit! E ka fjalën deputetja Hatixhe Hoxha, le të përgatitet deputeti Gani Koci.

DEPUTETJA – HATIXHE HOXHA

Zotëri kryesues, të nderuar deputet!

Sfera e Telekomunikacionit paraqet interes strategjik në çdo vend të botës, ndërsa Telefonia mobile është një prej tregjeve më të përhapura në fushën e telekomunikacionit në botë. Në Kosovë kemi ngecje në zhvillimin e këtij sektori kaq të rëndësishëm. Prandaj, duke pas parasysh gjendjen e rëndë në fushën e telekomunikacionit si dhe në ART-ë, është kërkuar disa herë rradhazi nga deputetët që përfaqësuesi i ART-së, të raportoj para Kuvendit.

Dhe më në fund pas një vonese të tej zgjatur sot po shqyrtoj më Raportin e punës së ART-së, dhe po e theksoj se, edhe sipas Ligjit të Telekomunikacionit, neni 13 pika 7, ART-ja është e obliguar t'i dorëzojë Kuvendit raportin vjetor mbi punën e saj gjatë vitit paraparak.

Por edhe pse ART ja obligohet me Ligj për këtë, ajo asnjëherë deri më tash nuk i është drejtuar Kuvendit, ashtu siç obligon ligji në fuqi.

Jam munduar ta lexoj dhe analizoj me kujdes raportin që kemi para vetës dhe ta krahasoj atë me të dhënat faktike në term.

ART ja me ligj është përgjegjëse për:

1. zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit;
2. liberalizimin e tregut të telekomunikacionit;
3. dhe është e obliguar të mbroj interesat e konsumatorëve në fushën e telekomunikacionit;

Të gjithë jemi dëshmitarë të asaj se në Kosovë veprojnë shlrshëm operatorë të palicensuar të cilët po e përdorin hapsirën tonë, për përfitime të mëdha dhe s'kanë asnjë detyrim ndaj vendit tonë, për faktin se ata nuk derdhin as edhe një cent në Buxhetin e Kosovës.

Askund në botë nuk ndodh që kaq Date të lejohet operimi i egër i operatorëve ilegal.

Sipas disa informacioneve thuhet se operatorët serbë 064 / 063 deri me tash janë shtriturë në njëzetë e tetë zona të Kosovës.

Dihet se përveç operatorëve që kanë shtuar kapacitetin e tyre veprues në afërsi të kufirit me Kosovën, ne kemi edhe vendosjen e infrastrukturës operuese edhe Brenda territorit të Kosovës.

Fuqia e antenave të instaluar në këto pjesë është disa here më e madhe se sa normat e lejuara. Këto antena të operatorëve serbë të përforcuara në vendet e banuara paraqesin rrezik për shëndetin e banorëve.

Ju para disa muajsh z. Berisha me pompozitet patët deklaruar se do të çoni deri në fund akcionin për heqjen e antenave të operatorëve ilegal. Por pas një kohe çdo & ra në heshtje, tash sërish keni filluar heqjen e antenave dhe nuk e di se deri ku do të arrini.

Me intereson të di z. Berisha se a është bërë nga ju ndonjë përllogaritje se sa i kanë borxh Kosovës këta operatorë?

Përveç se veprojnë në mënyrë ilegale, operatorët serbë të telefonisë mobile 063 dhe 064 thuhet se ata malirat e tyre i fusin në Kosovë pa asnjë taksë doganore apo TVSH.

Deri me sot mendohet se ata kanë future në Kosovë 42 antena për forcim të rrjetit pa paguar taksat, duke i sjellur kështu humbje buxhetit të Kosovës nga mospagimi i obligimeve doganore dhe TVSH mbi 1 milion E.

Po ua përkujtoj z. Berisha se ART-ja është e obliguar me Ligj të liberalizoj tregun e telekomunikacionit;

Dua t'ua rikujtoj me këtë rast se ju keni shpallur fituesin e operatorit të dytë të telefonisë mobile në vend, dhe keni nënshkruar kontratën me MobitelMobikosin.

Por, pas vendimit tuaj, pasoi vendimi i PSSP-se , pas reagimeve të Kryeministrit të atëhershëm Rexhepi, dhe të përfaqësuesve të shteteve të Quintit në Prishtinë, per faktin se ka pas shkelje në këtë proces.

Për të bërë vlerësimin e tenderit dhe mënyrën se si është proceduar ky tender, UNMIK-u pati angazhuar kompanin HELM, dhe në raportin e bërë nga HELM në gusht të 2004 thuhej në mes të tjerash se faza e parë e procedimit të tenderit ka pasur lëshime të mëdha, dhe se lëshimet e bëra në fazën e parë kanë mundur të ndikojnë në rezultatin final të tenderit nga I cili doli fitues kompania Mobitel Mobikos:

Vrejtjet kryesore ishin këto:

1. ofertuesit nuk kanë paraqitur raportet financiare ku do të shihej qëndrueshmëria e tyre financiare.
2. Në të gjitha dokumentet të cilat I ka përdorur Komisioni Special per vlerësimin e ofertave përfundimtare janë shqyer dhe të gjitha shënimet në Kompjutor janë fshirë.
3. Si është e mundur Z. Berisha të caktohen në Komisionin njerëzit që nuk e kanë njohur gjuhën angleze, për faktin se I gjithë materiali që I është ofruar komisionit ka qenë vetëm në gjuhën angleze.

Ja Raporti i HELMIT

Qeveria e Kosovës pati planifikuar si të ardhura të sigurta 6.5 milion E nga licensimi i operatorit të dytë të telefonisë mobile.

Ju pyes ju se a është menduar se sa dëme 11 anë shkaktuar ekonomisë sonë me këto veprime?

Për faktin se rreth dy vitesh ka mbetur i bllokuar licensimi i operatorit të dytë të telefonisë mobile në nëntor 2005 është kërkuar të bëhet rivlerësimi i operatorit të dytë të telefonisë mobile dhe Qeveria për kompaninë që do të bëjë rivlerësimin ka paguar 150 000 E.

Dëshiroj t'ua rikujtoj të nderuar deputetë se pak para shkarkimit të tij Kryeministri Kosumi pati shpallur fitues ofertuesin Mobitel-Mobikos edhe pse nuk ka qenë detyrë e kryeministrit të bënte një gjë të tillë.

Më pas Kryeministri (eku e anuloi vendimin e paraardhësit të tij edhe pse s'është detyrë e kryeministërve të shpallin apo anulojnë vendimet për shpalljen e fituesve të operatorëve të telefonisë mobile.

Në muajin prill të vitit 2006, Qeveria ka angazhuar një Kompani konsulente ndërkombëtare e cila do të përgadis pjesëmarrjen e kompanive në tender për operatorin e dytë të telefonisë mobile, dhe për këtë shërbim është thënë se Qeveria do të paguaj 250 000 E.

Kj o është hera e dytë që Qeveria ka paguan për shërbime konsulente për të njëjtin tender të telefonisë mobile.

Është thënë nga ju në një rast se ART-ja këtë punë do ta kryente përgjysmë më lirë, pra vetëm për 120. 000 E.

Z. Berisha a nuk mendoni se pasi që Qeveria ka angazhuar një Kompani të huaj për këtë çështje e jo ju a nuk flet kjo për mungesë mosbesimi nga ana e Qeverisë ndaj jush?

Të nderuar deputetë,

Vonesa në përzgjedhjen e telefonisë mobile dmth:

- 1.Humbje kohe,
- 2.Humbje mjeteve financiare të Buxhetit të Kosovës,
- 3.Dëmton qytetarët dhe
4. Dëmton rënd edhe imazhin e Kosovës para ndërkombëtarëve.

Në lidhje me këtë shih letrën e z. Brajshou të datës 3 gusht 2004, drejtuar kryeministrit të atëhershëm Rexhepi.

"Menaxhimi i drejtë i këtij procesi nga ana e Qeverisë do të ketë efekt të rëndësishëm mbi reputacionin ndërkombëtar të Kosovës, sit ë një vendi ku aktivitetet e biznesit zhvillohen në përputhje me ligjin dhe praktikat e pranuar ndërkombëtare".

Ja letra e Z. Brajshou:

Duke i pas parasysh të gjitha këto të dhëna pata kërkuar në emër të Grupit parlamentar në seancën e datës 8.9.2004 të hapet debat për këtë çështje.

Fjala ime:

Dua ta theksoj se sipas ekspertëve, nga ngecjet në sektorin e Telekomunikacionit gjatë këtij viti Kosova ka humbur qindra million €. Ndërsa për mungesë të Kodit dhe të veprimt të operatorëve ilegalë, humbjet vj etore j anë me miliona Euro.

Ju pyes ju se pse Bordi i ART-së funksionon me vetëm 4 anëtarë, kur me ligj Bordi duhet të ketë 5 anëtarë.

Si është lejuar që Bordi të funksionojë në vazhdimësi në përbërje jo të plotë?

Me ligjin për Telekomunikacion ART-ja është e obliguar të krijoj kushte të njëjta operimi për të gjithë operatorët.

Pyetja ime është : Mbi çfarë kriterësh mbështetet ART-ja kur cakton tarifat?

Për faktin se Siç duket ART-ja nuk aplikon tarifa të njëjta për licenca telefonike.

Kështu në vitin 2004, PTK ja ka paguar 2.9 milion E për të marrë licencën për shërbimet e telefonisë fikse, ndërsa tash,

Kompania "Ipko Net" për Vu pajisur me licencën e shërbimeve telefonike fikse i ka paguar ART-se 90.000 E.

Nga Raporti që kemi para vetës si dhe gjendja faktike në terren del se: Qeveria e Kosovës, ministria përkatëse si dhe ART-ja nuk kanë arritur që të:

1.Thyejnë monopolin e telefonisë mobile (për faktin se Vala 900 vazhdon të mban monopolin në fushën e telefonisë mobile në Kosovë, ndërsa qytetarët e Kosovës më të varfërit në Evropë do të vazhdojnë të kenë:

- a. shërbimet me të dobëta; b. Tarifat me të lartat;c. dhe do vazhdojë të paguaj stafin menaxhues me shumë se i tërë regjioni.)

2.Qeveria e Kosovës, ministria përkatëse si dhe ART-ja: nuk kanë arritur të ndërpresin aktivitetin e operatorëve ilegal;

Nga e gjithë kjo që u tha me lartë mund të konkludojmë se:

ART -j a nuk ka: 1. Menaxhuar mirë, përkundrazi ajo ka keqmenaxhuar;

2. Nuk ka arritur të liberalizoj ë tregu, por përkundrazi ai ka mbetur i monopolizuar, është dëmtuar Buxheti i Kosovës, janë dëmtuar qytetarët dhe është dëmtuar imazhi i Kosovës.

Prandaj, edhe unë mbështes kërkesën e Grupit parlamentarë të PDK-s për shkarkimin e bordit të ART-se, dhe kërkojmë që Kuvendi të deklarohe për këtë me votim.Hatixhe Hoxha 17.11.2006

KRYETARI – KOLË BERISHA

Ju faleminderit! fjalën e ka deputeti Gani Koci, përgatitet deputeti Bajrush Xhemajli

DEPUTETI – GANI KOCI

Ju faleminderit zotëri kryetar. Mirë bëre që erdhe se... patëm me më lënë deri në fund këtu. Mos me fol, po më duket edhe ne deputetët jemi ngatërruar në kohë, qysh është ngatërruar ART-ja në frekuenca, në valë etj.

Jemi ngatërruar në kohë se po flasim në mënyrë të përgjysmuar. Para vetes kemi një raport që ka një fillim dhe ka një mbarim. Po flasim për raportin e vitit 2005 dhe jo për

veprimet e ART-së, në vitin 2006. për veprimet e SRT-së në vitin 2006, do të flasim pak më vonë, prandaj ata që i ngrisin krahët në veprime të mira të ART-së në vitin 2006. t'i lëmë të flasin në 2007. dhe këtu të flasin për veprimet në vitin 2005.

Neni 4. pikal. e ligjit që po citohet shumë, shqyr që nuk është i 1984 atje po, e kemi pak ma hershëm, thotë se Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit është autoritet i pavarur, joprofitabil, brenda Ministrisë së Transportit dhe të Postelekomit, i cili zbaton politikat e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës. Po ia shtoj unë dhe Ministrisë dhe nëse është kështu që ART-ja është autoritet i pavarur dhe zbaton politikat e Ministrisë dhe të Qeverisë, unë këtu nuk po e shoh, së paku zëvendës kryeministrin, nuk po e shoh ministrin e Transportit dhe të Telekomunikacionit ,që do të duhej të ishte, pjesëtar i këtij debati dhe të na tregonte nga këndi dhe nga kompetencat e veta për veprimet e ART-së.

Por, le t'u mbetet atyre që të merren me kompetencën që e ka ndaj ART-së, dhe raportit që duhet të krijojmë me të. Nuk do të ndalem shumë në raportin financiar, sepse, raportin financiar të ART-së, Komisioni për Buxhet, e ka shqyrtuar në mars të vitit 2005 dhe ka kërkuar plotësimin e tij , që ai raport nuk është plotësuar, ose plotësimi ka ndodhur duke futë ,si tha dikush, materiale të përkthyer, dofarë raportesh -manuale 2006 për konformistët etj. Kur të vijë raporti 2006, këto mund të na i futni zoti kryesus i ART dhe jo tash, se nuk mund të na qitni hi syve. Nuk do të ndalem shumë rreth shpenzimeve të buxhetit që kanë ndodhë, por rreth vërejtjes që i është tërhequr për punën e ART-së nga administrata e ART-së dhe vërejtjet të cilat me shkrim iu kanë drejtuar institucioneve të ndryshme të Kosovës, prej Kuvendit deri te kryetarët e shefave të grupeve parlamentare.

Më vjen keq që nuk qenka këtu zotëri Alush Gashi dhe do të lexoj një letër të administratës së ART-së, dërguar Alush Gashit, është e datës 11.09.2006.

I nderuari zotëri Gashi, si administratë e autoritetit rregullativ të telekomunikacionit shumë institucioneve vendore u jemi drejtuar për mbrojtjen e ligjshmërisë në institucionin tonë. Mirëpo, fatkeqësisht deri më tani nuk kemi marrë përgjigje. Si shef i grupit parlamentar më të madh, jua drejtojmë këtë shkresë që ta bisedoni këtë çështje dhe në kuadër të grupit, por edhe në nivel të partisë suaj, sepse kryesuesi i bordit thotë të thirret se ka 21.000 vota nga Peja, ta shqyrtoni këtë çështje, në mënyrë që të mos dalë në gjykatë atje dhe të merren gazetat me të.

Një tjetër letër e drejtuar nga një anëtar i bordit , Aziz Sefedini, drejtuar Naser Osmanit, më vjen keq, nga kolegu im dhe kryetari i Komisionit për buxhet, sepse këtë letër është dashtë të na e jepte edhe neve, rreth shpenzimeve buxhetore. Kjo daton më 21.06.2006. Buxheti i ART-së është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në datën e caktuar. ART deri më tani ka realizuar të hyra 317.500 €. Trendi i cili tregon se ART, është fjala për 2005, nëse vazhdon me të njëjtin ritëm më tepër do të shpenzojë para publike se sa të sigurojë të hyra për buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Këtu ka sjellë një kontratë të cilën e ka bërë kryesuesi i bordit, për një senior konsulent ,siç e quajnë këtu. Nuk di tash në atë organogramin si e kanë parapa dhe ajo kontratë mbi punën ose mbi veprën, si e quajnë këta, vetëm për pagesën që është bërë brenda një viti, thotë kompensimi mujor i kontraktuesit caktohet në lartësinë 1800€ (edhe me shkronja

është (njëmijetëqind €), atij i vazhdohet kontrata edhe për dy muaj dhe, për ata dy muaj e kam edhe tjetren kontratë këtu, edhe për ata dy muaj i paguhet 4800 €.
Këtu anëtari tjetër i bordit thotë: Nuk ka pas nevojë fare të angazhohet ky, sepse të njëjtën punë e kanë kryer firmat konsulente të mëparshme.

Një tjetër letër drejtuar, nuk është këtu zonja ministre Melihate Tërnkolli, pikërisht rreth këtyre çështjeve dhe së njëjtës çështje që e thashë, është e njëjta letër që i drejtohet edhe këtu ulet ajo zakonisht, zonjës Melihate Tërnkolli dhe nuk ka marrë masa absolutisht rreth këtyre çështjeve. Ankesë tjetër i është drejtuar edhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, me 27.07.2006. për të bërë dhe të pabërë e bordit të ART-së dhe udhëheqësit të këtij bordi të ART-së, ndërsa nuk kanë marrë kurrfarë qëndrimi, vendimi dhe arsyetimi. Nga diskutimet e parafolësve këtu, doli se vërtet ART-ja, paska punuar mirë, E përgëzojmë për punën që ka bërë tani, i japim kurajo shumë të madhe dhe unë vetëm mund ta përmbyll këtë diskutim timin, sepse dëmi që i ka shkaktuar ART-ja Kosovës është shumë më i madh sesa që biseduam në atë raportin e buxhetit të Kuvendit dhe për dëmin që i ka shkaktuar buxhetit ndoshta administrata e zotëriut Nexhat Daci. Në Kuvend, nuk duhet të votohet raporti, por duhet të votohet shkarkimi i anëtarëve të bordit, respektivisht kryesuesit të bordit të ART-së.

KRYETARI – KOLË BERISHA

Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemajli, le të përgatitet deputetja Safete Hadërgjonaj.

DEPUTETI – BAJRUSH XHEMAJLI

I nderuari kryetar, zotëri ministër i Shëndetësisë, jeni prezent, përshëndetje zoti Anton Berisha, kryetar i ART-së edhe pse me një vonesë tepër të madhe keni ardhur këtu. Raporti i ART-së është vetëm njëra anë e medaljes, është ajo medalje të cilën ka pasur dëshirë ta shohë udhëheqësi i ART-së me ata që i ka përreth, mirëpo dihet se ana e errët natyrisht që, është fshehur dhe unë pikërisht do të mundohem ta ndriçoj këtë anë të errët të medaljes, që do të duhej ta shihnin qytetarët dhe gjithkush ashtu siç i kanë pa edhe shumë anëtarë të bordit apo punëtorë të zotëriut Berisha.

U potencua nga parafolësi zoti Koci, që ka shumë dokumente të cilat tregojnë se vërtet ART-ja jo që nuk ka punuar mirë, po ka punuar tepër keq. Është interesant se disa dokumente i janë drejtuar edhe këtij Kuvendi dhe çuditërisht janë fshehur. Unë them janë fshehur se do të ndalem në një dokument nga shumë dokumenta që janë këtu, që tregon shumëçka, po Kryesia e Kuvendit nuk e ka pa të arsyeshme të na i lë në kutinë postare, në mënyrë që t'i kemi në dispozicion, po kam qenë i detyruar që ta marr në një formë tjetër.

Ky dokument i administratës së ART-së, i është dërguar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës më datën 21.08.2006. dhe meqë dëgjon mjaftë dhe fletë vetvetiu do ta lexoj:

Autoriteti rregullator është organ i pavarur, të cilin e ka themeluar Kuvendi i Kosovës, në bazë të ligjit për telekomunikacionin. Pikërisht për këtë arsye, edhe duhet ti raportoj Kuvendit të Kosovës, mirëpo, fatkeqësisht edhe pas gati 3 vite të ekzistimit, një raportim i tillë nuk ka ndodhë. Pse po kërkojmë që të mbrohet ligjshmëria, thonë d.m.th. administrata e ART-së, së pari Kuvendi i Kosovës për vitin 2006. ka aprovuar buxhetin e ART-së në shumën prej 794.980 € së bashku me buxhetin është aprovuar struktura dhe numri i punëtorëve, që do ti ketë ART për vitin 2006.

Së dyti, buxheti, nuk po shfrytëzohet duke u bazuar në planifikimin dhe aprovimin, që ka bërë vetë ART, dhe Kuvendi i Kosovës, por sipas tekeve të kryesuesit të bordit. Bordi i ART-së, ka aprovuar një strukturë hipotetike, të propozuar nga bërës që dallon rrënjësisht, nga ajo të cilin e ka aprovuar Kuvendi i Kosovës. Në bazë të kësaj strukture, hipotetike, të gjithë të punësuarit në ART pa ndonjë vlerësim të punës së kryer paraprake duhet ti nënshtrohen një ristrukturimi. "Kryesuesi i bordit ka bërë përtëritjen dhe mos vazhdimin e kontratave të punës në mënyrë selektive duke u bazuar në këtë strukturë". Bordi i ART-së, në mënyrë të kundërligjshme ja miraton gjithë veprimtarinë e kundërligjshme kryesuesit me vendim nr. 161/06 datë 1.06.2006 të protokolluar më 21.06.2006. të gjithë shërbyesit civil, të cilëve nuk i janë vazhduar kontratat, kanë kërkuar nga bordi i ART-së, sqarim rreth këtyre veprimeve, mirëpo nuk kemi marrë përgjigje ende, ankesat drejtuar bordit 20.07.2006.

Gjithashtu, iu kemi drejtua edhe këshillit të pavarur mbikëqyrës të Kosovës, dhe MTPT-së, Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit edhe nga këto institucione nuk kemi përgjigje. ART vetë lavdërohet në raportin e paraqitur për Kuvendin e Kosovës, ndërsa edhe pas gati 3 vite të veprimtarisë, nuk ka faqe të internetit, të ART-së, është institucion kryesor për licencimin e shërbimeve të telekomunikacionit. Kërkojmë nga ju që si, kryesi e organit më të lartë në kuadër IPVQ-së ta trajtoni seriozisht këtë kërkesë, e të cilës i bashkangjesim dokumentet shtesë, janë 4 dokumente që i përmendin nga administrata e ART-së, që i ka dërguar Kryesisë së Kuvendit. Kjo do të thotë nuk na është ofruar dhe mendoj që është një lloj fshehje e llojit të vet, ART është jo profitabile thuhet edhe me ligj, këtu kanë përfitua shumë njerëz, kanë qenë shumë profitabil në këtë, ata që kanë drejtuar këtë përmendi kolegu im, Gani Koci, zotin e Bivolakut, po nuk e përmendi se zoti Bivolaku ka inkuadruar në punë edhe bashkëshorten, edhe një nip të vetin që është në konflikt i haptë i interesit, që nuk guxon të ndodhë sipas ligjit.

Nga këto që thashë më lartë shihet qartë se, dhe që u tha në të vërtetë edhe të tjerët që nuk dua ti përsëris, në ART ka veprime tejet arbitrare, mungesë të transparencës, shkelje të rënda të ligjit për shërbimin civil, nepotizëm apo familjarizëm deri në konflikt interesi. Se interesat klanore, grupe, a partiake janë tejet të mëdha, tregon edhe tenderimi, apo mënyra e tenderimit të operatorit, të dytë të telefonisë mobile. Me ç'rast u patën vu në veprim gjitha grupet e interesit sikur të ishin duke luftuar për liri, a vdekje.

Pra, nënshkruhet licenca për mobikosin nga ART, menjëherë UNMIK-u e anulon, Qeveria në të vërtetë, apo thënë më mirë vetë ministria nuk e aprovon një gjë të tillë, në kundërshtim me ART-në, me UNMIK-un së bashku e anulojnë, ndërsa, zoti Kosumi, në 5 minutat e fundit të punës tij, sikur kur e le një amanet, se tepër e rëndësishme kjo çështje, e bënë nënshkrimin, thotë jo duhet me qenë jo licencë, ndërsa Kryeministri i ardhshëm po prej të njëjtës parti, punën e parë që e bënë, e ka anulua këtë tender. Do të thotë vërtetë luftë tepër e ashpër, dhe sigurisht nuk bëhen kurrë këto luftëra kështu për liri a vdekje, pa një interes tepër të madh, -tepatë të madh, po them. Kjo luftë me thënë të drejtën kaq e ashpër po të ishte bë në shërbim të pavarësisë së Kosovës, do të ishim më mirë për mos të dhënë se kishte përfundua procesi.

Shkrycja e antenave e këtyre ditëve, për mua është tejet indikative dhe e dyshimtë, pse është indikative, indikative është se kjo paska mundë me u bë më herët, pse u bë pikërisht në prag të këtij debati. Ka mundë nja 5 javë më herët apo 10 javë më herët, a me u bë më vonë, pse nuk u bë nesër, pas nesër, po pikërisht në këtë. Do të thotë është shumë indikative. Po është shumë e dyshimtë në anën tjetër, pse është e dyshimtë, po është e

dyshimtë se gjithë këto lufta të ashpra për fitore të reja, ka mundë me qenë edhe diçka tjetër, edhe mund të jetë, e unë bile besoj ashtu, se kur krijohet një mundësi pikërisht këtyre operatorëve ilegal serb, të konkurrojnë tash, se ilegal po ti legalizojmë, dhe këto nuk legalizohen bash çyshtu qysh po i mendojmë na, koalicioni qeverisës këtu, për këto fjalë miradije kaq të mëdha etj. po vetë edhe kjo tregon shumë mendoj edhe nga ana e deputetëve një disiplinë shumë interesante, edhe disa në heshtje etj. po sidoqoftë dikush duhet të japë llogari për këto dështime që dëmtojnë dhe e kanë dëmtuar dhe nëse vazhdohet me këtë .avaz do ta dëmtojnë tepër rëndë, edhe buxhetin e Kosovës, edhe qytetarin e varfër të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI – KOLË BERISHA

Ju faleminderit! fjalën e ka deputetja Stafete Hadërgjonaj, le të përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETJA - SAVETA HADËRGJONAJ

Faleminderit z. Kryetar, Te nderuar deputet,

Kryetari i Bordit të ART, ka luajtur mire rolin e një të pafajshmi, që punon shumë që nuk është fajtor për asgjë, për të gjitha të këqijat që kanë ardhur si pasoj e mos respektimit të ligjit nga ana e tij dhe e bordit fajtor është UNMIKU, MTTK, Qeveria, Komunitat, kurse ART që ka për obligim sipas ligjit të rregulloj tregun e telekomunikacionit, nuk e ka asnjë faj, as atëherë kur shkelet ligji pikërisht nga ana e bordit të ART, as atëherë kur jepen të dhëna fiktive, as atëherë kur nuk raportohet sipas ligjit, as atëherë kur nuk ka transparencë.

Ne sot kemi para vetes *gjeja* raportin e punës së ART dhe raportin financiar. Po sot kujt do t'ia hedh fajin që nuk i ka ofruar Kuvendit raport ashtu siç e obligon ligji, që raportoj në baza vjetore në Kuvend. Për herë të parë po shqyrtojmë në Kuvend raportin e ART dhe faktikisht nuk kemi raport, kemi përmbledhje dokumentesh të vitit 2005 dhe 2006, ka vendime, materiale të përkthyer, materiale në gjuhën shqipe dhe angleze që kanë të bëjnë me standardet e BE, letra, shifra që nuk paraqesin realitetin.

Ndoshta kryetari i bordit të ART ka menduar se ai dhe bordi që ai menaxhon janë, aq të zgjuar të zotët sa kurrkush nuk mund të provoj shkeljet e tyre, duke vënë në lojë institucionet, por në fakt edhe kryetari edhe bordi bazuar në punën e deritanishme në gjendjen aktuale që kemi në tregun e telekomunikacionit kanë qenë të pa aftë për të kryer funksionet e tyre të përcaktuara me ligj. Puna që ka bërë ky bord me kryetarin e tij është keqpërdorimi, nepotizmi korrupsioni, dukuri këto që po la zënë frymën Kosovës dhe qytetarin të saj.

Kryetari i bordit të ART në të shumtën e rasteve është sjellur sikur shumë çështje që kanë të bëjnë me telekomunikacionin por edhe me të hyrat që realizon ky institucion janë pronë private e tij. Ky Kuvend nuk ka monitoruar si duhet punën e këtij institucioni, ndryshe këtë institucion shumë më herët është dashur ta udhëheqin njerëz tjerë me kualitete tjera gjë që PDK shumë herët e ka kërkuar.

Raporti financiar është shumë i mangët dhe konfuz. Nuk disponojmë me të dhënat e të hyrave të cilat janë realizuar nga ART. Nga të dhënat e BKK të vitit 2005, e dimë që ART i janë ndarë 300,000 euro, në këtë raport shohim se janë alokuar dhe shpenzuar 210,000 euro. Nga të hyrat e realizuar sipas një marrëveshje mirëkuptimi me MFE, ART i janë ndarë edhe 160.000 euro. Nga njëra tabelë shohim se janë shpenzuar 246,500 euro,

sipas një tablele tjetër shohim se Janë shpenzuar 504,892. Kush i ka dhënë të drejtën e shfrytëzimit edhe të 134,892 eurove, meqenëse nuk ka kurrfarë memorandumi të mirëkuptimit për shfrytëzimin e mjeteve? Cilës tabelë të shpenzimeve t'i besojmë.

Nga pasqyrat e shpenzimeve që na janë ofruar shohim se për paga dhe mëditje janë shpenzuar 96,800 euro. Nga materiali shohim se janë paguar 10 punëtor, që rroga mesatare për një punëtor ka qenë mbi 800 euro. Për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 139,600 euro, vetëm për telefon janë shpenzuar 18,453 euro kurse për karburante 11,825, kurse për qira 21,771, pra vetëm për telefon, karburante dhe qira janë shpenzuar 52,000 euro. Kërkoj që sa me shpejtë Kuvendi të ketë raportin e Revizorit Gjeneral nëse është bërë auditimi për vitin 2005, nëse nuk është bërë ndonjë auditim kërkoj që ART t'i bëhet auditimi i jashtëm sepse humbjet që i ka shkaktuar ky autoritet BKK janë shumë të mëdha.

GP i PDK në seancën e mbajtur me datën 15.02.2006 nuk ka miratuar buxhetin e ART, për vitin 2006, sepse buxheti i asnjë institucioni nuk është marrëveshje xhentëlmenësh, askush nuk ka të drejtë të përvetësoj pasurinë publike në dobi të interesave personale. Ne nuk kemi miratuar buxhetin sepse ART nuk ka pasur transparencë ndaj Kuvendit, nuk ka pasur pasqyrën e të hyrave (të cilën as sot nuk e kemi) por as pasqyrën e detalizuar të shpenzimeve, nuk ka raportuar në Kuvend, nuk ka shpjeguar shumë çështje që kanë të bëjnë me operatorin e telefonisë së dytë mobile, për operatorët ilegal dhe frekuencat që ata kanë shfrytëzuar dhe janë duke shfrytëzuar.

Meqë kryetari i Bordit të ART sot është këtu unë do ti bëjë disa pyetje, me shpresën se do të marrë përgjigje.

Autoritetet ndërkombëtare dhe vendore kanë dyshuar për parregullsi, korrupsion dhe keqpërdorim gjatë procedurave të tenderit për fitues të operatorit të dytë të telefonisë celulare. Tenderi është anuluar. Ju keni deklaruar se vendimi për fituesin e tenderit Mobitel - Mobikos ka qenë i drejtë dhe është i pamundur anulimi i tij.

Kush është fajtor për parregullsitë, korrupsionin dhe keqpërdorimin me këtë tender?

Sa i kanë kushtuar buxhetit të Kosovës, manovrimet tuaja dhe të tjerëve për gjëja shqyrtimin dhe rishqyrtimin e këtij tenderi?

Sa janë humbjet në BKK dhe të konsumatorëve?

Operatori ilegal MTS 064 muajt e fundit në mënyrë agresive ka zgjeruar rrjetin e vet në tërë rajonin e Kosovës përmes vendosjes së transmetuesve. Ky operator i paligj shëm operimet e veta i realizon duke shfrytëzuar brezin frekuencave të ndara të valës 900 nga ART, duke qar deri te zvogëlimi i mundësive që vala 900 të ofrojë kualitet të plotë të shërbimit.

Ky operator ilegal ka operuar në më shumë se 28 celula në tërë temtorin e Kosovës duke transmetuar 46 kanale (prej 71 kanaleve të GSM vala 900) të gjitha pjesë të brezit frekuencave të vala 900..

UNMIK-u iu ka kërkuar që të mos ndaloni antenat e Mobitelit në zonat ku jetojnë serbët atëherë:

Pse keni lejuar vendosjen e antenave të reja? Pse nuk i keni shkyqur ato? Apo u dashtë të paralajmërohet debati në Parlament e ju të veproni. Kjo është një hipokrizi e llojit të vet. Kush qëndron pas operatorëve ilegal? Pse nuk mbroni licencën e PTK dhe konsumatorëve të saj?

Shfrytëzuesit e frekuencave a paguajnë për brezin e frekuencave? Nëse po sa janë të hyrat nëse jo pse? ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT – KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputeti Bexhet Brajshori

DEPUTETI – RAMADAN KELMENDI, - Ju falemidnerit! i nderuari zotëri kryetar, të nderuar kolegë deputetë!

Unë nga këndi im raportin mbi punën e ARTK-së e kam shquar në prizmen e prezentuar në rapaort për vitin 2005. natyrisht duke mos pasur shumë të dhëna që dëgjova këtu, që janë shkruar po janë interpretuar në forma të ndryshme. Megjithkëto fakte unë mendoj se është bërë mirë nga bordi konkret që ka paraqitë raport për punën e një periode të caktuar e cila ntyrisht se është përcjellë me vështirësi, pengesa, por edhe me forma të tjera të cilat veç u publikuan. Interesi im ishte që jo të elaborojmë shumë këtë raport, por natyrisht me një kerkesë që edhe agjensionet dhe bordet e tjera të na paraqesin raportet e punës, sepse vetëm në këtë mënyrë do të arrijmë nivelin e përgjegjësisë të të ushtruarit të shtetit brenda Kosovës, për të cilën synojmë dhe angazhohemi të gjithë.

Unë në këtë drejtim, pajtohem me këtë raport pune që të jetë i aprovuar si i tillë, me vërejtjet dhe sygjerimet, por kam dy çështje që do t'i shtroja, ndoshta jo për të marrë përgjigje menjëherë, por jemi shumë të shqetësuar nga shumëçka. Unë pikërisht që vij nga Mitrovica - pjesa Veriore e Kosovës, kush i mbulon shepenzimet e telefonisë fikse për qytetarët serbë që me vite të tëra nuk paguajnë dhe një ndër ata që nuk paguajnë dhe e shfrytëzoj jam edhe unë, sepse gjindem dhe jetoj në atë pjesë.

E dyta, kur do të jetë e mundur që antenat ilegale të rajonit të Mitrovicës të shkyçen, sepse ato pengojnë shumë shfrytëzimin e telefonisë, shumë të nevojshme për këtë pjesë të qytetit. Edhe në këtë aspekt, edhe në aspektin shëndetësor dhe në aspekte të shumta, Veriu i Mitrovicës lihet anash. Pra. kërroj që edhe ky bord të ketë një mbikëqyrje, një mundësi më të madhe për ata qytetarë të komunikimit mbrenda Kosovës dhe komunikim ndërkombëtar. Ju falemiderit!

KRYETARI – KOLË BERISHA – Ju faleminderti!

Fjalën e ka z. Behxhet Brajshori, le të përgatitet Xhevat Bislimi.

DEPUTETI – BEXHET BRAJSHORI- Ju falemidnerit zoti kryetari i Kuvendit, të nderuar kolegë deputetë,

Falënderoj kryetarin Berisha për raportin që ka paraqitë në Kuend për ti dhënë mundësinë deputetëve të Kuvendit, për të debatua për një çështje që unë konsideroj se është shumë e rëndësishme edhe për nga aspekti ekonomik dhe e asaj që ne e themi mbështetje që duhet të bëhet në përgjithësi për zhvillimin ekonomik të vendit.

Raporti mund të shërbejë si një bazë e mirë për diskutime, unë nuk do të ndalem në çështje dhe në numrat që janë pasqyruar në raport, dhe pse raporti është shumë më i begatuar me të dhëna, sesa në rastin e parë.

E kemi një raport. Me të drejtë Komisioni funksional ka kërkuar që raporti të plotësohet, megjithatë, unë do të ndalem në dy çështje kryesore, që mund t'i ndihmojnë në rregullimin e fushës së telekomunikacionit në Kosovë dhe për zhvillimin ekonomik të vendit edhe një herë po e them.

E para ndoshta mund të shtrohet si pyetje, sa autoriteti rregullativ i telekomunikacionit në Kosovë ka arritur ta zbatojë Ligjin në këtë fushë në Kosovë, në rend të parë për eliminimin e operatorit ilegal në Kosovë. Në këtë drejtim mendoj se ka shumë për të bërë dhe vetvetiu nëse kjo zgjat në këtë formë, pa marrë parasysh sa do të jetë numri i operatorëve ilegalë në Kosovë, do t'i dëmtojë proceset ekonomike në përgjithësi edhe buxhetin e Kosovës sigurisht në veçanti.

Dhe çështja e dytë, që unë e kërkoj është shumë e nevojshme të bëhet ndryshimi i Ligjit për telekomunikacionin. Kosova ka nevojë për më shumë operatorë legalë, jo vetëm edhe për një, do të thotë jo vetëm për dy dhe përshpejtimi i procedurave për të ardhur deri te numri më i madh i operatorëve legalë, kjo do të bëjë të mundur shumë aspekte zhvillimin e ekonomisë së tregut edhe në fushën e telekomunikacionit por edhe rritjen e konkurrencës dhe me këtë edhe uljen e çmimit për konsumatorët dhe natyrisht ngritjen e të hyrave buxhetore të cilat janë shumë të nevojshme për vendin. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi, le të përgatitet deputeti Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit z. kryetar, z. kolegë deputetë. Unë nuk do të zgjas shumë edhe për faktin që nga kolegët e mi u sollën mjaftë argumente, mjaft fakte, që provojnë se kjo agjenci ka bërë shkelje dhe shpërdorime enorme edhe të ligjit edhe të buxhetit të Kosovës. Dua ta ngris një shqetësim timin që këtu nga kolegë deputetë dhe nga grupet e caktuara parlamentare po veprohet me dy kute.

Rasti i Dacit, ish -kryetarit të Kuvendit, është i freskët për të gjithë dhe jemi dëshmitarë të gjithë se këtu në këtë Kuvend ra koka e drejtuesit të Kuvendit pikërisht në emër të shkeljeve të ligjit, shpërdorimeve mosrespektimit të procedurave etj. . fakt tashmë i njohur për të gjithë.

Kurse për ART-ën që të gjithë e dinë se shkeljet, mosrespektimi i procedurave, shpërdorimi i buxhetit, nepotizmi, ato të gjitha që u thanë të mos i përsëris janë shumë më rënda, shumë më të mëdha dhe po jepet përkrahje nga grupet e caktuara që ishin shumë të zëshme kundër ish- kryetarit të Kuvendit dhe kundër administratës së tij të mëparshme.

Dua të them që, ky Kuvend nuk duhet asnjë herë që për dikën të jetë nënë për dikën të bëhet njerka. Ky Kuvend dhe secili deputet që është ulur këtu duhet të jetë gjithmonë njerka për korrupsionin për shpërdorimet e buxhetit, për shkeljet e ligjit, të cilat janë evidente pothuajse në të gjitha agjencitë e krijuara nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës. Po ndoshta aty ku janë paratë e mëdha aty ku janë përfitimet e mëdha për figurat e caktuara edhe të partive edhe të Kuvendit edhe të Qeverisë mbyllen sytë, jepet përkrahja dhe bëhen sikur nuk ka ndodhur asgjë.

Unë shpreh mendimin tim, dhe kërkoj që çështja ART t'i kalohet Komisionit Hetimor që është formuar nga ky Kuvend dhe vetë pastaj të merremi me raportet e këtij agjencioni dhe të agjencive tjera.

Kam propozim edhe mendim ky ishte edhe mendim i shefit të Grupit të LDK-ës që çështja e agjencive të rishikohet nga e para dhe të merren praktikat e vendeve më të përparuara për funksionimin e këtyre agjencioneve.

Mbështes dhe kërkoj faktin që t'i kalohet Komisionit Hetimor çështja ART edhe për arsye se këtu ka allishverishe nga zyrtarët e lartë të Qeverisë dhe të partive politike. Prandaj, edhe një herë kërkoj që kjo çështje t'i kalohet Komisionit Hetimor të krijuar nga ky Kuvend. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti, le të përgatitet deputetja Teuta Sahatqija.

DEPUTETI XHAVIT HALITI –Zoti kryetar, më lejoni që t'i them dy fjalë lidhur me mendimin tim rreth asaj sepse po debatohet.

Së pari do të dëshiroja ta përgëzoja kryetarin e Bordit të ART-ës dhe Bordin në tërësi për mbështetjen e siguruar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës për ta ruajtur pozicionin e tij. Kjo s'do mend që për mua zgjon kureshtje dhe normalisht që më bën të dyshoj se vallë si do ta luftojmë ne korrupsionin kur faktikisht po shihet qartë dhe është parë qartë se ky Bord nuk është i denjë për arsye që janë cekur më lart dhe nga disa diskutues këtu, që të qëndrojnë në pozicionin e tij.

Vetë fakti që raporti financiar i vitit 2005 po shqyrtohet në fund të vitit 2006 nënkupton se përveç pozitës që e ka fituar me votimin e Kuvendit të Kosovës këta nuk kanë qenë në gjendje t'u japin llogari atyre që i kanë ngarkuar me detyrë sipas kohës ligjore që e kanë për të dhënë.

Së dyti, mendoj që faktet e dala në publik dhe konfliktet të cilat poqë se i përmendim do të na marrin shumë kohë se janë krijuar gjatë tenderimit të operatorit të dytë dhe këmbëngulja në kundërshtim me vendimet që u morën nga institucionet e UNMIK-ut dhe të zyrave që kanë monitoruar keqpërdorimet në tenderimin e dytë të telefonisë mobile, ishte një këmbëngulje e pashembullt e këtij agjencioni për t'ia dhënë operatorit të dytë Kariqëve të Serbisë. Le të jetë ai emër çfarëdo, le të kamuflohet me cilindo emër, por dihet qartë se ajo ka qenë kompani e Kariqëve. A thua meritojnë këta njerëz të cilët kanë bërë këto shkelje dhe të cilët në kundërshtim me interesat e Kosovës kanë lejuar prapë invazion elektronik të territorit të Kosovës ilegalisht përmes Telekom Serbia, Crna Gora e çka janë këto që i kanë shpërndarë frekuencat e tyre në Kosovë. Për mua është pushtim (invazion) i territorit të Kosovës me anë të elektronikës. Dhe duke u mbështetur në këto që po them konsideroj që ky agjencion nuk është i denjë të udhëheq procesin e operatorit ose të tenderit të ri të shpallur, sepse konflikti i interesave është shumë i madh dhe gabimet politike të bëra në të kaluarën kanë qenë shumë të rënda.

Unë nuk e besoj që Qeveria e Kosovës që Parlamenti i Kosovës me kërkesën e ART-ës dhe Ministria e Brendshme nuk do të ndërmerrnin hapa konkretë për zhvendosjen dhe shuarjen e antenave të cilat vërtet kanë fituar qindra miliona euro mbi territorin e Kosovës dhe të paktën nuk kanë paguar asnjë euro tatim Qeverisë së Kosovës e as buxhetit të Kosovës. Prandaj, mendoj që të theksojmë të gjitha së bashku dhe të konstatojmë të gjitha këto shkelje dhe të vendosim konform interesit të Kosovës dhe

konform interesave të ngushta të grupeve ose të njerëzve të veçantë të cilët janë të interesuar që ta shtyjnë me këtë Bord derisa t'u jepet licenca e dytë e telefonisë mobile. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë.

Desha të sqaroj pak; mendoj që kolegu im nuk është kuptuar si duhet. Kolegu im e përkrahu shkyçjen e antenave si aktivitet të cilën e ka bërë ART-ja dhe ne qëndrojmë pas asaj. Mendojmë që çkyqja është një veprim i mirë i çfarëdo operatori ilegal i çfarëdo biznesi ilegal ,i cili e dëmton buxhetin e Kosovës dhe duhej të trajtohej ashtu si është edhe të çkyqet.

Gjithashtu e përkrah kolegun tim i cili e përkrahu ART-ën që e ka bërë raportin. Mendoj që raporti është i mirëseardhur, ndonëse është i vonuar, sepse tre vjet që ky raport është i vonuar, por presim që ART-ja të mos bie raporte çdo tri vjet, por që duke u bazuar në diskutimet prej këtij Kuvendi që ato raporte të jenë të rregullta në mënyrë që të rritet transparenca. Çdo vonim, çdo mungesë e raportimit sjell deri te mos transparenca, prej mos transparencës rrjedhin edhe shumë gjëra të cilat ky Kuvend i ka luftuar deri më tash.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar çdo herë kemi kërkuar transparencë, çdo herë kemi kërkuar llogaridhënie. Prandaj në qoftë se auditimi është bërë për Kuvendin e Kosovës mendojmë se ai do të duhej të bëhej për cilindo institucion të Kosovës,duke pasur parasysh edhe ART-ën, ministritë dhe të gjitha institucionet të cilat e shpenzojnë buxhetin e Kosovës. Prandaj, ne qëndrojmë pas asaj. Në qoftë se Kuvendi vendos për ndonjë komision pse jo, secili komision që do të arrijë transparencën mendoj që është i mirëseardhur me ngritjen e transparencës ,me ngritjen e llogaridhënies do të kontribuohet në punën më të mirë të Kuvendit.

Të gjithë parafolësit u deklaruan se me kyçjen e operatorëve ilegalë buxheti i Kosovës dhe qytetari i Kosovës kanë pësuar humbje të mëdha, të cilat me siguri maten me miliona apo me dhjeta miliona apo qindra nuk kam guxim ta përmend, por mendoj që një autoritet, një komision do të duhej të jepte një farë vlerësimi sa janë ato humbje.

Përveç humbjeve në para mendoj që këta operatorë ilegalë kanë bërë njëfarë agresioni në pasurinë e Kosovës ,sepse frekuencat janë pasuri e një vendi dhe si të tilla do të duhej të mbroheshin dhe të shfrytëzohen në mënyrë legale dhe assesi ilegale. Mendoj që është një dëm tjetër të cilën ne nuk e kemi cekur deri tash prej përdorimit ilegal të këtyre , sepse me përdorimin ilegalë janë vendosur antenat, infrastruktura e cila me rastin e shpalljes së tenderit të dytë do të jetë një ndihmesë për atë i cili ilegalisht sot e përdor e nesër do të jetë i privilegjuar që edhe në mënyrë legale të vazhdojë aktivitetin e vet dhe t'i qesë të tjerët në pozita jo të barabarta dhe pozita të vështira për ta fituar.

Prandaj, bashkohemi me diskutuesit e mëparshëm që Ligji i telekomunikacionit i cili ka një kohë që ekziston që të gjitha ato nene, të gjitha ato vërejtje të cilat janë parë gjatë punës së këtij Kuvendit të legjislacionit, mendoj që Komisioni do ta ketë për detyrë,

duke pasur parasysh vërejtjet, ta ndryshojë ligjin, në mënyrë që ai të jetë sa më i pranueshëm dhe sa më tepër në dobi të qytetarit.

Përsëri përkrahim çdo iniciativë e cilitdo grup parlamentar që i ngrit transparencën dhe llogaridhënien, ne jemi për. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Z. kryetar, të nderuar deputetë. Unë kërkoj nga ju si kryetar i Kuvendit që në të ardhmen të gjitha shkresat të cilat i vijnë të çfarëdo natyre qofshin Kryesisë së Kuvendit dhe që kanë të bëjnë me institucionet të cilat i emëron Kuvendi, të njoftohen edhe deputetët e këtij Kuvendi zyrtarisht e të mos ndodhin shmangie të shkresave dhe mos njoftim zyrtar i deputetëve për institucionet të cilat vetë deputetët i zgjedhin.

Raporti i ART-ës i sjell me vonesë këtu nuk është asgjë tjetër vetëm një raport ku në mënyrë të shkruar dhe zyrtare u jepet deputetëve se sa është bërë shkelja e ligjit në Kosovë.

Unë mendoj se të gjitha institucionet e dala nga Kuvendi i Kosovës dhe të gjithë njerëzit të cilët emërohen në ato institucione nuk njohin ligj në Kosovë, nuk njohin Buxhet të Konsoliduar të Kosovës dhe para për qytetarët e Kosovës, por e njohin të vetmin vendim me të cilin ata emërohen dhe mendojnë se shndërrohen në pronarë të institucioneve të cilat e udhëheqin e në këtë rast edhe agjencioni, gjegjësisht ART-ja.

Ne sot po diskutojmë këtu dhe po përmenden shifra e miliona euro si të ishin ato miliona.

Ku është interesi i qytetarëve në raport me ato miliona euro apo, kush i fshehu dhe kush përfitoi nga ato miliona euro, derisa qytetarët e Kosovës nuk fituan. Mua më vjen keq që shumica e deputetëve këtu nuk janë ndoshta në gjendje që ta thonë atë çka e ndiejnë në shpirtin e tyre dhe të flasin shumë realisht edhe të kërkojnë përgjegjësi, gjegjësisht shkarkim të këtij agjencioni, për shkak se duhet të ulin konkën dhe të heshtin para interesave të grupeve të caktuara. Mua më vjen keq që ky Kuvend vetëm debaton edhe sot vetëm debaton për një raport si të gjitha raportet e tjera për shkelje dhe kush po përgjigjet për ato shkelje. A thua nuk po i njohim ligjet të cilat vetë po i aprovojmë, a thua zyrtarët në krye të atyre institucioneve nuk po u dashka t'i njohin ato ligje, a kemi pas ndonjëherë si deputetë një raport, ku kryesuesit e atyre institucioneve apo agjencioneve kanë prurë rekomandime të tyre, që në ligjet duhet të bëhen ndryshime apo plotësime apo kanë prurë në ato raporte edhe lëshimet të cilat mund të bëhen në mënyrë të pavetëdijshme. Jo, gjithëherë raportet të shkëlqyeshme, gjithëherë raporti ku gjithçka ka shkua lege-artist, mirëpo e vërteta flet ndryshe, realiteti është ndryshe. Kush duhet të merret me atë realitet, kush duhet të merret me atë të vërtetë, ne deputetët,? Unë mendoj se po. Kërkojmë përgjegjësi prej njerëzve, të bëjmë sikur i ngarkojmë me përgjegjësi, të bëjmë edhe shkarkimi nga përgjegjësia e më pastaj institucionet tjera të vazhdojnë me punën e tyre. Secili për çfarëdo shkelje të ligjit duhet të përgjigjet. Heshtja e deputetëve shumicë këtu dhe përkrahja dikush me plotësime dikush me ndryshime, arsyetimet se po

bëhen keqinterpretime, se mund të ketë edhe vakum ligjor, nuk e arsyeton ART-ën për tre vjet të mos të paraqesë raport para institucionit të cilin e ka zgjedhur.

Unë sa herë që flas kërkoj që ky Kuvend duhet të jetë në nivelin e përgjegjësisë. Përgjegjësia është të mbikëqyrë punën e institucioneve të cilat i udhëheq vetë, të mbikëqyrë çka po ndodh me buxhetin e Kosovës, ku po humbin rastet ku mund të fitojë ky buxhet, ku mund të rritet me vlerë. Ato raste po i humbin njerëzit të cilët ne po i emërojmë. A mund ta japim ndonjëherë ndonjë shembull, si deputet në këtë Kuvend, që dikush për shkak të papërgjegjësisë duhet të shkarkohet nga përgjegjësia. Apo duhet t'ju tregojmë se të gjithë ata të cilët emërohen nga ky Kuvend janë rehat për ta nuk ka ligj, për ta buxheti është privat, bëjnë çka duan, sillen si duan.

Kërkoj të ngritet ndërgjegjja jonë, të zgjohemi nga kjo përgjumësi dhe të kërkojmë të fillojmë me kërkimin e llogarisë për njerëzit të cilët i kemi emëruar. Nuk është me rëndësi a i emëroi apo votoi vetëm shumica e deputetëve për ta apo edhe pakica gjegjësisht pozita apo opozita. Për të gjithë përgjegjësia duhet të jetë në nivel. Nuk flasim ne gjithëherë prej këndit se jemi opozitë dhe duhet të shprehim vërejtje apo pakënaqësi tonat.

Duhet të jepni shembull si shumicë e deputetëve këtu se duhet t'i shkarkoni apo të lypni përgjegjësi ndonjëherë edhe prej njerëzve të cilët vet i zgjidhni, nuk ka gjithmonë keqinterpretime për humbjen e parasë, nuk ka gjithmonë keqinterpretime për shkelje të ligjeve, por ato bëhen me qëllim. Paraja po humb prej buxhetit, paraja nuk po shfrytëzohet me interes të qytetarëve, por paraja po shkon te një grup i caktuar, e atë grup të caktuar duhet ta gjejmë ne vetë. Duhet të japin llogari njerëzit të cilët janë në krye të atyre institucioneve. Secili që e thërrasim ne ose që është i obliguar të japë raport këtu vjen shumë i qetë, nuk e njeh institucionin e Kuvendit, pse, e di se do të debatohet edhe në fund ai prapë vazhdon me avazin e vjetër. A duhet ta dijë dikush që kur e merr një pozitë një herë duhet t'i japë llogari dikujt.

Deri tash praktika po tregon se jo, mirëpo këto praktika duhet të ndërpriten Kuvendi duhet ta marrë rolin e vet çfarë e ka, nxjerrja e ligjeve, mbikëqyrja e zbatimit të tyre dhe kujdes të shtuar për buxhetin e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit Gazmend Muhaxheri e ka fjalën.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Faleminderit z. kryetar. Shkeljet, gabimet dhe parregullsitë në zbatimin e ligjit të Bordit të ART-ës janë evidente. Por unë e kam një pyetje për zotërinjtë që sot janë të zëshëm për shkarkimin e këtij Bordit dhe kryetarit të tij Anton Berishës.

Në Qeverinë e koalicionit të gjerë ju e kishit kryeministrin, ishit në gjendje të merrni masa dhe të shkarkoni ministrin edhe bordin. A ju dash tri vjet me pritë për me ndërmarrë këto masa dhe atë në kohën kur është në zgjedhje dhe është hap tenderi për përzgjedhjen e operatorit dytë. A nuk është edhe ky një lobim juaji për dike tjetër? Unë jam i vetëdijshëm se ky bord është dashtë me u shkarkua në momentin kur e ka përzgjedh operatorin e parë dhe është anulua tenderi, shkeljet kanë qenë evidente dhe ky bord është

dashtë të shkarkohet atëherë, por jo vetëm bordi por edhe ministri ose edhe kryeministri me dhanë dorëheqje. Kjo ka qenë përgjegjësia atëherë me u bë, tash pas tri vjetëve kur koha ka kaluar është shumë joparimore me e kërkuar këtë punë. edhe me u akuzua na se po e përkrahim një bord i cili ka punua në mënyrë të parregullt.

Unë haptas po them se nuk e ka përkrahjen time, mirëpo nuk jam që për hir të interesave politike të kohës tash të kërkohet shkarkimi i bordit. Aty janë dy palë, do me thanë edhe ju keni interes edhe këta që e mbrojnë kanë interes. Mirëpo është koha tri vjet kanë kaluar zotërinjë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bajram Rexhepi.

DEPUTETI BAJRAM REXHEPI – I nderuari kryetar i Kuvendit. Unë nuk e kisha ndërmend me diskutua se shumë gjëra u thanë edhe nga ish- ministri edhe nga një numër i madh i deputetëve dhe s'dua me këtë t'i krijoj vetes një alibi. Pas fjalëve të zotit Gazmend Muhaxheri, mendoj se me kohën në të cilën kemi vepruar dhe vendimi që është marrë për suspendim deri në hulumtim të procedurave për operatorin e dytë të telefonisë mobile kemi vepruar konform mandatit dhe fuqisë që kemi pasë.

Arsye pse kemi kërkuar që edhe PSSP-ja të jetë e involvuar na kemi qenë shumë real në fuqinë ekzekutive që ka pasur Qeveria dhe që ajo të zbatohet dhe në tenderin e parë më të madh të votohet një rregullshmëri. Mendoj se kemi vepruar në mënyrë të drejtë, ndërsa pse Qeveria nuk e ka shkarkuar ART-ën, Qeveria nuk mund ta shkarkojë për arsye se ajo është votuar në Parlament, por atë ka mund ta bëjë Parlamenti. Ndërsa sa për Ministrinë unë mendoj se nuk ka pasur arsye ose vend në atë kohë që të iniciohet. Nëse shkojmë me moralizim aty ndoshta ka pasur vend që edhe kryeministri të japë dorëheqje në atë moment. Nuk kemi menduar se ka vend për një gjë të tillë dhe mendoj që të jemi parimor. Unë jam shumë i vetëdijshëm se ky raport është shumë i vonuar dhe është stërgjatë dhe ka pasë pasoja, por ky është dashtë shumë herët të anulohet të shpallet tenderi i dytë dhe të kemi një transparencë më të madhe në tenderim.

Unë absolutisht nuk mendoj se ne si grup ose diçka kemi ndonjë interes që të zhagitet, përkundrazi, ato që kanë qenë defekt të ART-ës nuk mund të mbyllen sytë edhe pse ky debat është i vonuar. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Gani Koci e ka fjalën.

DEPUTETI GANI KOCI – Faleminderit z. kryetar.

Desha vetëm të sqaroj përfaqësuesin e ORËS. Ky raport është ofruar për diskutim në mars të këtij viti. Komisioni për Buxhet ka dhënë rekomandimet e veta dhe i ka refuzuar si të tillë me arsyetimin se duhet të plotësohet dhe kush kanë qenë ata se ndoshta atëherë do të ishte ngritur çështja e shkarkimit të këtij bordi e jo sot. Kush kanë qenë ata që kanë prolonguar këtë diskutim deri sot? A mund t'i kërkonti dhe mund t'i hulumtoni se jeni edhe anëtar i Kryesisë dhe e dini shumë mirë.

Ne kemi kërkuar që në mars, eventualisht në prill, të diskutohet ky raport dhe atëherë do t'i dëgjoni të gjitha këto që i thamë sot. Ata që kanë prolonguar kanë pas interesa që të

mos ngritet kjo çështje. E dini se edhe këtu edhe grupi më i madh parlamentar ishte në rend dite raporti, por u hoq nga rendi i ditës ,gjoja të plotësohet raporti. Plotësimi i raportit është kërkuar në muajin mars. Se kush ka interes dhe cilat janë ato interesa vërtet do ta shohim nesër. Interesi ynë është sot që ne të ngrisim institucione të pastra të pakorruptuara që implementojnë ligjin dhe që e respektojnë ligjin. Nëse vazhdojmë të mbrojmë atëherë do të na ndodhë-e dini edhe për këtë Kuvend kemi kërkuar komision në marsin e vitit 2004, por u dash 2006 që të bëhet ai. Mos ta presim 2008 për të njëjtin komision, por të veprojmë sot.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Z. Muhaxheri nuk e pat një fjalë, por e pat një reagim që më shtyri të reagoj. Më duhet ta quaj një reagim i mirë. Çështja që ne këtu po debatojmë është raporti i vitit 2005. Ne kemi ngritur zërin disa herë për çështje të tjera dhe nuk është hera e parë që po e ngritim, siç po e bëj që tani edhe ne maskim interes, vetë mënyra e reagimit të tij por edhe e partisë së tij tregon interes madje interes tepër të madh. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Deputeti Jakup Krasniqi e ka fjalën.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Zotëri kryetar, të nderuar deputetë. Dola para jush për të thënë që Partia Demokratike e Kosovës nuk ka problem me emra të përveçëmKëtë e kemi thënë edhe kohë më parë, kur ka qenë fjala për të debatuar për raportin për çështjet e Kuvendit dhe vërtet dikush paska pasur interesa personale, por jo interesa për t'i mbrojtur çështjet. As sot ne me bordin e ART-së nuk kemi probleme personale as me shefin e këtij bordi. Ne kemi problem dhe shqetësohemi me familjarizimin që po ndodh në Kosovë në përgjithësi e në Parlamentin tonë në veçanti me të keqen, do të thotë po familjarizohem se dikush paska të drejtë të jetë në pozita udhëheqëse dhe të keqpërdorë gjithçka. Pra, të mos e respektojë ligjin, ta shkelë atë dhe ta përdorë buxhetin e njësisë së vet sikur të ishte ai buxhet privat dhe jo Buxhet i Konsoliduar i Kosovës.

Nëse dikush në këtë sallë sot nuk është bindur se drejtuesja dhe bordi i ART-ës e kanë keqpërdorur buxhetin, e kanë dëmtuar atë për miliona euro. Mendoj që nuk e kanë mirë dhe po dëshirojmë si Parlament t'i hapim rrugët keqpërdorimeve dhe avizionit fiskal që bëhet për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Ju lutem ,nëse dikush për katër pesë vite ka lejuar në Kosovë të operojnë operatorë ilegalë që asnjë mjet nuk e derdhin në buxhetin e Kosovës, por e varfërojnë xhepin e qytetarit të Kosovës, kush ka pasur interes me krejt në këtë marifet? Ne do të duhet të konstatojmë se dikush nga lejimi i operatorëve ilegalë në Kosovë ka përfituar. Ne do të duhej ,si Parlament ,të konstatojmë, a ka përfituar administrata e UNMIK-ut që ka qenë tepër lojale ndaj këtyre operimeve, apo së bashku me administratën e UNMIK-ut ka edhe forca politike apo individë të fuqishëm në Kosovë që i kanë pasur përfitimet e veta, një gjë e di që dikush ka përfituar dhe atë përfitim diqysh po e legjitimojmë edhe ne sot në Parlament.

Partia Demokratike nuk ka problem personal as me kryetarin e Parlamentit, as me anëtarë të kabinetit qeverisës, as me Bordin e ART-ës nuk ka problem për

keqpërdorimet që kanë ndodhur po ndodhin dhe po tolerohen. Kjo ishte arsyeja që dola ta sqaroj, do të thotë nuk kemi probleme personale, kemi probleme parimore, probleme për çka jemi të thirrur që t'i mbrojmë, t'i evidencojmë dhe t'i ndëshkojmë ata që kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Hatixhe Hoxha e ka fjalën.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Z. kryetar, të nderuar deputetë. Më lejoni të jap vetëm një sqarim.

Pas raportit të Kompanisë Helm që ka dhënë në gusht 2004, si anëtare e Komisionit, atëherë përpos telekomunikacion kam shprehur në Kuvend, më lejoni ta citoj, kam kërkuar: Kërkojmë nga Kuvendi që në procedurë urgjente të fus në rend të ditës këtë çështje dhe kërkoj nga Qeveria që të autorizojë ministrin përkatës, gjegjësisht ministrin e Transportit, Post Telekomunikacionit të raportojë para Kuvendit në lidhje me ART-ën gjegjësisht për çështjet që lidhen për operatorin e dytë të telefonisë mobile. Pas dëgjimit të raportit të hapet debat në Kuvend. Kjo është bërë më 8 shtator 2004, por nuk është hap debat.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Pasi nuk ka diskutues të tjerë Kuvendi duhet të deklarohet për raportin me rekomandimet e Komisionit funksional. Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Z kryetar. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike që në fillim në paraqitjen e parë ka kërkuar që ky Kuvend të votojë për shkarkimin e Bordit të ART-së dhe si propozim ky duhet të futet i pari dhe pastaj të vendoset për Raportin e ART-ës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Në rendin e ditës është shqyrtimi i raportit të Bordit. Urdhëroni z. Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Pikërisht debati rreth raportit ka nxjerrë edhe këtë propozim, prandaj si i tillë ky duhet të dalë në votim në këtë Kuvend.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Fjalën e ka profesor Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Këtë që do të thosha unë do të duhej ta thoshin kryetari i Kuvendit dhe njerëzit që i ka pranë aty, por duhet të sqarohen sendet.

Këtu kemi një raport që diskutohet dhe ka vlerësime që i kam. Nuk dua t'i karakterizoj kurrfarë vlerësimesh se është punë e deputetëve, e ndërgjegjes dhe e dijeve të tyre. Por një gjë duhet të dihet edhe deputetët e pozitës edhe opozitës edhe kush do qoftë duhet ta dijë që ekziston një rregull i emërimit dhe i shkarkimit dhe le ta kapin, le ta lexojnë ligjin, qysh emërohen dhe qysh shkarkohen këta njerëz.

Është neni 7, dihet saktë kur thuhet që rekomandon ministri, propozon Qeveria, vendos Kuvendi. Atëherë amendamenti ligjin dhe ndërroni ju lutem shumë, kështu që sot për sot është pika e rendit të ditës. Unë thashë nuk jap shpjegime as nuk jap nota për vlerësime. Unë po them që ekzistojnë procedurat dhe procedurat për çdo gjë duhet të ndiqen. Nëse duam të kemi demokraci, nëse dom të kemi voluntarizëm në bazë të momenteve, interesave, motivimeve etj. unë nuk dua t'i arsyetoj.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Ju lutem. Në rendin e ditës e kemi Shqyrtimin e raportit për punën e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2005. Urdhëro Bajrush.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Faleminderit. z. kryetar, as unë as z. Hamiti nuk jemi juristë, por mendoj duhet t'i dimë bile do rregulla elementare. Mendoj që z. Hamiti ka ra në rregullën e parë elementare ai që të ngarkon me diçka, që të zgjedh edhe të shkarkon, do me thanë ka të drejtë ai që të ngarkon dhe të shkarkon. Ai që të zgjedh edhe ka drejtë me të shkarkua. Kuvendi e kan ngarkuar Kuvendi e shkarkon edhe kjo është rregull shumë elementare. Mendoj s' do koment, ka jurist plotë të mos na lanë bash kështu, por kjo është elementare Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Prof. Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Po më replikën një njeri që e respektoj shumë për punën që ka bërë në Parlament vërtet jo vetëm në këtë legjislacion, por edhe në tjetrin, por ky tash po ngutet pak. Unë nuk thashë që s'ka të drejtë Kuvendi, keq më ke dëgjuar. Më vjen keq, nuk jam jurist ta merr mendja, por di me i lexua gërmat shumë mirë. Ekziston procedura zotëri, po çdo agjenci rregullative që e zgjedh dhe e shkarkon Kuvendi, por edhe Kuvendi ndjek procedura, ligji i cakton procedurat. Unë fola për procedurat zotëri, le të qohen, le të interpretojnë nëse dinë dhe munden ndryshe juristët e famshëm që janë këtu. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryetar. Unë gjithashtu do të thirrem në atë çka përmban Ligji për telekomunikacionin neni 7 i referoj pikës 6 çdo shkarkim nga detyra në pajtim me nenin 7 pika 5 do të jetë objekti i shqyrtimit nga Kuvendi, pika 5 thotë: Me dy të tretat e votave të anëtarëve bordet do të largojë një anëtar në bazë të jo kompetencës profesionale apo sjelljeve të këqija. Baza specifike për largimin apo dorëheqjen e detyrueshme të një anëtari do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në kriteret vijuese: vdekja a), b) paaftësia psikike ose fizike, c) diskualifikimi sipas dispozitave të këtij ligji, d) falimentimi apo paaftësia paguese, e) mungesat e paarsyetuara në tri mbledhje zyrtare apo të zakonshme e njëpasnjëshme të ART-së, f) dënim për kundërvajtje apo vepër penale, g) interes personal bashkëshortor apo interes të drejtpërdrejt familjar në ndonjë licence të lëshuar sipas ligjit dhe h) përfitime financiare nga çfarë pajisje telekomunikacionit apo cilido furnizues apo ofrues i shërbimeve.

Prandaj atë çka po kërkojmë është me të vërtetë vetëm zbatimin e ligjit ashtu siç është e definuar në nenin 7. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Xhavit Haliti e ka fjalën.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Unë mbeta pa u sqaruar përmes ligjit, a kemi të drejt me shqyrtua raportin me ligj, tani si parlament?. Nuk e di a kemi të drejtë me shqyrtua raportin dhe me vendosë për raportin, Unë mendoj që Parlamenti si i tillë e ka zgjedh dhe ka të drejtë t'i shkarkojë edhe ministrin edhe kryeministrin edhe Qeverinë krejt, bashkë tanë për një herë. Është një kërkesë konkrete e një grupi parlamentar dhe është e drejtë e tyre me kërkua diçka sipas Rregullores të Kuvendit të Kosovës, nuk ka shkelje të ligjit këtu nga grupi parlamentar ,në qoftë se ka shkelje të ligjit le të japin llogari. Është e drejtë e kryetarit të Parlamentit që tha ta qesë në votim raportin ,por është e domosdoshme ta qetë në votim edhe propozimin e grupit parlamentar ,sepse nuk është vetëm një deputetë këtu , e ka me rregullore.

Prandaj nuk është mirë të merremi se çka thotë ligji, sepse në ligj nuk e pashë që kemi të drejtë. Po më duket se po bëjmë shkelje ligjore edhe na që po votojmë, se nuk është me ligj me votua raportin e ART-ës. Na jemi organ ligjvënës, e kemi ngarkuar këtë farë bordi, ka vërejtje të mëdha, ka propozime. Nesër mund me pasë propozime me shkarkua kryeministrin dhe prapë duhet me u mbështetë në ligj. Ky është organ në qoftë se e ka zgjedhë ka të drejtë me shkarkua, nuk e shoh të mundshme që të niset procedura e shkarkimit çfarë u lexua këtu dhe unë nuk po dua me hy në detaje se më vjen keq me hy në detaje, më vjen keq me e ofendu këndo këtu të cilët mund të jenë dhe janë të implikuar në interesa të caktime. Nuk po dua me përmend emra të askujt as të ART-ës, ku dhe kur ka qenë në Slloveni, kur dhe ku është takua dhe kur dhe çfarë shërbimesh i ka bërë në Slloveni agjencionit i cili e ka fituar herën e parë tenderin. Prandaj, unë po e shoh që është interes i shumicës me mbajt ART-ës i se e di që votojnë. Votoj pro dhe le ta mbajnë është krejt normale, por nuk është normale me e arsyetua përmes ligjit në Kuvendin e Kosovës se s'paskemi të drejtë me kërkua shkarkimin, nuk është e vërtet se kemi të drejtë me kërkua shkarkimin.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Deputeti Alush Gashi e ka fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Ne kemi mirëpritur radhitjen për raport dhe debat të agjencisë apo të Autoritetit Rregullativ që ... të jetë i pavarur dhe për punën të cilit i nevojitet një mbështetje e fuqishme institucionale me kohë kur pjesa më e madhe e asaj mbështetjeje që i nevojitet, ka qenë dhe ende është në kompetencat e rezervuara.

Ne si Grup Parlamentar dhe si deputetë angazhohemi që këto institucione të reja që ndërtohen në Kosovë , njëkohësisht duhet të jenë të pavarura, transparente, por edhe të kenë mbështetje institucionale që të jenë sa më të suksesshme. Si grup me asnjë formë nuk angazhohemi për mbështetje të shkeljes së rregullave dhe të ligjit. Angazhohemi që si për këtë raport si për këtë agjenci që komisionet funksionale të Kuvendit të Kosovës t'i flojnë edhe agjencitë e tjera dhe të përgatisin raport.

Lidhur me raportin e sotëm ne kemi marrë një material si Grup Parlamentar e kemi pranuar i pranojmë mundësitë se për çështje të cilat janë ngritur këtu në pamundësi të verifikimit të tyre që të lihet hapësirë që përmes rrugëve institucionale të vërtetohen apo

të hidhen. Natyrisht ky është Kuvend dhe nuk na befason as moralizimi i tjerëve e as akuzat, por pasi që është një fillim i raportimit të agjencive, ju kisha lutur z. kryetar që raportin të cilin e kemi në rend të ditës, nëse ka përfunduar debati ,ta hedhin në pranim apo refuzim nga ana e këtij Kuvendi. Lidhur me propozimet e tjera unë shpresoj që ju do të veproni sipas Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Naim Maloku e ka fjalën.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Z. kryetar unë sa u tërhoqa nga fjala që tha z. Alush Gashi ,por të them se Komisioni Parlamentar i cili ka punuar që nga marsi me raportimin e ART-ës na i ka ofruar Kuvendit të Kosovës rekomandimet. Grupet parlamentare dhe deputetët kanë propozuar dhe rekomandime shtesë. Unë citoj edhe një herë, më lejoni të them se Grupi Parlamentar i AAK-ës kërkon që në një afat sa më të shkurtër të kompletohet Bordi i ART-ës dhe të presim propozimin nga Ministria dhe Qeveria për anëtarin e pestë dhe lus që të procedohet sipas Rregullores së punës. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Pikërisht sipas Rregullores së punës duhet ta vë në votim shqyrtimin e raportit. Urdhëroni z. Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Nuk dua ta përsëris atë çka u tha këtu se ai që të zgjedh ai të shkarkon. Kjo është një rregull dhe parim. Në nenin 7 të cilin e citoi profesori dhe të cilit iu bashkëngjit pastaj pika 5 e zonjës atje që është ulur, pika 5 nuk ka lidhje me shkarkimin e bordit, pika 5 e nenit 7 ka të bëjë me shkarkimin e një anëtari të bordit që e shkarkon vetë bordi merr vendim, por ai vendim i nënshtrohet pastaj edhe vendimit të Kuvendit.

Prandaj, kërkesa që ka dalë për votim për shkarkim të bordit ose për votëbesim të bordit ka dalë si kërkesë e vet debatit dhe e raportit këtu dhe nuk është në kundërshtim me ligjin absolutisht. Ky Kuvend e ka autoritetin të ngarkojë dhe të shkarkoj edhe Qeverinë edhe ministrat edhe të gjithë ata të cilët i zgjedh. Prandaj, propozimi i grupit tonë parlamentar duhet të dalë këtu si propozim i tillë , pastaj ata që duhet ta miratojnë raportin le të miratojnë dhe si propozim të tillë dua të votohet dhe nuk është në kundërshtim as me Rregulloren e punës së Kuvendit, as me Kornizën Kushtetuese dhe as me ligjin nenin 7 pa rregullën 5. Zonjë, lexoje mirë për kë ka të bëjë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar. Ne kemi bërë një kërkesë dhe një mocion për shkarkimin e Bordit të ART-ës. Nëse shumica do me e mbrojt, le të mbrojë, por unë mendoj që propozimi ynë së pari duhet të qitet në votim e pastaj le të votojnë kundër, ne nuk dëshirojmë t'i imponojmë askujt asgjë. Pas këtij votimi të parë vjen votimi, le të votohet pastaj edhe raporti, ne do të marrim pjesë në votim, por nuk dëshirojmë as t'ia imponojmë dikujt votimin ,as të na imponojë dikush ne. Prandaj, mendoj që edhe me Rregullore e keni që mocioni ynë është thënë në fillim të seancës dhe duhet të dalë përpara e pastaj të votohet raporti.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Në rend dite nuk është shkarkimi, por shqyrtimi i raportit dhe në sërë votojmë për Raportin respektivisht rekomandimet e komisionit përkatës dhe pastaj mund të votohet për propozimin e mëvonshëm, nëse nuk kalon ky propozim .

Kush është për?: E vë në votim raportin me rekomandimet e Komisionit funksional me vërejtjet eventuale.

Votojmë tash:

Në sallë momentalisht janë 81 deputetë.

Për	46;
Kundër	15.

Kalon raporti.

E hedh në votim mocionin për shkarkim të ...
Kjo është kërkesa që keni kërkuar dhe urdhëroni votoni nëse.....

Votojmë tash, për mocionin që keni kërkuar.
Edhe për atë ka vend ,nuk është problem.

Për	21;
Kundër...	24.

Nuk kalon mocioni.

Paузë për drekë deri në orën 14,00.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Kolegë deputetë, meqenëse në sallë kemi 61 deputetë do të thotë se janë plotësuar kushtet që të mund të vazhdojmë më tutje.

Vazhdojmë me pikën e 9 të rendit të ditës

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion e Kornizë Kushtetues lidhur me listën e kandidatëve të propozuar për pozitën e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij

Komisioni Legjislativ e ka përfunduar procesin e emërimit të avokatit të popullit dhe të zëvendësit kryesor, konform me dispozitat e Rregullores nr. 2006/6 mbi institucionin e avokatit të popullit, të rregullave procedurale të Kuvendit të Kosovës, për emërimin e avokatit të popullit, zëvendësit kryesor dhe zëvendësve të avokatit të popullit.

Raporti i Komisionit së bashku me dokumentacion mbështet dhe u është shpërndarë deputetëve sipas Rregullores së Kuvendit. Ftoj zëvendës-kryetarin e Komisionit, por meqenëse nuk është këtu z. Sadudin Berisha për të arsyetuar rekomandimet për emërimin e Avokatit të Popullit për zëvendësin kryesor të tij.
Urdhëroni z. Sadudin.

DEPUTETI SADUDIN BERISHA – I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar ministra të kabinetit qeveritar.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, me 8 maj të vitit 2006 i ka propozuar Kryesisë së Kuvendit që të iniciohet procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit. Ky veprim i Komisionit është ndërmarrë duke u bazuar në transferimin e kompetencave të Avokatit të Popullit nga institucionet ndërkombëtare në institucionet vendore në pajtim me Rregulloren 2006/6 për institucionet e Avokatit të Popullit. Komisioni Legjislativ me autorizim të Kryesisë së Kuvendit i ka hartuar rregullat e procedurës së zgjedhjes së avokatit të popullit, të zëvendësit kryesor dhe të zëvendësve të tjerë, të cilët janë miratuar në seancën plenare të 15 qershorit 2006. Komisioni më 21 qershor të vitit 2006 ia ka propozuar Kryesisë tekstin e konkursit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe Kryesia e ka bërë shpalljen e konkursit.

Konkursi ka qenë i hapur 40 ditë ku janë ftuar institucionet dhe organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Kosovë, të propozojnë kandidatët për pozitën e Avokatit të Popullit dhe zëvendësit kryesor të tij si dhe kandidaturat individuale.

Komisioni në pajtim me rregullën 3 të rregullave të procedurës së Kuvendit të Kosovës për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor dhe të zëvendësve të tjerë numër 02-2290 data 15 qershor 2006 me 11 shtator të vitit 2006 formoi panelin për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësin kryesor në këtë përbërje.

1. Zonja Nekibe Kelmendi kryesuese e panelit,
2. zonja Nergjivane Dauti, anëtare,
3. Zonja Gjylnaze Syla, anëtare,
4. Zotëriu Nazim Jashari, anëtar,
5. Dragisha Krstoviq anëtar,
6. Hysnija Beshkoviq, anëtar dhe
7. Numan Baliq anëtar

Përbërje me përfaqësim të të gjitha grupeve parlamentare pjesëmarrëse në Komisionin për Legjislacion.

Paneli në pajtim me rregullat e procedurës së Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, të zëvendësit kryesor dhe zëvendësve të tjerë ka bërë intervestimin dhe vlerësimin e kandidatëve për të dyja pozitën dhe i ka propozuar Komisionit tre kandidatë për pozitën e Avokatit të Popullit dhe tre për zëvendës kryesor. Komisioni në pajtim me rregullën 9 të rregullave të procedurës të Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, zëvendësit kryesor dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit me 25 qershor 2006 shqyrtoi raportin e panelit rekrutues për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësit kryesor.

Në mbledhjen e Komisionit anëtarët e panelit rekrutues e arsyetuan listën kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit dhe zëvendësit kryesorë.

Komisioni njëzëri e përkrahu listën e kandidatëve të propozuar nga paneli rekrutues dhe i propozon Kryesisë së Kuvendit për procedim të mëtejshëm në seancën plenare me këtë rekomandim.

1. Për pozitën e Avokatit të Popullit i rekomandohet, Kuvendit të Kosovës këta kandidatë.
1. Hilmi Jashari
2. Ibrahim Makolli dhe
3. Dijana Toska.

Për pozitën e zëvendësit kryesor të Avokatit të Popullit i rekomandohet Kuvendit të Kosovës këto kandidatura, nën

1. Palë Bala
2. Habit Hajredini dhe
3. Todoroviq Lubinka

Radhitja e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit dhe për pozitën e zëvendësit kryesor të Avokatit të Popullit është bërë sipas alfabetit të mbiemrit, në pajtim me rregullën 9.7 të rregullave të procedurës.

Kuvendi voton me votim të fshehtë, në pajtim me nenin 6.2 të Rregullores nr. 2006/6 të Avokatit të Popullit pas votimit të fshehtë i zgjedhur për Avokat të Popullit dhe zëvendës kryesor të Avokatit të Popullit konsiderohet kandidati i cili me numrin e votave të shumicës së deputetëve të Kuvendit.

Në rast se në rrethin e parë të votimit asnjëri prej kandidatëve nuk e fiton shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, procedura e votimit përsëritet me dy kandidatë që kanë marrë numrin më të madh të votave, kurse kandidati i tretë më me pak vota nuk përfshihet në këtë votim.

Në rast se edhe në rrethin e dytë asnjëri prej kandidatëve nuk e merr shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, përmbillet procedura e votimit dhe Kryesia e Kuvendit në pajtim me rregullat procedurale në fuqi e përsërit konkursin.

Të nderuar deputetë,

Para jush janë tre kandidatë për pozitën e Avokatit të Popullit dhe tre për pozitën e zëvendësit kryesor të tij. Vota e juaj do të vendosë se cili prej kandidatëve do të jetë i zgjedhur për avokat të popullit dhe cili për zëvendës kryesor. Ju dëshiroj votim të mbarë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit .Fjalën e ka kërkuar Zlatica Kujunxhiq

DEPUTETJA ZLATIC A K U J U N X H I Q- Poštovani predsedniče, članovi predsedništva, poštovani ministri poštovani kolege. Kao srpska demokratska stranka koja učestvuje u radu Parlamenta podržavamo glasanje za narodnog avokata ali molimo parlament da predsednika parlamenta da za zamenika parlamenta da nam omogući konsultaciju. Znači za glavnog predsednika narodnog advokata i da se samo ovaj deo znači glasanje za glavnog zamenika narodnog advokata odloži za narednu sednicu a da danas izglasamo kandidata za narodnog advokata.

Zahvaljujemo ukoliko usvojite ovu našu molbu.

Znaçi da danas izglasamo narodnog advokata, a za zamenika odložimo za sledeću sednicu da bi izvršili konsultovanje. Hvala vam

KRYETARI I KUVENIDT KOLË BERISHA – Do ta jepni sqarimin pse duhet bërë kjo.

DEPUTETJA ZLATICA KUJUNXHIQ – Za glasniye za zamenika samo radi konsultacije znaçi,

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Z. Berisha, nënkryetar i Komisionit. Keni koment rreth kësaj.

DEPUTETI SADUDIN BERISHA – Numri për procedurën në Kuvend është i mjaftueshëm, por konsideroj se s'kerni të bëjmë me një zgjedhje që do të duhej të kemi për pëlqimin së paku prezencën e shumicës dërmuese të deputetëve. Kujtoj që kërkesa për të shtyrë këtë pikë të rendit të ditës për seancën e radhës apo të hënën do të ishte e pranueshme dhe në interesin e gjithëve që pjesa tjetër e opozitës të jetë prezentë me rastin e deklarimit për zëvendësin është fjala.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, deputetja Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Zoti kryetar. Ne mendojmë që jo vetëm për zëvendësin e Obudspersonit, por mendojmë që edhe Obuds- personi, i cili është një institucion shumë i rëndësishëm për Kosovën do të duhej që të jetë e pranishme edhe opozita, duke e pas parasysh që një numër i madh që nuk është këtu nuk mendoj që zgjedhja do të jetë adekuate dhe do ta tregojë mendimin e të gjithëve. Mendojmë që kjo pikë do të duhej të shtyhej, të gjitha pikat do të duhej të shtyhen, për derisa në Kuvend të jetë edhe opozita.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Lumnije Hyseni

DEPUTETJA LUMNIJE HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar, kolegë të nderuar. Rregullorja nuk e parasheh që të vendoset ndaras për Avokatin e Popullit dhe për zëvendësin kryesor të tij, mirëpo edhe Rregullorja thotë që vendimi fiton nominimin ai kandidat i cili vetë merr votat më shumë nga deputetët nga shumica, e deputetëve, kushtet janë për me u procedua dhe për me vazhdua votimin. Kërkesa edhe pse mundet me pasë ndokush vullnetin që ta përkrahë atë kërkesë me rregullore nuk është e rregulluar, të bëhet një anshëm vendosja, ose unë e shoh të arsyeshme ose të vendosim për të dyja pozicionet, ose të marrim një vendim të caktuar tashmë apo të vazhdojmë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, do të marrim një vendim të caktuar. Mahir Jagcilar.

DEPUTETI MAHIR JAGCILAR – Ju faleminderit z. kryetar, unë mendoj se sot duhet ta shtyjme votimin ,sepse nuk kemi mundësi të zgjedhim, 61 deputetë jemi edhe nuk ka shanse as në rundin e parë as në rundin e tretë të kalojë me 61 votë. Të jemi të gjithë se bashku , kështu që duhet të shtohet teknikisht. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Profesor Ymer Muhaxheri.

DEPUTETI YMER MUHAXHERI – Kuvend i nderuar ,zoti kryetar, politikisht po ma merr mendja se është tejet e arsyeshme me aprovue mendimin e deputetes në fjalë, të përkatësisë serbe dhe atë duhet me e përkrah, gjithsesi duhet me marrë në konsiderim se prej rrethit të minoriteteve si zëvendëse dhe ne mundemi me votuar vetëm për atë , pavarësisht prej asaj se Rregullorja e parasheh, duhet politikisht ky organ në vend parë është politik, tani legjislativ. Kaq.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Deputetja Gjylnaze Syla

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA- Ju faleminderit z. kryetar, unë në emër të grupit mendoj se duhet ta shtyjme për një seancë të ardhshme zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Atëherë do të deklarohe mi me votim.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Unë tash flas në emër të Grupit. Ne jemi për ta shtyrë më të parët në botë, gjithçka me shty, domethënë, jemi kampion të shtyrjeve. Mendoj që nuk prish punë me shtyrë edhe këtë çështje, krejt është normale për ne. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni zoti Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Ju faleminderit zoti kryetar, edhe pse nuk e kërkova fjalën,kjo është bukuria kur e kemi shumicën në Kuvend. Ne besojmë si grup që i bashkëngjitem kërkesës për konsultime dhe e mbështesim edhe qëndrimin e Aleancës dhe të grupeve të tjera. Jemi të përgatitur me votue sot ,por nëse të tjerët nuk janë, për ne është e pranueshme kjo të vendoset në një prej seancave të ardhshme.

KRYETARI I KUVENDIT. KOLË BERISHA – Urdhëro profesor

DEPUTETI SABRI HAMITI – Nuk kam çka të them, pos me e vazhduar seancën po mendoj. Kjo po shihet nëse doni me votuar po votojmë, për heqje, s’ka arsye të bisedojmë për të.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Pati propozime për të hequr vetëm një pjesë të kësaj pike rreth zgjedhjes, ose krejt pikën e rendit të ditës. E hodhi në votim shtyrjen e pikës së 9 të rendit të ditës për një mbledhje tjetër.

Kush është për.....59

Kundër..... 2

Konstatohet se me shumicë votash shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për seancën e radhës.

Pika 10-të e rendit të ditës.

10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për shëndetësi

Në pajtim me rregullën 53.3 d, të Rregullores së punës, në funksion të ushtrimit të kontrollit parlamentar mbi ekzekutivin në implementimin e ligjit, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, i paraqet raport Kuvendit për monitorimin e zbatimit të Ligjit për shëndetësi.

Raporti u është shpërndarë deputetëve me kohë, prandaj e hapë diskutimin. Ftoj kryetarin e Komisionit përgjegjës raportues ta marrë fjalën.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. kryetar, edhe pse falënderoj ministrin e Shëndetësisë që me të vërtetë tërë ditën ka pritur me e dëgjuar këtë raport, megjithatë mendoj se ky raport është punë ekipore e tërë Komisionit funksionit funksional dhe është një raport konsensual.

Megjithëse pikë tjetër është që ne në një shkresë që ia kemi dërguar gjithashtu Kryesisë së Kuvendit, ka qenë domosdoshmëria e prezencës së kryeministrit dhe të ministrit të Financave në këtë seancë. Meqenëse në këtë moment ne e dimë që me shëndetësi, përveç ministrit i cili është përgjegjës në ministri kemi edhe një grup tjetër ndërministror, ku përgjegjësia është marrë edhe merret, domethënë edhe gjysma e kabinetit qeveritar në çështjet e shëndetësisë si dhe ministri i Financave i cili duhet të japë kyçe sa i përket fondit për sigurim shëndetësor.

Duke pasur parasysh që edhe mungon një pjesë e madhe e deputetëve nga Komisioni funksional, unë po propozoj, por nuk do të thotë që a do të vendosë kjo seancë të shtyhet edhe kjo pikë edhe pse kam luftuar individualisht shumë që ky raport të vijë në rend dite, sepse me të vërtetë i përfshinë rekomandimet të cilat kemi qenë të interesuar si komision që të miratohen nga ky Kuvend, sepse atje do të fuqizohen dhe do të jenë ndihmesë për Ministrinë e Shëndetësisë. Duke i pasur parasysh të gjitha këto që i përmenda, unë ju lus që ta vëni këtë propozim, ta shqyrtoni që të shtyhet, duke e pasur parasysh që është një punë konsensuale e gjithë komisionit, sot mungon një pjesë e madhe e deputetëve, mungojnë njerëzit kyç që janë relevantë që t'i dëgjojnë këto rekomandime, sepse gjithë e dimë, se si është situata në shëndetësi dhe problemet me të cilat po përballlemi. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në sallë kemi vetëm 59 deputetë Ftoj përfaqësuesin e LDK-së, Naim Jerliun,

DEPUTETI NAIM JERLIU – Ju faleminderit z. kryetar.

Ashtu si e tha edhe kryetari, është një pikë e rendit të ditës e cila është kërkuar edhe më herët që të hyjë si temë e debatit e diskutimit në seancë parlamentare. Në fakt Komisioni Parlamentar për Shëndetësi qysh vitin e kaluar kishte me marrë iniciativën që në suaza të kompetencave të veta mbikëqyrëse, të nis hartimin e një raporti i cili do të kishte për qëllim monitorimin e realizimit në praktikë ligjit për shëndetësi, që është miratuar në vitin 2004.

Në fakt aktiviteti mbikëqyrës i komisioneve parlamentare është praktikë relativisht e re, e cila zhvillohet në Kuvendin tonë, sidomos sa i përket monitorimit të zbatimit të ligjeve të miratuara në Kuvend, por komisioni e ka vlerësuar se e vlen që në punën tonë të provojmë që përmes raporteve të detajuara të vlerësojmë dhe të përcjellim se sa po implementohen ato ligje të cilat janë miratuar në periudhën e deritashme të funksionimit të Parlamentit.

Në raportin e shpërndarë të gjithë deputetëve dhe që është rezultat i punës disa mujore të Komisionit, është shqyrtuar në tërësi implementimi i ligjit sidomos në kuptim të hartimit, nxjerrjes së akteve nënligjore, pa pretenduar që të analizohet kualitativisht implementimi i atyre akteve, pjesë të këtij raporti, përpos vlerësimit të gjendjes lidhur me zbatimin e Ligjit për shëndetësi, janë edhe disa rekomandime të cilat janë menduar se do të duhej të jenë masa që do të ndërmerren nga Qeveria. E them nga Qeveria, për faktin se një pjesë e rekomandimeve po edhe e obligimeve që dalin nga Ligji për shëndetësi nuk janë obligime të cilat do të mund të realizoheshin vetëm nga Ministria e Shëndetësisë, por bien edhe në fushën e disa ministrive të tjera, posaçërisht të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, po ashtu edhe në përgjegjësi të Shërbimeve Publike, në përgjegjësi e të Qeverisë në kuptimin e përgjegjësive që janë sidomos për stafin në sektorin e shëndetësisë.

Në hulumtimin që ka bërë apo përcjelljen e implementimit të Ligjit të shëndetësisë, komisioni ka ardhur në përfundim se ka pasur ngecje sidomos në nxjerrjen e një vargu aktesh nënligjore, të cilat kanë qenë obligim i Ministrisë, respektivisht i Qeverisë dhe po ashtu ka konstatuar se një pjesë e akteve nënligjore është dashur të nxirren dhe disa procese të tjera që kanë të bëjnë me procesin e reformimit dhe të ristrukturimit të sektorit shëndetësor, nuk është arritur të realizohen me kohë apo siç është paraparë me Ligjin për shëndetësi.

Këtu do të duhej përmendur posaçërisht disa segmente, siç është riorganizimi i Qendër Klinike Universitare, që mbështetur në Ligjin për shëndetësi është dashur të përfundojë më 31 dhjetor të vitit 2004, pastaj themelimi edhe fillimi i funksionimit të fondit të sigurimeve shëndetësore që është mbështetur në Ligjin për shëndetësi, është dashur të fillojë të funksionuar më 1 janar të vitit 2005, pastaj konstituimi i këshillit të përgjithshëm profesional në shëndetësi, i cili është dashur të fillojë së funksionuar më 1 janar të vitit 2005 dhe po ashtu edhe një varg veprimesh dhe akte të tjera të cilat është dashur të ndërmerren me të cilat është ngecur deri më tash.

Po ashtu komisioni ka ardhur deri te konstatimi se p.sh. për mos përmbushjen e obligimit për fillimin e punës të fondit për sigurime shëndetësore ekziston edhe një farë justifikimi që është i lidhur me faktorin jashtë Ministrisë së Shëndetësisë, megjithatë, komisionet nuk janë ofruar apo komisioni nuk ka gjetur arsyetim të argumentuar për mos përmbushje të afateve kohore lidhur me riorganizimin e QKUK-us dhe po ashtu për themelimin e këshillit të përgjithshëm profesional.

Duke mos dashur të futem më tej në detaje edhe për faktin se ne gjithë e kemi marrë këtë raport, dua të theksoj edhe një element tjetër që besoj do të jetë shumë i rëndësishëm për veprimet e metutjeshme të Qeverisë në funksion të përmirësimit të gjendjes në sektorin shëndetësor. Është fjala për financimin e këtij sektori dhe krijimin e një financimi të qëndrueshëm i cili do të siguronte që sektori shëndetësor të përmirësojë

gjendjen e vet dhe po ashtu edhe ndërmarrjen e hapave urgjentë që të fillojë së funksionuari fondi i sigurimeve shëndetësore dhe i agjensioneve të tjera të sigurimit shëndetësor, të cilat në bazë të një projektligji që e kemi kaluar në leximin e parë në këtë Parlament, do të duhej të respektohen parimet edhe standardet që janë të aplikueshme në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Dua të them po ashtu se një pjesë e përgjegjësisë për ngecjen në këtë plan nuk do të mund të adresohet vetëm te Ministria e Shëndetësisë. Kjo është çështje e ndërlidhur me mundësitë buxhetore të Qeverisë së Kosovës, por është ky debat i sotëm, ndoshta një moment i mirë që të theksojmë nevojën që të dominojë vetëdija që të gjejmë një zgjidhje që fondi i sigurimeve shëndetësore si një parakusht esencial për stabilizimin e sektorit shëndetësor, të fillojë sa më parë së funksionuari. Asnjëra nga reformat e mundshme apo përpjekjet në përmirësim në këtë sektor nuk do të mund të garantojë sukses, nëse në Kosovë nuk do të fillojë të funksionojë sistemi i cili është i aplikueshëm në të gjitha vendet që kanë sistem të qëndrueshëm shëndetësor.

Në përfundim më lejoni të them se këtij raporti si aneks i është bashkangjitur lista e rekomandimeve të cilat kemi konsideruar se është mirë që të aprovohen në Parlament dhe si të këtilla të jenë obliguese për Ministrinë dhe për Qeverinë dhe si të këtilla, po ashtu, të jenë në përpjekje dhe për angazhim e dëshnim të përkushtimit të këtij Parlamenti për hapa në përmirësim të gjendjes së sektorit shëndetësor.

Ju ftoj që përveç kontributeve që do t'i japim me debat në fund të miratojmë këtë raport me pjesën e rekomandimeve dhe në këtë mënyrë t'i japim mbështetje Qeverisë në realizimin e këtyre rekomandimeve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! përfaqësuesi i AAK-së

Pas përfaqësuesit të AAK-së keni me marrë fjalën ju. Ju lutem do ta merrni fjalën kur t'ju vjen radha. AAK-ja a e ka përfaqësuesin. Zylfije Hundozi.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Zotëri kryetar, zoti ministër, kolegë deputetë. Ligji për shëndetësi është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në shkurt 2004 dhe në bazë të Rregullores 53 të punës së Kuvendit të Kosovës Ministria e Shëndetësisë është dashur një herë në vit t'i raportojë Komisionit për Shëndetësi për zbatueshmërinë e ligjit pasi që kjo nuk ka ndodhur, atëherë Komisioni për Shëndetësi, duke u bazuar në këtë rregull ka filluar monitorimin e zbatimit të ligjit nëpër institucionet shëndetësore në tërë Kosovën.

Puna tetëmuajore e Komisionit ka rezultuar me raportin për të cilin po debatohet sot. Menjëherë gjatë monitorimit është kuptuar se sa i dobishëm është ky proces për arsye se u bë një udhërrëfyes për konstatimin e gjendjes së vërtetë në institucionet shëndetësore dhe lidhshmërisë së kësaj gjendjeje me zbatimin e Ligjit për shëndetësi, i cili është një ligj bazik në këtë fushë. Pas këtij monitorimi i zbatueshmërisë së ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës duhet të jetë imperativ i kohës për këtë Kuvend.

Puna e madhe që kemi bërë në këto dy mandate për miratimin e shumë ligjeve do të mbetet vetëm një punë mekanike dhe do të humbet qëllimi i vërtetë i punës së këtij Kuvendi nëse ato ligje që i kemi miratuar nuk zbatohen, objektivat të cilat i ka

parashtruar komisioni vetes, pas një pune të gjatë janë arritur plotësisht dhe hollësisht janë dhënë në raport.

Vlerësimi i përgjithshëm mbi zbatimin e Ligjit është se ky ligj po zbatohet vetëm pjesërisht, me atë një pjesë e vogël e tij, nëse marrim parasysh se zbatimi i këtij ligjit varet nga nxjerrja e akteve nënligjore dhe ligjore, me të cilat do të bëhet i mundshëm funksionalizimi i këtij ligji, Ministria ka nxjerrë 60% të ligjeve të parapara dhe 30% të akteve nënligjore. Është e kuptueshme pse ky ligj po zbatohet vetëm pjesërisht.

Punëtorët shëndetësorë, por edhe shumica e udhëheqësve të institucioneve shëndetësore publike, nuk ishin të njoftuar për ligjin dhe aktet nënligjore. Vlerësimi i detajuar i përmbushjes së obligimeve specifike nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë është dhënë në raport, por thënë në përgjithësi Ministria e Shëndetësisë nuk i ka përmbushur disa obligime të rëndësishme, që janë të domosdoshme për funksionimin themelor të shëndetësisë e që dalin nga ky ligj.

Mos rregullimi adekuat i punës në sektorin farmaceutik, sidomos furnizimi i mangët i institucioneve publike shëndetësore me barna nga lista esenciale. Në këtë lëmi situata është e rëndë dhe burim i pakënaqësive si për pacientët, ashtu edhe për punëtorë shëndetësorë që tregojnë edhe greva në QKU.

Sistemi informativ nuk është funksional nga ky sistem është bërë grumbullimi i të dhënave, por jo edhe përpunimi e interpretimi apo analiza e tyre, prandaj menaxhmenti nuk ka mundur t'i përdorë të dhënat e marra nga ky sistem si bazë për planifikim dhe organizimin e shërbimeve shëndetësore dhe nën.

Financimi, moszbatimi, gjegjësisht zbatimi i pjesshëm, me nenin 12 pika.6 para shihet finansimi i qëndrueshëm i kujdesit shëndetësor, si edhe parandalimi i rrezikut financiar për qytetarët gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore. Gjer më sot nuk është krijuar një sistem financiar gjithëpërfshirës i sistemit shëndetësor dhe kjo bashkë me keq menaxhimin e mjeteve financiare ka ndikuar negativisht në sektorin e financimit të kujdesit shëndetësor. Pa financim të qëndrueshëm dhe të mirëfilltë nuk mund të ketë shërbime shëndetësore kualitative.

Moszbatimi, gjegjësisht zbatimi i pjesshëm i ligjit ka pasur pasoja serioze në funksionimin e institucioneve shëndetësore, publike dhe private, duke keqësuar gjendjen në shëndetësinë kosovare, e cila edhe ashtu ishte e rëndë.

Komisioni ka paraqitur 46 rekomandime të cilat Ministria e Shëndetësisë duhet t'i marrë parasysh dhe t'i zbatojë ato dhe pas një afati të caktuar t'i referojë Kuvendit të Kosovës për zbatueshmërinë e këtij ligji.

Për raportin mund të them se është gjithëpërfshirës dhe i qartë. Me përmbajtjen e vet e ka dhënë një pasqyrë të qartë të zbatueshmërisë së Ligjit për shëndetësi dhe ka ndihmuar për sqarimin e konfuzionit që ekziston në sistemin e shëndetësisë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

DEPUTETI XHEZAI R MURATI – Evo g. Predsedniče da i vas pozdravljam, i ministre i kolege koje su ovde na ivici kforuma odnosno bez kvoruma i mi mižemo praviti izgleda komentare, koliko bi bili oni efktni ja bih pre isvmuo na izveštaj komisije za zdravstvo rekao sam jednu primedbu a već je bilo takvo primedaba rečenih, da u utorak je u hotelu Alfa na kratko bibilo održan jedan veoma važan seminar Projekat dalja podrška Skupštini Kosova gde su bili prisutni osmoro renomiranih poslanika iz Belgije, Nemačke, Francuske i Slovenije, i u tom prilikom nekih od ovih poslanika neki kolega koji su ovde a bili koji su prisutni gde rečeno doslovce da je u nazivu bilo parlamentarne nadgledanje Vlade, mi jako lepo sada nadgledamo vas i vidimo da nema ovde nikog sem jednog ministra ili kad su prisutni onda su uvek prepoznatljivo jedno te isti maltene na naše pitanje šta će biti u parlamentu ukolko se raspravlja tematika gde je bitan segment prisustva određenog ministra odgovoreno nam je parlament pravi pauzu.

Dokle god taj ministar ne dođe, a ukoliko ne dođe opet ima metoda privođenja i takodalje. Mi ne vidimo takvu efikasnost u našem parlamentu i to u ovoj fazi kada je veoma važnost srega parlamenta i Vlade dakle nešto nije u reku ili sa pravilnikom rada Skupštine ili sa nerelacija saradnja vlada skupština ali mi nažalost evo prisustvujemo evo ovakvom jednu zasedanju koja je koliko je jedna legitimnos danas ako je na 60 –tu drugo, ja bih sada da se vratim malo i izveštaju komisije, Svima nama je poznato da je zdravstveni sistem Kosova u ostalom kao i većina ostalih oblasti i delatnosti izašao je znatnih sukoba dosta oštećen nakon čega se pristupilo obnovi i transformaciji zdravstvenog sistema koja kako to uvidamo još uvek traje.

Desetogodišnja stagnacija zdravstvenog kadra i institucija ranije sistema uslovila je neophodnu potrebu za edukacijom i u savršanjem postojećih kadrova kao i nametnula potrebu da se razmišlja o usavršavaju budućih stručnjaka kao posledicu tih dešavanja i mamu čitavu ekspanziju specijalističkih usavršavanja kao i post diplomskih studija. To je dovelo do hiperprodukcije stručnjaka ne boli glava nikad od njih ali naša ovaj ekonomia i potrebe za sada ne mogu da ih prime i to je svakako izazvalo budžetske ograničenja sa kojima se suočava ministarstva zdravstva a normalno mi vidimo da još uvek ima stihije u tome i već sumoji kolege rekli da se ne može odgovornost prelaziti samo na nekoga ako to zavisiti od nekih drugih. Oni koji su odsutni kod nas uvek su u boljoj situaciji nisu prisutni da im ukažemo na propuste.

Napominjem da je Skupština Kosova usvojila zakon što je koleginica pre mene rekla februara 2004. godine a specialni predstavnik je potpisao 7 meseci kasnije, kao što vidimo uzveštaje komisije koji nam je dostavljen komisija za zdravstvo je u prvih u 6 meseci je u ovoj godine obišla nekoliko glavnih zdravstvenih institucija, uključujući i kabinet ministra u cilju uvida u monitorisanje istog dakle zakona.

Nakon čega je urađen sve obuhvatni izveštaj sa mnogim primedbama ali preporukama. Naravno sa mnogima bih se složio, a na neke bih ja stavio i znak pitanja to je ovom drugom prilikom.

Mislim da je u ovom izveštaju zaobiđen jedan evidentan propust na relaciji ministarsvo – zdravstva, ministarsvo – ekonomie o čemu je i kolega doktor Naim je govorio dakle a zašto ovo pominjem zbog budžetskih implikacija do koje je dolazilo i to u više navrata

kako još uvek kod nas ne postoji fond za zdravstveno osiguranje kako je to u ostalim zemljama jer nemamo još uvek usvojen ni zakon o zdravstvenom osiguranju.

Iz čega proizilazi da su izdvajanja iz kosovskog konsolidovanog budžeta sve manja a realne potrebe stanovništva je sve veće.

Tu prije svega mislim na esencijalnu listu lijekova to ljudi iz dravlja mnogo bolje znaju koja je kod nas sve više se revidira ne zadovoljavajući ni minimum potreba stanovništva.

Stoga apelujem na što brže donošenje zakona o zdravstvom osiguranju kao jednom od osnovnih zakona za kosovsko zdravstvo, što će biti od oslanaca u radu ove važne institucije za sve građane Kosova.

Ja bih takođe podržao mnogih 50 preporuka izveštaju komisije ukoliko bi se usvojile neke od predloženih izmena i dopuna. Zakona u zdravstvu on će postati primenjiviji u svakoj dnevnoj praksi što nam je svakako svima krajni cilj. Analiza izveštaja komisije za zdravstvo upućuje da konstatujemo da je neophodno da Vlada u narednoj budžetskoj godini još jednom razmotri, dakle da još jednom razmotri stanje oko povećanja izdvajanja sredstava budžeta za zdravstvo za narednu godinu, ali i obavezu ovo naglašavam dakle obavezu tijesnije saradnju ministarstva zdravstva sa ministarstvom za ekonomie i finansije i obrnuto, koju buduće treba da bude efikasnije i ekspeditivnije isplati te takođe i sa ministarstvom obrazovanja nauke i tehnologije i ministarstvom za rad i socijalnu politiku u cilju zajedničkog donošenja ni za pod zakonskih akata i administrativnih uputstava jer se ona na mnoge kategorije prožimaju prepliću tako evo na primer ako uzmemo samo neke kategorije ugroženog stanovništva, penzionere, lica sa ograničenim sposobnostima, invalide, djecu bez roditelja i da ne nabrajam i tako dalje. Kažem njihovom boljom koordinacijom ovom ministarstava i saradnjom mnogi dosadašnji propusti mogu okloniti a brojni problemi koji su bili rezultat te nesaradnje koja dovodi do onoga do čega ovih dana dovela i propusta ne bi se sigurno ponovilo. U tom cilju i izveštaj i sugestije koje proizilaze iz njega su dobrodošli. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni. doktor Ferid Agani

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë, i nderuari ministër, Grupi Parlamentar për Integrim mbështet që në fillim mocionin të cilin kryetarja e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale e bëri që ky debat të shtyhet për seancën e radhës. Vazhdimi i debatit në këto rrethana vetëm do t'i irritojë punëtorët shëndetësorë dhe opinionin e gjerë dhe paraqet një vazhdimësi të qasjes jo serioze ndaj problemeve enorme në sektorin e shëndetësisë.

Është hera e par që në Kuvend të Kosovës shqyrtohet zbatimi i një ligji në bazë të një raporti të mirëfilltë të punuar një kohë shumë të gjatë dhe raportit të miratuar me konsensus, nga të gjithë anëtarët e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi. Unë ju kisha lutur edhe kërkoj në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, të merrni parasysh këtë mocion që debatin ta vazhdojmë në seancën e radhës, ku do të sigurohet pjesëmarrja e kryeministrit të Kosovës, ministrit për Ekonomi dhe Financa, natyrisht ministrit për Shëndetësi dhe në të cilën në kuadër të shqyrtimit të zbatimit të Ligjit për shëndetësi, do të tentojmë të dalim me propozime konkrete dhe me fuqizimin e rekomandimeve të cilat

janë bërë në fund të raportit. Mendoj se është momenti i fundit që kësaj çështjeje t'i qasen në mënyrë serioze dhe gjithëpërfshirëse të gjitha fuqitë politike në Kuvendin e Kosovës, përndryshe, një dalje e tillë në rrafshin politik nuk premtion zhvillime pozitive në sektorin e shëndetësisë në të ardhmen.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Sa është prezenca e deputetëve në sallë? Në sallë aktualisht kemi 54 deputetë. Ftoj deputetët që nuk janë në sallë, të kthehen sa më parë.

58 deputetë gjenden në sallë.

Debatin mund ta mbajmë, por vendime nuk mund të marrim.

I kemi dy kandidatë që janë paraqitur për diskutim, Fehmi Vula dhe Ramadan Kelmendi. Urdhëroni doktor Fehmi.

DEPUTETI FEHMI VULA- Ju faleminderit z. kryetar, unë e kam shtypur tasterin duke menduar se ne do të diskutojmë sot për këtë rend dite, këtë pikë të rendit të ditës, por ende nuk e kuptova a do të diskutojmë a nuk do të diskutojmë. Për arsye se jam i mendimit se bëhet fjalë jo se është pika më e rëndësishme për të gjitha fushat e jetës, por është mjaft e rëndësishme në qoftë se- këtë e them për arsye se i takoj grupit (sektorit) të shëndetësisë, por mendoj se është një seriozitet jo i mjaftueshëm për arsye se edhe këtë numër na dolën edhe katër pesë deputetë jashtë, ne vetëm të diskutojmë nuk është në rregull.

Unë mendoj se ne duhet të diskutojmë për të na dëgjuar dikush, e në qoftë se na dëgjon dikush atëherë rregullojmë disa çështje në këtë drejtim, për arsye se nuk do të dëshironim që të na ndodhë edhe neve skenari 20 e sa ditësh si në QKU ose në këtë shëndetësinë e Kosovës.

Pa marrë parasysh a do të ketë jehonë a do të ketë rezultat diskutimi i sotëm dhe përfundimet që do t'i marrim ndoshta sot unë mendoj se nuk do të jemi në gjendje për shkak të numrit shumë të vogël të deputetëve në këtë sallë. Pra, nëse ju e shihni të arsyeshme unë do të vazhdoj me fol. Edhe një herë thashë se i pashë se dolën katër – pesë deputetë tash

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Po 55 deputetë tash i kemi në sallë. E vërtetë është,

DEPUTETI FEHMI VULA – Unë nuk po insistoj edhe pse do të dëshiroja që me të vërtetë në qoftë se nuk ka mundësi zoti Agim Çeku me qenë prezent, atëherë së paku të jetë ministri i Financave se ministri i Shëndetësisë edhe sot edhe dje ka qenë prezent edhe ka qenë i gatshëm të na dëgjojë edhe ndoshta të na japë mendimet e veta.

Por është shumë me rëndësi se kjo sferë kërkon mjete shtesë financiare, kërkon edhe një menaxhim të mirëfilltë, duke filluar nga Ministria deri te qendra më e vogël e mjekësisë familjare diku në fshat. Për arsyes se ne duhet të gjejmë pa tjetër resurse të reja financiare për të mund t'i dalim në krye për një minimum sado të vogël kërkesave të qytetarëve tonë. E unë mendoj që do të jetë i pa seriozitet që ne sot e fatkeqësisht, po them se

shumë po na përcjellë opinioni kosovar ,thonë: a thua kaq e pa rëndësishme qenka kjo pikë e rendit të ditë që ma shumë se gjysma e deputetëve dolën jashtë,në qoftë se ju mendoni atëherë mundemi me vazhduar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Po ju pyes edhe një herë, a ja vlen të diskutojmë të bëjmë debat pa fuqinë e vendimmarrjes, apo jo, atëherë ta ndërpresim.

Urdhëro profesor.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Zotëri kryetar i Kuvendit, kolegë të nderuar deputetë, unë e thashë edhe nga vendi kjo e do edhe një koment dhe po përsëris diçka që kam thanë në këtë sallë, po më duket para një muaji.

Kjo temë ka ardhur në bankat e Kuvendit me insistim të jashtëzakonshëm të Komisionit për Shëndetësi.

Ka pasur ide edhe në Kryesinë e Kuvendit që raportet e komisioneve të Kuvendit nuk duhet të dalin në Kuvend dhe këto kanë qenë kërkesat e opozitës, është Lidhja Demokratike e Kosovës që e ka pranuar, megjithatë që ky raport të diskutohet në Kuvend, e tash është absurdi i llojit të vet është që opozita nuk do të bisedojë për temën që e kërkon në Parlament dhe kjo duhet të thuhet haptas

Unë po them që në këtë parlament që duhet të jetë shumë përgjegjës, duhet të pushojmë ose të mos fillojmë, të them më mirë,lojërat politike jo parimore. Ne jemi përfaqësues politikë këtu, por jemi ligjvënës, kemi interes t'i mbrojmë interesat e gjithë qytetarëve të Kosovës, nëse mjekësia është një sektor tepër i rëndësishëm i Kosovës, një sektor që ka probleme të mëdha për të mos thënë është në krizë, atëherë është përgjegjësi e çdo përfaqësuesi që do të vijë këtu dhe ta diskutojë dhe të kërkojë zgjidhje e cila do t'i propozohet Qeverisë,

Unë i respektoj të gjithë që janë këtu dhe që donë t'i marrin përgjegjësitë. Unë i theksova dhe i ftoj ata që kanë përgjegjësi, të vijnë në Parlament dhe të shtrojnë idetë e veta. Është e vërtetë po të mos jetë së paku më shumë se gjysma në kuptimin formal, nuk mund të votohet asgjë qoftë edhe rekomandimet, por në Parlament mund të diskutohet problemi u tha këtu nuk ekziston një vullnet i veçantë që të diskutohet substancialisht sot. Nëse është ashtu atëherë unë mendoj që nuk duhet të vazhdohet, sigurisht, por po ju them edhe një herë, më jepni garanci se nuk do të luhet loja politike që unë t'i quaj joparimore për të mos përdorur më emër tjetër, tjetër herë. Ju faleminderit.

KRYETARI IKUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Vazhdojmë ditën e hënë, në orën 10.

20.11.2006 në orën 10,00
VAZHDIMI I SEANCËS

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA - I lus deputetët që t'i zënë vendet e tyre.

Vazhdojmë me pikën e 10 të rendit të ditës:

Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për shëndetësi

Udhëro Ramadan!

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI - I nderuari kryetar, ju faleminderit për fjalë, të nderuar qeveritarë dhe deputetë. Në emër të 121 kryefamiljarëve shqiptarë, boshnjakë, turq, romë, ashkalinjë e të tjerë, të cilët banojnë në lagjet Veriore të qytetit të Minitrovicës dhe mbështetur në rregullën 29 kërkoj që në seancën e ardhshme të caktohet ekskluzivisht vetëm për problemin e banesave dhe të pronave të paluajtshme të shqiptarëve, si çështje urgjente për të miratuar një deklaratë me të cilën do të pamundësohet lidhja e kontratave dhe shitblerjeve. Unë, lidhur me këtë paraqes dëshminë e nënshkrimeve të të gjithë qytetarëve dhe kryefamiljarëve dhe një dëshmi tjetër të posedimit. Pronën të cilën unë e posedoj Qeveria e Serbisë përmes matrapazëve dhe shqiptarëve avokat më ka ofruar 500 € për metër katror. Ky është dokument bartës i drejtës banesore dhe dokumentacioni nga HABITAT-i që më është njohur e drejta banesore. Unë jam një ndër ata, jo rasti im, ta shpëtojmë atë pronë dhe ta shpëtojmë strukturën shqiptare në Veri. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVEDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ju lutemi procedoni në mënyrë të rregullt në sekretari.

Vazhdojmë debatin rreth raportit të Komisionit për Shëndetësi.

Fjalën e ka deputetja Zahrije Jusufi

DEPUTETJA ZAHRIJE JUSUFI – I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë. Ligji për shëndetësi nr. 2004/4 përcakton sistemin e kujdesit, veprimtarisë shëndetësore. Qëllimi i monitorimit të Ligjit është që brenda fushës së përgjegjësisë të ndikojë në përmirësimin e cilësisë të shërbimit shëndetësor. Gjatë monitorimit në institucionet shëndetësore u konstatua se shkalla e implementimit të ligjit është e ulët dhe se qëllimet legjislativ i ligjit nuk është plotësuar. Ligji parashikon një numër të madh të dispozitave të cilat duhet të zbatohen përmes akteve nënligjore, për zbatim sa më të efektshëm të tij në praktikë, por gjer më tani shumë pak është realizuar për t'i shërbyer funksionalitetit të institucioneve shëndetësore. Analiza tregon se implementimi i ligjit nuk ishte në vëmendjen e duhur të Ministrisë së Shëndetësisë. U konstatua se duhet të hartohen shumë akte nënligjore për implementimin e tij, vonesa e përpilimit të tyre është, përpos tjerash, edhe në determinante që ndikon në stagnim të implementimit të ligjit. Në ligj parashikohen afatet për përgatitjen e akteve nënligjore.

Ministria e Shëndetësisë nuk i ka përmbushur detyrimet duke mos respektuar afatet për nxjerrjen e tyre. Analiza tregon se vonesa e tyre e bënë ligjin jo të zbatueshëm në shkallën e duhur. U konstatua se Ministria nuk ka mekanizma të mbikëqyrë funksionalitetin e ligjit. Institucionet shëndetësore nuk janë njoftuar për rekomandime përcjellëse dhe obligimet për institucionet implementuese. Përpos ligjit të Ministrisë të Shëndetësisë edhe Qeveria ka përgjegjësi për implementim të Ligjit. Qeveria gjer më tani nuk ka nxjerrë asnjë akt nënligjor për implementimin e ligjit. Numri i urdhëresave administrative të hartuara gjatë vitit është i vogël dhe i pamjaftueshëm dhe se pa legjislacion plotësues vlerësojmë se implementimi është i pamundshëm. Gjatë monitorimit u identifikuan probleme të shumta në shëndetësi, mangësi të sistemit shëndetësor dhe rekomandime konkrete për tejkalimin e gjendjes. Në pamundësi që t'i shqyrtojmë të gjitha, propozojmë disa më problematikat.

Në institucione u konstatua gjendje shumë e rëndë. Problem madhor në të gjitha institucionet u konstatua mungesa e barërave të listës esenciale. U fol shumë për këtë problem, edhe këtu në Kuvend edhe jashtë. Asnjë nen i ligjit apo akt nënligjor nuk u mundëson institucioneve të blejnë barëra nga buxheti i tyre edhe për rastet më emergjente. Është defekt i ligjit dhe mungesë e strategjisë afatshkurtër dhe afatgjatë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe e Qeverisë për të mos rrezikuar shëndetin publik. Ministria e Shëndetësisë duhet t'u japë prioritet hartimit të akteve nënligjore dhe harton strategji për tejkalimin e gjendjes. Qëllimi i Ligjit që të arrijë furnizim me barëra të listës esenciale dhe material sanitar është plotësuar vetëm 10 deri 30%. Përgjegjësinë kryesore për implementimin e këtij neni e ka Qeveria. Nenet në vijim paraqesin disa nga problemet e identikuara. Nenet 22, 23, 24, 27.5 janë përgjegjësi e Ministrisë dhe Qeverisë që ta hartojë strategjinë për implementimin e neneve për tejkalimin e gjendjes. Edhe pse qeveritë e shteteve të pasura ballafaqohen me paqëndrueshmëri të sistemeve shëndetësore për shkak të rritjes së shpenzimeve dhe mungon politika shëndetësore dhe zbatim jo i drejtë i financimit shëndetësor që shkaktuan gjendjen e rëndë. Edhe pse duhet kohë, fondi i sigurimeve shëndetësore do të jetë një mekanizëm shtesë dhe i domosdoshëm për plotësim të financimit. Ministrisë me ligj i është dhënë detyrë të themelojë fondin sipas nenit 124.2. Fondi i sigurimeve shëndetësore është dashur të fillojë punën më 1. janar 2005. Ministria e Shëndetësisë nuk i ka përmbushur detyrimet që burojnë nga ky nen, po ashtu edhe Qeveria nuk i ka përmbushur detyrimet e këtij neni me arsyetimin se krijimi i fondit është në kundërshtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Ky projektligj është i rëndësishëm vitalë nga se mënyra e financimeve në shëndetësi është e pamjaftueshme. Detyrimet e tjera të Ministrisë të Shëndetësisë në bazë të ligjit, për financim të sistemit shëndetësor sipas nenit 57 sigurohen edhe nga burime të tjera. Nuk zbatohen sipas nenit të parashikuar. Të gjitha dispozitat e Ligjit nga nenet 57, 58, 59, 60, 61 mbeten të pa implementuara. Dispozitat e nenit 27.3 nuk janë implementuar. Implementimi i këtij neni të ligjit përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë, si rezultat i mospërmbushjes së detyrave, janë krijuar pakënaqësi të shumta që janë manifestuar me greva për shkak të mospagesës së kujdestarisë, edhe pse Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë dy urdhëresa administrative ato ishin të mangëta dhe nëpërmes tyre nuk u tejkalua gjendja.

Analiza e shkallës së zbatueshmërisë së nenit 33 të Ligjit për sektorin e farmacisë tregon se shumë probleme u identifikuan dhe vunë në pah mangësitë e këtij neni. U dëshmuua se ky nen është jo praktik, jo funksional. Furnizimi, deponimi, shpërndarja e barërave janë disa nga problemet madhore të identikuara, duhet të ndërrohet qasja. Në këtë nen

mungojnë standardet e menaxhimit të barërave. U konstatua qasje jo e drejtë për trajtimin e problemeve që i parashih ky nen. Është e nevojshme që boshllëqet e këtij neni të plotësohen me akte nënligjore se ky sektor të jetë funksional.

Edhe neni 24.5 nuk implementohet. Sipas këtij neni barnat nëpër barnatore jepen vetëm nga ana e farmacistit.

Edhe nenet: 21.1, 24.3, 24.4, 24.5, nuk implementohen. Si pasojë e mos implementimit të këtij neni në barnatoret tona blihen barëra me cilësi të dyshimtë, të falsifikuar, të regjistruar pa kriter, pa receta të mjekut. Nga mungesa e regjistrimit të barërave farmacistët furnizohen në mënyrë ilegale me barëra të domosdoshme në përqindje shumë të lartë.

Edhe nenet 94.1, 94.2 nuk implementohen. Në këtë nen mungon aktin nënligjor. Sipas këtij neni punëtorët shëndetësorë janë të detyruar të aftësohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim të ngritjes së cilësisë. Mosimplementimi i këtij neni pamundëson investimin në dije. U konstatua se nga ana e Ministrisë e menaxherëve të institucioneve nuk përfilllet strategjia e edukimit të vazhdueshëm. Në ligj mungon akti nënligjor për subspecializime. Mosvlerësimi i tyre e vështirëson punën e institucioneve. Ky nen duhet të plotësohet për arsye se është i nevojshëm koordinimi i planit strategjik për resurse humane në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe nevojave të institucioneve.

Edhe neni 49.3. nuk implementohet. Institucionet shëndetësore mbikëqyren nga ana e Këshillit mbikëqyrës. Në institucionet shëndetësore mungon mbikëqyrja profesionale me qëllim të funksionimit më të mirë, Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë masa të nevojshme për të nxjerr aktin ligjor e komandues për institucionet shëndetësore.

Rekomandojmë që Ministria e Shëndetësisë t'i përmbushë obligimet që kërkohen sipas ligjit, të hartojë akte nënligjore sipas prioriteteve dhe t'i afatizojë ato. Për ta arritur qëllimin legjislativ të ligjit propozojmë që të hartohen strategji afatshkurtër dhe afatmesme jo improvizuese, që do të sjellin ndryshime të shumëfishta. Për financim të qëndrueshëm dhe për kosto efektive sistemi i financave të plotësohet sipas ligjit dhe nën dy, të përshpejtohet Ligji për sigurime shëndetësore, të përmirësohen defektet ligjit. Ministria e Shëndetësisë të marrë masat procedurale për plotësim të Ligjit për shëndetësi, të hartohet strategji për zhvillim të resurse humane për ngritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor. Të plotësohen normat dhe standardet e mbikëqyrjes së institucioneve nga ana e Këshillit mbikëqyrës profesional, që ligji të realizohet në mjete oficiente, të planifikohen mjetet shtesë sipas arsyetimeve dhe programe sipas prioriteteve. Për barërat e listës esenciale, programe për aparaturë me prioritet dhe për edukim. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në sallë janë 79 deputetë. Fjalën e ka deputeti Fehmi Vula, le të përgatitet deputeti Gjergj Dedaj.

DEPUTETI FEHMI VULA – Ju faleminderit z. kryetar, përshëndetje për ju për ministrat dhe gjithë deputetët kolegë. Nuk është modeste, por është realitet të thuhet se raporti i Komisionit për Shëndetësi është i pari i këtij lloji në praktikën e këtij Kuvendi deri më tani, prandaj kërkoj një respekt nga ky Kuvend. Ju falënderohem që e vutë në rend të ditës për arsye se e meriton të fitojë këtu një peshë të veten ndoshta edhe peshën ekzekutive. Nuk është vetëm një monitorim i thjeshtë i mënyrës së implementimit të Ligjit për shëndetësi në terren, por ka edhe karakterin e një studimi për shkak se hyn më thellë jo vetëm në konstatimet e gjendjes së shëndetësisë në Kosovë, por aty jepen

edhe rekomandimet të cilat do të dëshironim të kenë edhe forcën e detyrimeve për zbatimin e tyre. Natyrisht, këtë forcë, këto sugjerime do ta fitojmë këtu dhe kjo ka qenë arsyeja e insistimit të Komisionit që ky raport të dalë këtu në debat.

Shëndeti i popullit është përparësi mbi përparësi në nën qiellin tonë. Gjendja shumë e vështirë në shëndetësi nuk është vetëm pasojë e mjeteve të pakta financiare, por edhe pasojë i një menaxhimi jo të mirë, duke filluar nga Ministria e deri te njësiat më periferike e shërbimeve shëndetësore. Natyrisht që puna më e madhe pritet të fillojë nga Ministria, ajo duhet të bëjë organizimin e mirëfilltë, ndryshime kadrovike sidomos për postet shumë të përfolura. Me këtë petëz do të qetësoheshin shpirtat në terren dhe pakënaqësitë dhe do të ndikoni në përmirësimin e drejtë dhe të ndershëm të shërbimeve. Kjo do të ndikon drejtpërsëdrejti në përmirësimin e gjendjes financiare sado pak dhe do të zvogëlojë hapësirën e veprimeve, të pakënaqësive nga punëtorët shëndetësorë, por edhe nga vetë kërkuessit e shërbimeve shëndetësore.

Detyrë e dytë për ndikimin e përmirësimit në Departamentin e Farmaceutikës shumë të përfolur, ku mund të kursehen shumë mjete financiare, të cilat nga Shërbimi kishte gjetur rrugë të errëta për të përfunduar në errësirën e vogël të quajtur xhep. Komisioni ka marrë vërejtje të shumta në terren për mënyrën e blerjes së barërave dhe materialin sanitar dhe të aparaturave të ndryshme, tenderë të ndryshëm, ruajtjen e barërave, Mazgiti shumë i përfolur, si dhe distribuimi i tyre. Çmimi i blerjes së barërave shpesh është më i shtrenjtë se çmimi me pakicë. Ka fakte për këtë. Ky drejtorat që dy vite bënë vetëm debate mediale për ekzistimin e barnatoreve pa farmacistë, për diploma dhe licenca të dyshimta, e nuk janë në gjendje ta bëjnë asnjë hap konkret në mbylljen e tyre. Nga ana tjetër Inspektorati sanitar bënë vetëm një vizitë dhe i mbyll shumë ordianca private të ekspertëve të dëshmuar. Natyrisht se bën mirë me këtë, por duhet të bëhet edhe e mira tjetër edhe me barnatore.

Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Arsimit duhet të bashkëpunojnë më seriozisht dhe me sinqeritet e jo të ngelin vetëm në të folurat nëpër koluare, për numrin e madh të diplomave të falsifikuara dhe të licencave të dyshimta. Nuk është në rregull që këto punë shumë të rëndësishme të presin me vite për t'i zbardhur, nuk ka mundësi të zgjidhen, por mendoj se duhet brenda dy-tre muajve e në qoftë se ekzistojnë disponimi dhe vendosmëria, të gjitha këto do të zbardhen. Ministria duhet të decentralizojë disa shërbime të veta, jo pse decentralizimi është trend modern në Kosovë momentalisht, por pse punët do të shkonin më mirë dhe më drejt. Njëra nga këto është emërimi e jo zgjedhja e drejtorëve të institucioneve shëndetësore pa e konsultuar bazën. Baza më mirë i njuh njerëzit e vet e pastaj, natyrisht duhet të marrë edhe bekimin e Ministrisë. Mjetet financiare duhet të sigurohen në sasi dukshëm më të madhe, sidomos për barëra dhe mjete pune. Këto duhet të sigurohen në radhë të parë nga Qeveria e duke u siguruar më shumë nga Buxheti i konsoliduar derdhja nga fondet e tjera, por edhe nga donacionet e mundshme nga jashtë. Kjo së paku derisa të lejohet formimi i fondit për sigurime shëndetësore. Një sasi e konsiderueshme mund të sigurohet edhe nga vetë Ministria, si edhe nga entet shëndetësore. Një menaxhim dhe një organizim më i mirë në të gjitha këto nivele do të siguronte mjete të konsiderueshme. Për shembull në disa takime me ministrin asnjëherë nuk është mësuar arsyeshmëria e ekzistimit të zyrave rajonale të shëndetësisë të cilat kanë staf dhe shpenzime të konsiderueshme, ekzistimi i tyre do të ishte i nevojshëm vetëm kur Kosova të bëhet e madhe sa është Kina. Prandaj ky sugjerim nga terreni dhe Komisioni duhet të përfillet se do të bëhen kursime të konsiderueshme. Në fund kërkoj nga Ministria ta marrë në konsideratë serioze dhe të veprojë për të gjitha rekomandimet e shumta që janë dhënë në këtë raport nga Komisioni

dhe vijnë nga terreni dhe nga ata të cilët ballafaqohen këto ditë me nevoja dhe kërkesa të qytetarëve për ta përmirësuar sadopak situatën e krijuar. Jam i bindur se përfillja e këtyre rekomandimeve do të ndikojë mjaft pozitivisht në përmirësimin e gjendjes të gjithmbarshme në shëndetësi. Rekomandimi më i rëndësishëm është auditimi i shpejtuar në këtë Ministri . Në fund e lus sekretarinë që ta bëjë një përmirësim në pikën 11 të raportit , i cili gjendet në faqen 20 ku thuhet: Shkaku i vdekjes dhe shërbimeve e morgut. Murgjit në këtë vend nuk kanë vend, kanë vend vetëm morgu, prandaj le të shkruhet, nuk është gabim teknik ,por është lëshim i cili përsëritet deri në fund të tekstit – Shërbimet e morgut e jo të murgut. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit doktor! Në vend të deputetit Gjergj Dedaj, fjalën e ka deputeti Numan Baliq

DEPUTETI NUMAN BALIQ – Hvala gospodine Predsedniçe, dozvolite mi da kažem nekoliko rječi vezano za rad Komisije boavljenei posao koju je Komisija radila i predložena rešenja koje je dala. U celini posmatrana Kokmisija je obavila jedan zavidana posao, posjetila je veliki broj institucija, razgovarala je sa velikim brojem ljudi i obavila više posjeta, prikupila dosta informacija, medjutim predložena riješenja u nekim djelovima su nedovoljna u nekim djelovima su čak i smješna, ali u celini posmatrano ona ne nudi odgovor na postojeću situaciju u zdravstvu koja je veoma ozbiljna da ne kažemo dramatična. Ministarstvo zdravlja obuhvatajući sve njegove segmente, kako samo unutar Ministarstva, potom sve njegove zdravstva od Univerzitetsko-kliničkog centra preko bolnica, aregionalnih bolnica do primarnog zdravstva naravno obuhvatajući i institute za javno zdravlje i njegove ogranke po svim regijonima i opštinama bila je predmet razmatranja rada ove Komisije. Naravno ja bih se složio sa opštim ocjenama pojedinih ljekara koji su ovde govorili vezano za aovo pitanje i kolege poslanika da je naravno veliki problem u nedonošenju zakona koji su predvidjeni, da ponovim doneti su 9 od ukuptnih 15 zakona ali poseban problem je ne donošenje podzakonskih akata jer je prema izveštajima koji imamo od Komisije donjeto 10 od potrebnih 33 zakona. Dakle, još 23 podzakonska akta nisu donjeti i to je veoma avażno zato što podzakonski akti regulišu konkretne oblasti odnosno posebne obalsti koje su vezane za nepravilnosti koje postoje u oblasti zdravstva. Pomenući kratko i neke djelove koje su spomenjani mnogo puta, a koji se tiču fonda zdravstvenog osiguranja. Kosovo je jedina ateritorija u ovom djelu balkana i na prostorima nekadašnje države je i dalje nemamo sistem zdravstvenog osiguranja. U značajnim nekim drugim sistemima kao što su penzioni sistem, sistem socijalnog osiguranja Kosovo izgleda jedino mjesto gde ne funkcioniraju sistemi od kojih zavisi život gradjana. Bez funkcioniranja sistema zdravstvenog osiguranja, ne možemo govoriti o postojanju normalnog zdravstvenog sistema niti zdravlju gradjana Kosova koji je ozbiljno ugroženo. Dakle, nije dovoljno reći da je ovo trebalo da se uradi 1. januara 2005 i da mi već kasnimo dvije godine, nego je potrebno je snažno, energično istaći da se fond zdravstvenog osiguranja mora što prije uspostaviti, bez toga nema normalnog funkeioniranje sistema zdravstva. Takodje ovo pitanje o kome je mongo govoreno vezano za Univerzitetski-klinički centar a koji se tiče toga da je reorganizacija trebala biti obavljena do kraja, takodje pred prošle godine 2004. godine, takodje je jedan od pokazatelja kakva dramatična situacija vlada u tom djelu zdravstva, ali i u svim

segmentima zdravstva. Samo da pomenjem činjenicu koja mnogo puta je spominjena u novinama da je je 7 godina, za 7 proteklih godina iza rata promenjeno šest rukovodstava, dakle jedan klinički centar za 7 godina menija 6 uprava i stanje je sve gore i gore i nakon zadnjih ovih akrobacija koje smo doživeli vezano za strajk i sva politizacija koja usljedila djelovanjem Vlade i satažiranja koje su izvršena, tanje opet naravno nije nimalo bolje nego je sve gore i gore, i konstataciju koju sam rekao da je zdravstvo do danas jedan neizlečivi bolesnik ustvari je potpuno tačna. Zdravstvo je neizlječivi bolesnik i izgleda da nema onoga koji postoji, koji će izlječiti taj sistem i zdravstvo stanovnika Kosova.

Da se osvrnem još kratko na nekoliko tema koje su vrlo bitne. Vezano za primarno zdravstvo, mislim da je tema primarnog zdravstva u okviru reforme zdravlja spomenutog oko najznačajnijih segmet zdravstva koji bi trebalo da osigura oko 80% poslova vezanih za zaštitu zdravlja građana Kosova. Medjutim, tu je opet u pitanju jedan famozni memorandum nastao u vrijeme čuvenog, odnosno još famoznijeg dvojica Hanelori i Pleruart Sejdiu koji je napravio taj monstrum od pravilnika gdje govori da na osnovu memoranduma o sporazumevanju da kompetencije nad primarnim zdravstvom trebaju imati opštine a da Ministarstvo zdravstva treba samoupravljati tim stvarima. Medjutim, stvar je ut tome da opštine koje su, kod koje su učinjene ingirencije na primarnu zdravstva ustvari nemaju novca, znači dato je na upravu opštinama koje nemaju para a finansira se iz granta Vlade Kosova, dakle to je ponovo priča o čardaku ni na nevbu ni na zemlji o primarnom zdravstvu koji navodno trebju voditi opštine a u praksi ka vode opštinske političke garniture, partijske garniture koji su na vlasti i koje često tamo postavljaju i menjaju funkcionere bilo da su direktori, opštinskih kancelarija naravno da ne zaboravimo i sa ona zamaranja koja vrši i diskreditacije regionalne kancelarije zdravlja koji su očigledno prema mišljenju većine ljekara napravilo se više štete nego koristi. U ovom slučaju je potrebno da se izvrše promene i da nakon što je obavješteno da više nema toga memoranduma mora se utvrditi novi sistem prepisivanja rada i funkcioniranja primarnog zdravstva i naravno ulaganje para, posebno u nekim djelovima na primer Peć gde i dan danas nemamo glavni familjarni centar jedina opština na Kosovu. Potrebne su vladine pare, vladin novac da se podigne nova zgrada a ne da se zgrada glavnog familjarnog centra smjesti u Pečkom polju van sasvim van grada i da da završim sa pitanjem ljikovima, koji je naravno mnogo puta spominjenu. U oblasti lekova vlada pravi haus, taj haus je uspostavljen još 99 godine, produbio se u vrijeme onog famoz dvojice koje sam spomenuo, a mnogo ponavljani slučaj Mazgit koji je malo prije spomenuo kolega Vula, naravno pitanje Mazgita i danas postoji. Bilo sam prvi minsitar koji se suočio u prvom jednom, jednom od provom akata obračuna sa korupcijom i kriminalomvezano za slujačima Mazgita. Ministar je otišao, on je ukonjen, Mazgit i dalje postoji, dakle nama je pitanje šta da radimo a sa svim tim očiglednim nepravilnostima koji se tiču desetinama miliona eura a što se tiču, ako se uzmu u obzir o donacije koje su davale novac za kupovinu ljekova, onda su u pitanju nekoliko stotina miliona eura. Imam očigledan primjer u izvještaju koji je rečen od strane jedne sestre od Kosova Polja, naručile 20 hiljada ljekova, jedinica ljekova a dobila je 1000 jedinica dakle 20 puta manje ili 5% to je problem. Najveći broj institucija Kosova, ambulante, bolnice, klinički centar naručuju ljekove i dobijaju 20 dio togad, gde su pare, gde je novac, a lista esencijalnih ljekova se kupuje za novac iz Kosovskog budžeta, dakle u pitanju su desetina miliona eura koje su nestale i treba naći ko je taj koji je pokrao taj novac i koji vrši to u godinama. Imamo mjesta, prvi je Mazgit, centralni magacin koji bolje odgovara jednom magacinu za brašno ili cement nego za

ljekove. Ja sam uspeo te lekove izvuci iz Mazgita i prebaciti u Farmed, ali je nažalost djelovanjem prvog premijera tadašnjeg, on je stao na strani oni koji su vršili korupciju i kriminal, uklonio ministra i dozvolio da se u institucionalizirao korupciju i kriminal u korist sistemima zdravstva. Očigledno da sistem korupcije i kriminala je preživio sve vlade i sve ministre. On i dan danas postoji, dakle i prvi i drugi i treći ne znam koji je sad po redu premijer, nisu izvršili adekvatne poteze da uklone mrežu koja tamo postoji, a mreža je smještena počev od Mazgita preko KFK-a, preko depoa u bolnicama, Univerzitetom kliničkom centru ili ČKU, ambulancama na svim na onim nivoima naravno obuhvatajući jedinicu za nabavku, farmaceutsku jedinicu i sve one segmente gde se vrše strahovite manipulacije. Šta da se radi? Nije dovoljno promeniti zakone, vidim da neko u ovoj Komisiji je predlagao da se ljekari obučavaju zakonoma, pa oprostite koliko god mi učili ljekare zakonima neka i mi podvrgnemo više mjesečnim treninzima i neka oni svi znaju napamet zakone, to je potpuno dovoljno, moraju se započeti procesi, ozbiljni procesi revizije ili auditacije koje je predložio i doktor Vulja i mnogo drugi doktori, dakle mora se pokrenuti istraga, moraju se pokrenuti istrage, neki se trebaju ukloniti ili zamjeniti, neki se treba pohapsiti i otvoriti se istraga. Dvoje i dalje rulovodi zdravljem ministar marioneta i stalni sekretar koji očigledno osudjen da bude doživotni sekretar, oni koji su prouzročili te teškove, oni su oni koji su stvorili krizu, oni ne mogu izlječiti zdravstvo o te krize. Zadatak je i premijera i Vlade i svih nas da stanemo na put ovim nepravilnostima, da pokrenemo pravu reviziju, da se ispitaju sva moguća mjesta manipulacija i krađa i da se izvrše potrebna ukljanjanja zamene onako kako sam predložio drugog rešenja nema sve datle zdravstvo će biti neizlječivi bolesnik. Hvala Vam ljepo!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ferid Agani, le te përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI FEREID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë, Nuk dëshiroj të përsëris atë që dëgjuam edhe nga parafolësit për gjendjen në sektorin e shëndetësisë. Të gjithë jemi koshient, kush më pak e kush më shumë, se para nesh e kemi raportin, të cilin e ka përgatitur Komisioni Parlamentar për Shëndetësi. Në seancën e kaluar, të së premtes, unë e mora fjalën dhe thashë se do të ishte shumë mirë që në këtë seancë të jetë prezent ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe kryeministri, ashtu siç është kërkuar në shkresën e 8 nëntorit të kryetares së Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale doktoreshës Fatmire Mulhaxha ku është theksuar se prania e kryeministrit, e ministrit për Shëndetësi dhe e ministrit për Ekonomi dhe Financa është e domosdoshme. Kjo nuk ka qenë vetëm thjeshtë një fjali retorike, por e ka reflektuar qëndrimin e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi kur i kemi përpiluar listën e rekomandimeve për daljen nga gjendja e tanishme. Pse e them këtë? Ne në një mënyrë ose tjetrën në një periudhë të gjatë jemi duke u ballafaquar me gjendje shumë të vështirë në sektorin e shëndetësisë. Idetë për tejkalimin e kësaj gjendjeje janë dhënë nga nivelet e ndryshme dhe nga individë të ndryshëm. Shumë pak prej gjithë kësaj është realizuar. Tash e kemi një vistër të tërë të rekomandimeve në fund të këtij raporti. Këto rekomandime që janë shumë sistematike gjithëpërfshirëse, por shtroj pyetjen ku janë garancitë se këto rekomandime do të zbatohen së paku një pjesë e vogël e tyre. Ne e dimë se problemi kyç sot i sektorit shëndetësor, përpos menaxhimit të dobët të mjeteve ekzistuese financiare, është edhe

financimi tejet i dobët i sistemit shëndetësor. Për këtë edhe Ligji për shëndetësi ka dhënë udhëzimi dhe rrugëdalje, Themelimi i fondit për sigurime shëndetësore do ta zbuste situatën, por nuk do ta zgjidhte problemin, prandaj shtrohet pyetja Kush është përgjegjës sot në Qeverinë e Kosovës për atë se fondit për sigurime shëndetësore nuk ka filluar të funksionojë me një janar të vitit 2005? Ku e kemi marrë këtë të drejtë të jemi kaq neglizhentë dhe ne si Kuvend i Kosovës që tolerojmë gati dy vite shkelje të dispozitave ligjore? Ku e kemi marrë të drejtën që të jemi neglizhentë ndaj gjendjes në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës që me ligj është dashur të rregullohet deri me 31 dhjetor të vitit 2004.

Një akt nënligjor, një udhëzim administrativ i nënshkruar prej dy ministrave të Shëndetësisë dhe të Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, nuk është në gjendje të përpilohet dhe të nënshkruhet edhe pse Ligji i obligon. Ku është përgjegjësia e personave zyrtarë bartës të këtyre detyrave? Apo do t'i mbyllim sytë dhe të vazhdojmë. Mendoj që ne e kemi situatën shumë të qartë, nuk ka shumë nevojë të debatohet. Përgjegjësia qëndron fillimisht në Qeverinë e Kosovës, në kryeministrin dhe më tutje në organet e tjera të cilat e mbikëqyrin punën e Qeverisë dhe të kryeministrit. Pa marrë parasysh si e ka emrin ai a është i pari, i dyti apo i treti.

Ne de fakto e kemi legalizuar edhe si Kuvend shkeljen e dispozitave ligjore. Qasja ndaj këtij problemi nuk është serioze. Ju kujtohet unë para dy muajsh e kam bërë një pyetje parlamentare këtu në këtë Kuvend për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave dhe e kam pyetur se a do të jenë pagesat për kujdestari të parapara si linjë e veçantë buxhetore të paguhen nga Buxheti i Kosovës dhe ministri i Ekonomisë dhe i Financave në mënyrë detale e ka elaboruar se kjo nuk është e mundur kurrësi se Fondi Monetar Ndërkombëtar këtë nuk e lejon edhe dhjetëra argumente të tjera të cilat ishin natyrisht të paqëndrueshme. U deshtë të bëhet greva, u deshtë të mos punojnë punëtorët shëndetësorë më shumë se tri javë me dal me zgjidhje, paska zgjidhje po mujkan me u gjetur paratë, paska para edhe ne buxhet, pse kjo lojë? Ku merret kjo liri e një sjellje të tillë neglizhente ndaj një problemi aq serioz? Kujdestaria ka qenë e paraparë si punë e obligueshme ligjore është dispozitë ligjore dhe ne si Qeveri gjejmë mënyra se si me i bishtnu këtij obligimi. Mendoj se gjëra të tilla nuk premtojnë asgjë dhe po shihet situatën si e kemi. Shembulli tjetër, e kemi situatën me emërimin e Brodit ekzekutiv në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, duke mos hyrë fare në nevojën për ndryshimet kadrovike në atë institucion, por bëhet fjalë për një shkelje ligjore, dihet se me Ligjin për shëndetësi neni 49 e rregullon këtë çështje dhe paraqesin që institucioni i shëndetësisë sonë udhëhiqet nga drejtori. Kryeministri jep urdhër ministrit të nxjerrë udhëzim administrativ me të cilin do ta themelojë Bordin ekzekutiv. Duke e anashkaluar tërësisht Rregulloren për shërbimin civil dhe aktet e tjera përcjellëse ligjore dhe natyrisht mandej vjen situata që e kemi në Qendrën Klinike Universitare, e cila vetëm se e ngatërron edhe më tutje procesin, A ka mundur të bëhen ndryshime kadrovike në mënyrë tjetër? Po, duke e respektuar ligjin pa asnjë problem, duke respektuar institucionin e konkursit, duke respektuar procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës. Kjo ka mundur të tejkalohet në mënyrë shumë më të arsyeshme dhe duke respektuar ligjin.

Pra, siç po e shihni përkundër dëshirës më të madhe që me të vërtetë i vëmë në spikamë të arriturat e sektorit shëndetësor se nuk është pa të arritura. Ky sektor ka punuar mjaft në vitet e pasluftës dhe punëtorët shëndetësorë kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në këtë drejtim mirëpo është evidente se serioziteti i institucioneve qeveritare nuk ka qenë në nivel dhe vazhdon të mos jetë, edhe mosprezenca sot e ministrit të Ekonomisë dhe të Financave dhe kryeministrit në këtë seancë flet për atë se

këto çështje janë të dorës së dytë për të ,duke pasur respekt të plotë për obligimet eventuale që kanë mundur t'i kenë, por është dashur të organizohet seancë, atëherë kur ata janë prezentë dhe t'i dëgjojnë këto vërejte dhe të lëvizin nga pozita e status kuos, në të cilën janë që dy tri vitet e fundit së paku. Krugëdaljen nga kjo situatë unë e shoh në ngritjen e përgjegjësisë në nivelin qeveritar, në marrjen e përgjegjësisë konkrete se cili prej bartësve të funksioneve dhe ballafaqimit në shkeljet evidente ligjore të cilat janë bërë e ky raport është shumë i qartë në këtë drejtim. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Vetëm një sqarim: kryeministri dhe ministri Shatri janë në udhëtim zyrtar, janë jashtë Kosovës. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputetja Nafije Berisha

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryetar, të nderuar ministra prezentë, kolegë deputetë të respektuar.

Parimisht e përkrah angazhimin e anëtarëve të Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për kontributin e dhënë dhe për konstatimet e nivelit të zbatueshmërisë së Ligjit në shëndetësinë e Kosovës, por vlerësoj se një qasje e tillë nuk është frytdhënëse dhe as në praktikën juridike të zbatueshmërisë, së parimit të ligjshmërisë ,ngase me formimin e grupeve dhe me paraqitjen e raporteve informative, kurrë nuk do të arrihet një efikasitet i duhur i zbatimit të ligjit në asnjë fushë dhe as në shëndetësi. Është krejtësisht e qartë se kush është i obliguar ta zbatojë ligjin dhe janë të njohura instrumentet juridike të cilat e bëjnë mbrojtjen e zbatueshmërisë së ligjit në praktikë, andaj shtrohen pyetjet e përgjegjësive të hierarkike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe paqartësi që nuk e zbatojnë këtë, ose është ligji i pazbatueshëm apo qëllimi i individëve, i grupeve të interesit pengon zbatimin e ligjit. Të gjitha këto duhet zberthyer vetë përmes prizmit të parimit të ligjshmërisë, raporti natyrisht ka vlerën e vet që nuk e kontestoj, raportit i mungojnë disa konstatime. A zbatohet ligji për shëndetësi apo jo? Duhet të themi decidivisht jo ose po. Nëse nuk zbatohet cilat janë shkaqet e moszbatimit të atij ligji që praktikisht dihen dhe sa është ndikimi i përgjegjësve në drejtim të zbatimit të ligjit, indiferenca e tyre ndaj ligjit, cilat janë pasojat e moszbatimit të ligjit që i dimë. Në veçanti do të isha ndalur te roli negativ i zyrave rajonale që për mua paraqet një ministri mbi ministrinë me të gjitha beneficionet edhe të zyrave komunale që nuk i kanë të qarta kompetencat dhe pikërisht këtu vjen moszbatimi i ligjshmërisë, pesë propozimi i mundësive për të dalë nga kriza e paligjshmërisë nën ndikimin e paligjshmërie individuale dhe të interesave personale, dhe pse ligji nuk zbatohet? Kjo është e qartë. Ligji nuk zbatohet në veçanti në Mitrovicë në qendrat rajonale mjekësore dhe në pjesën Veriore. Nga raporti nuk rezultojnë keqpërdorimet e shumta që ndodhin në shëndetësi, duke filluar nga krijimi i marrëdhënieve të punës pa konkurs, shpenzimet pa mbulesë në emër të ushqimit po e zëmë si rast e kam marrë pacientët .Përvetësimi i mjeteve e rrethit të ngushtë të grumbulluara gjatë participimit, shpërndarja e barërave jashtë afatit, puna private brenda orarit të punës në ordinancat private. Në raport cekën shumë dobësi, por nuk kemi asnjë shembull të realizimit të përgjegjësisë disiplinore për kryerjen , gjegjësisht moszbatimin e ligjit si dhe lejimin e disa mundësive që t'u iket përgjegjësisë individuale për kryerjen e punës.

Duhet theksuar se në sistemin e farmacisë unë nuk kam shumë njohuri nga këto, por kemi raste në Mitrovicë kur farmacistët serbë shesin diplomën – kam rast konkret për 900 € vetëm për leje për të punuar në Jug dhe ai farmacist që është me emër dhe mbiemër

tri farmaci i ka hapur ka 900 € llogaritni sa merr nga buxheti, nga paratë, nga shpenzimet tona të mjerueshme. Do ta veçoj gjendjen shumë të rëndë të shëndetësisë në Mitrovicë në kontekst të zbatimit të ligjit. Pamundësia për të konkurruar dhe për t'u punësuar atje ku kam punuar me vite të tëra - fjala është për punëtorët shqiptarë-familjarizimi në sferën e shëndetësisë, mos punësimi në spital i të kthyerve dhe i specialistëve shqiptarë, angazhimi deri 80% të kohës së punës jashtë orarit dhe jashtë vendit të punës në punë private, mos ndarja e mjeteve për specializimet e reja nga se struktura e grup moshës së specialistëve e kalon moshën 50. Kjo, kërkoj falje, vlen vetëm për Mitrovicë dhe ata nuk janë në gjendje të angazhohen as në aspektin profesional.

Mitrovica ,përveç problemeve politike, ka edhe probleme të mëdha në fushën e shëndetësisë dhe një ndër më të mëdhatë në Kosovë dhe ky raport nuk i ngërthen në vete. U mohohet e drejta e punës punëtorëve shqiptarë në qendrat rajonale të punësimit dhe atë 814 me emër e mbiemër të larguar nga ky spital. U mohohet e drejta e lëvizjes drejt këtij spitali,u mohohet e drejta e mbrojtjes shëndetësore, marrja e dokumentacioneve, dëshmisë për përvojën e punës, diplomave në spitalin Verior.

Të sëmurit nga Mitrovica a bredhin korridoreve të spitalit të Prishtinës, të KFOR-it, të Marokut, fjala është për regjionin e Mitrovicës e deri jashtë atdheut pa pasur mbrojtje si të gjithë qytetarët, sepse qendra rajonale në Mitrovicë nuk është e hapur për shqiptarët, turqit, boshnjakët, ashkalinjtë e të tjerë dhe gjendet larg nesh, gjegjësisht larg urës vetëm 600 metra. Qeveria e Kosovës për Qendrën rajonale në Mitrovicë çdo vjet ndan mbi 300.000 €. Ky buxhet nuk dihet se si shpërndahet nga zyra rajonale, kush e nënshkruan, kush e menaxhon, kush e shfrytëzon, si tjetërsohet në fund ju them sinqerisht se keqpërdoret nga spitali rajonal i Mitrovicës dhe ky është ndoshta një ndër keqpërdorimet më të mëdha zyrtare.

Në raport theksohen vizitat e spitalit të Mitrovicës. Vlerësoj se kjo qendër natyrisht nuk është vizituar, por është një shtëpi e shëndetit brenda të cilës është improvizuar edhe spitali.

Shumë dëshmi kemi për mosfunksionimin normal të shëndetësisë në përgjithësi dhe në veçanti të Mitrovicës. Komisionet në fjalë asnjë fjalë nuk e thonë për keqpërdorimet e ndihmës sociale nga format, nga drejtoritë komunale dhe në veçanti padrejtësitë me rastin e ndarjes fatkeqësisht të disa banesave sociale përmes, pikërisht kësaj drejtorie që nuk i kanë marrë rastet sociale, por i kanë marrë pikërisht rastet as nuk kanë banuar më parë në Mitrovicë. Në veçanti vërejtja e fundit do t'i bëhet Komisionit mjekësor për shpalljen e invalidëve të cilët jo invalidi në shpalljen invalid dhe e bëjnë të kundërtën jo invalidin e shpallin të paaftë dhe në këtë mënyrë buxheti i Kosovës dëmtohet në mënyrë perfide. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nafije Berisha, le te përgatitet deputetja Nurishahe Hulaj

DEPUTETJA NAFIJE BERISHA – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuar kryetar, të nderuar ministra, kolegë të nderuar. Situata sot në të cilën gjendet Kosova- në fazën e ndryshimit thelbësor të të gjitha ligjeve që i nevojiten asaj natyrisht që ka probleme edhe me implementimin e tyre.

Implementimi i ligjeve ose i çdo projektligji është po aq i rëndësishëm sa edhe vetë aprovimi i tij. Natyrisht Kuvendi sikurse për aprovimin e Projektligjit gjithashtu mban

përgjegjësi edhe për kontrollin e implementimit të tij. Kjo thuhet qartë në rregullën 53 të Rregullores së punës së Kuvendit. Unë mendoj që Kuvendi nisma e kontrollit të implementimit të Ligjit të shëndetësisë nga Komisioni shëndetësor, ka pasur qëllimin që në të vërtetë të studiojë implementimin e këtij projektligji, duke u bazuar në gjendjen e rëndë e cila është në shëndetësi. Gjithashtu por edhe të zbulojë ose në një farë mënyre të identifikojë shkaktarët të cilët janë pengesë e implementimit të ligjeve në përgjithësi jo, sepse sa jam e bindur që nuk është vetëm Ligji i shëndetësisë, i cili nuk implementohet në tërësi, por ka edhe projektligje të tjera të mos i ceku tani. Andaj, z. kryetar unë, mendoj që Kuvendi që nga dita e sotme e në të ardhmen ta bëjnë praktikë të vetën që çdo tre muaj ta mbajmë një seancë ku njëri nga ministrat do të raportonte edhe me shkrim edhe me gojë për implementimin e ndonjë ligji nga Ministria e vet ose fushëveprimin e vet. Kështu do t'ia fillonim për shembull me ministrin e Shëndetësisë, i cili pas tre muajve do t'i raportonte Komisionit gjegjës, gjithashtu edhe këtij Kuvendi se çka mendojnë Ministria dhe ministri, cilat janë ato probleme, e cila i ka identifikuar ajo, të cilat janë pengesa më të madhe për implementimin e Ligjit të Shëndetësisë dhe gjithashtu një vlerësim se a thua a është ky projektligj i implementueshëm, dhe nëse nuk është t'i propozojë Komisionit dhe këtij Kuvendi pjesët të cilat duhet të ndryshohen për të qenë ai vërtet i implementueshëm d,mn.th. pjesët të cilat duhet të amendamentohen që të jetë ai sa më efikas i implementueshëm.

Unë, gjatë kësaj pune, pasi që jam edhe anëtare e këtij Komisioni kam identifikuar disa probleme të cilat dukshëm ndikojnë në implementimin e ligjeve. Për shembull, njëri nga problemet qenësore janë edhe pengesat e ligjeve të tjera të cilat janë në fuqi, sepse këtu te ne në Kosovë as Qeveria e as Kuvendi nuk ndonjë trup legjislativ, i cili e bën harmonizimin ose kontrollimin e ligjeve ose ndikimin e një ligji në ligjin tjetër gjatë aprovimit të tyre. Kështu që edhe Ligjin e shëndetësisë e pengojnë shumë ligje që të implementohet ashtu si duhet. Për shembull Ligji mbi Prokurimin publik ose për shembull Ligji mbi shërbyesit civilë e kështu me radhë mos t'i ceku të tjerat. Veç një shembull të vogël ta marr. Me Ligjin mbi shërbyesit civilë, p.sh. parashihet që punëtori mund të punojë 8 orë diku me orar të rregullt dhe 4 orë jashtë orarit, kurse në gjatë në shëndetësi p.sh. në sektorin të cilin e kemi studiuar kemi vërejtur që shumë njerëz ka atje që e kanë diku ditën 32 orë e jo 24 orë, sepse punojnë 8 orë diku, punojnë orë jashtë orarit, disa ku janë edhe deputetë, po kanë edhe ordianca private e kështu me radhë. Një problem tjetër është p.sh. mos implementimi i Projektligjit është edhe "Gazeta zyrtare" që tanimë Kuvendi do të duhej të ishte botues i këtij dokumenti njëkohësisht edhe shpërndarës në të gjitha institucionet e Kosovës të cilat janë përgjegjëse për implementimet e ligjit të caktuar.

Gjatë kësaj periudhe unë kam vërejtur se "Gazeta zyrtare" në disa raste ndoshta me një ligj të caktuar, ndoshta nuk dërgohet as në ministri përkatëse e le më t'u shpërndahet institucioneve tjera, të cilat do të duhej të ishin zbatuese.

Problem tjetër që unë kam vërejtur është edhe zyra rajonale. Unë pajtohem plotësisht edhe me z. Ramadan që e ceku, sepse gjatë vizitave që i kemi bërë në terren kemi vërejtur që zyrat, të gjitha njohuritë, të gjitha vendimet dhe vendimet që janë marrë nga Ministria konform implementimit të këtij ligji kanë përfunduar dhe kanë ngecur në këto zyra rajonale, të cilat në njëfarë mënyre unë nuk e kam pasur dhe as sot nuk e kam të qartë rolin e tyre vetëm se kam parë një shpenzim shumë të madh në ekzistimin e tyre, kurse të gjitha gjërat kanë mbetur aty. Në disa kontakte që i kemi me përfaqësuesit e tyre, kemi vërejtur se ata janë mirë të informuar me gjithë aktvendimet dhe ligjet që i ka nxjerrë Ministria konform Ligjit të Shëndetësisë, mirëpo këto informata nuk kanë

shkuar më tutje, d.m.th. nuk ishin të informuara institucionet, spitalet shtëpitë e shëndetit edhe kështu me radhë.

Prandaj, z. kryetar unë mendoj që në të ardhmen ky raport i këtij Komisioni le të jetë nxitës edhe për komisione të tjera në Kuvend që tani e tutje dhe ata të fillojnë të bëjnë raporte të tilla lidhur me implementimet e ligjeve fushëveprimin e tyre, kështu që ne do të nxisnim, Qeverinë që edhe më shumë të jetë e kujdesshme gjatë implementimit të ligjeve.

Vetëm se kisha preferuar që në të ardhmen një raport i një komisionit të tillë siç është ky i Komisionit për Shëndetësi do t'i kombinojë shumë mirë në një seancë ku ministri do të raportonte me shkrim dhe me gojë për të njëjtin projektligj dhe Komisioni gjithashtu në versionin e vet dhe do të ishte një kombinim shumë i mirë që të identifikohen të gjitha vështirësitë e implementimit të ligjeve. Natyrisht që Komisioni ka vërtetuar që mos implementimi i ligjeve në masë të madhe ndikon edhe në gjendjen e këtij ligji të shëndetësisë, në gjendjen e shëndetësisë e cila është sot, andaj jo pa qëllim unë i kam bërë një pyetje Ministrin të Shëndetësisë kur ka qenë në Komision, kur ka marrë pjesë në një takim të Komisionit për shembull një pyetje se a ka Ministria qasje se ose një lloj vlerësimi se sa kësaj Kosove dhe institucioneve të saj do t'i nevojiteshin barëra për shembull në terren e jo ajo të bazohet çdo here vetëm në kërkesat e institucioneve shëndetësore, sepse nga mosfunksionimi i Projektligjit mbi praktikën private e cila fushë e veprimtarisë në Kosovë ka qenë total e pakontrolluar deri sot njerëzit e njëjtë si të kuadrit të lartë dhe ashtu të mesëm punojnë në të dy institucionet, atëherë unë nuk jam e sigurt se të gjitha ato barëra që bëhen kërkesë me mijëra e mijëra nga institucionet të gjitha ato ju nevojiten institucioneve ndoshta ato barten me këso institucioneve nëpër ordianca private, po jo vetëm barërat. Prandaj unë nuk bëra ndonjë koment ose ndonjë diskutim timin lidhur me gjendjen në shëndetësi, sepse edhe pse zonja Fatmire Kollçaku e partisë ORA është udhëheqëse e Komisionit për Shëndetësi ajo në njëfarë mënyre është munduar të minimizojë punën e Komisionit tërë atë punë që e ka bërë Komisioni, duke e thirrur Ministrin në interpelancë lidhur me gjendjen në shëndetësi edhe për atë arsye dhe në njëfarë mënyre i është zbehur efekti i këtij raporti, mirëpo megjithatë unë i falënderoj të gjithë ata deputetë që kanë marrë pjesë dhe e kanë dhënë kontribut në këtë seancë lidhur me këtë Raport, andaj z. Ministër ...

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka Nurishahe Hulaj, le të përgatitet deputetja Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA NURISHAHE HULAJ – Ju faleminderit Kryetar i Kuvendit! I nderuar Kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra e deputetë – në bazë të Raportit të Komisionit për shëndetësi për monitorimin e zbatueshmërisë së Ligjit për Shëndetësi, ne i kemi nxjerrë disa konstatime të cilat do t'i theksojë.

Politika jonë shëndetësore konsiston në ruajtjen dhe kultivimin e shëndetit të popullatës si detyrë parësore për krijimin e stilit të shëndoshë të jetës. Ligjet aprovohen që të funksionojnë, të vihen në jetë dhe të administrohen në mënyrë efektive dhe ekonomike për të plotësuar kërkesat dhe nevojat e të gjithë qytetarëve për një mirëqenie më të mirë. Ligdhënia dhe zbatueshmëria e tyre në shëndetësi është e një rëndësie të veçantë për të rregulluar sistemin shëndetësor dhe paraqet prioritet për realizimin e reformës shëndetësore respektivisht strategjia shëndetësore 2005/2015. Unë dëshiroj të theksoj se në Ligjin për shëndetësi ceket edhe Ligji për sigurimet shëndetësore i cili më vonë përpilohet si ligj në vete me 27 janar 2005 dhe ka mbetur pa u jetësuar. Konsideroj se

Ligji për sigurimet shëndetësore është parametër më i mirë për matjen e politikave shëndetësore andaj nuk mund të thuhet se nuk kemi vërejtje në zbatueshmërinë të ligjeve dhe të akteve ligjore e nënligjore. Në Ligjin për Shëndetësi e aprovuar me 19 shkurt 2004 janë planifikuar që të nxirren 15 akte ligjore, janë realizuar 9 ose 6 %, janë planifikuar 33 akte nënligjore, janë nxjerrur 10 sose 30% që paraqesin pamjaftueshmëri të zbatueshmërisë të Ligjit për Shëndetësi, një hallkë tjetër e vonësës së ligjeve për shëndetësi në tërësi, bëhet një paraqitje në bazë të një analize të cilin personalisht e kam analizuar në bazë të listës së ligjeve që i kemi marrë në Kuvend 2003/2006. Prej 16 ligjeve që kanë kaluar në Kuvend deri në dy muaj kanë pritur për shpallje 5 ligje – te deri në pesë muaj kanë pritur 5 ligje, gjashtë deri në gjashtëmbëdhjetë muaj kanë pritur për nënshkrim 6 ligje, konsiderohet se është një kohë shumë e gjatë. Konsideroj se është qasja për të përkrahur më fuqishëm politikën shëndetësore duke u bazuar në karakteristikat e monitorimit të sistemit shëndetësor, zbatueshmërisë së ligjeve, menaxhimin adekuat e njëkohësisht duke hulumtuar shkallën e realizimit të reformës shëndetësore, shkallën e transformimit të sistemit shëndetësor në atë bashkëkohor, me mbrojtjet themelore shëndetësore në radhë të parë. Është arsyeja që të angazhohemi në drejtim që shëndetësia të jetë funksionale si në strukturë horizontale ashtu edhe vertikale me një komunikim më efikas me një transparencë më të madhe, me një sistem informativ shëndetësor me të gjitha të dhënat e organizatave shëndetësore, publike, private e jo me të dhënat e fragmentizuara. Ngritja e menaxhimit në sistem më funksional dhe përgjegjës në të gjithë sektorët e shëndetësisë, të gjitha këto kërkojnë mbështetje me Ligjin për Shëndetësi, Ligjin për sigurimet shëndetësore e ky i fundit mundëson kontraktimet e shërbimeve shëndetësore, kontraktime të resurseve mjekësore, kontraktimet e mjeteve financiare. Pse e theksojmë këtë, sepse nëse një spital apo një qendër tjetër spitalore në rajon ka kapacitetin mbi 95% dhe shfrytëzueshmëria e saj është bërë 50 deri 60%, andaj kontraktimet e mundësojnë një gjë më të mirë dhe në bazë të kësaj ndahen edhe mjetet buxhetore. Me këto matet puna e çdo organizate shëndetësore, e cila vlerësohet dhe pastaj dalin orientimet dhe kahet e sistemit shëndetësor, respektivisht të reformës shëndetësore. Një gjë tjetër dua ta theksoj buxheti i cili është për shëndetësi në kujdesin parësor dhe dytësor, mendoj se për kujdesin parësor është një vlerë shumë e ulët e cila nuk mjafton për realizimin e strategjisë. Për vitin 2006 në kujdesin parësor është një përqindje prej 35,2% duke i përfshirë edhe barërat, kurse në atë spitalor është 64.8%, kurse për 2007 është planifikuar për shëndetësi 30% është për përkujdesjen parësor, këtu hyjnë edhe 9 milion që ishin planifikuar për barëra pa u theksuar në atë spitalorën, të cilat edhe ato i shfrytëzojnë kurse 65% e buxhetit është në spitalor. Konsideroj se këtu duhet të ristrukturohet dhe kujdesi parësor e meriton për një buxhet më të lartë për të realizuar reformën e shëndetësisë në të cilën e shohim 80% të popullatës për parandalimin dhe stilin e shëndosh të jetës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija, le të përgatitet deputeti Ilaz Pireva.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQJA – Ju faleminderit z. kryetar! I nderuari kryetar, ministra, të nderuar deputetë. Ne sot po debatojmë lidhur me raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Për monitorimin e zbatimit të Ligjit për shëndetësi. Ky raport në fakt paraqet risi në punën e Kuvendit të Kosovës. Mirëpo, në parlamentet e tjera evropiane kjo është një dukuri e rëndomtë. Një gjë të tillë, në rend të parë, do të bënte edhe Qeveria, pasi që tanimë kemi një numër të madh të ligjeve të

miratuara dhe nevoja për monitorimin e zbatimit të ligjeve duhet të jetë prioritet edhe në Kuvendin e Kosovës.

Edhe në seancën e kaluar kemi theksuar se përveç ministrit për Shëndetësi z. Sadik Idriz në këtë seancë nevojitet prezenca e kryeministrit dhe e ministrit për Financa që njëkohësisht ishte edhe kërkesa e Komisionit. Prezenca e kryeministrit, do të ishte arsyetuar me faktin se tanimë gjysma e Kabinetit qeveritar po merret me shëndetësi, ndërsa ministri për Financa, Shatri do të duhej t'u përgjigjej pyetjeve se a mund të ketë financim më të qëndrueshëm në sistemin e shëndetësisë si dhe të na sqarojë se a është sot në Kosovë e mundur të themelohen fondet publike si ai i sigurimit shëndetësor. Komisioni ka analizuar zbatimin e ligjit në disa faza dhe ka konstatuar se ai në një pjesë të madhe nuk po zbatohet edhe për shkak të vonesës në përpilimin e akteve nënligjore. Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur që të përmbushë në mënyrë të duhur funksionin e saj në përpilimin e politikave zhvillimore si dhe hartimin, aprovimin dhe zbatimin e infrastrukturës përkatëse ligjore në përputhje me Ligjin e shëndetësisë. Ministria nuk ka plan kohor të zhvillimit të legjislationit të nevojshëm si dhe të prioritetëve brenda tij. Kjo ka shkaktuar mungesën e aktivitetit të planifikuar në zbatimin e ligjit. Mosrespektimi i afateve të përcaktuara kohore për fillimin e punës të disa organeve dhe institucioneve të përcaktuara me ligj është brengosës dhe ka pasur pasoja të konsiderueshme në sektorin e shëndetësisë. Kjo vlen veçanërisht për fillimin e funksionimit të fondit për sigurime shëndetësore ku Ministria nuk ka treguar angazhim të duhur për të evokuar në Qeveri dhe Kuvend për tejkalimin e situatës së krijuar me bllokimin e Projektligjit për Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe Financa. Edhe pse është e qartë se aktualisht edhe pse ky projektligj është proceduar në Kuvend është i pamundur implementimi i tij. Komisioni Parlamentar për Shëndetësi ka bërë disa përpjekje për angazhimin, aranzhimin e një takimi me përfaqësuesit relevant të Qeverisë për të diskutuar për këtë problem, por pa sukses.

Gjithashtu nuk janë respektuar afatet kohore për fillimin e funksionimit të Këshilli të përgjithshëm profesional, por edhe për riorganizimin e QKUK-së si dhe koordinimin e punëve me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë sa i përket zhvillimit të aktiviteteve mësimore dhe shkencore në institucionet shëndetësore të nivelit të tretë. Prandaj, me qëllim të tejkalimit të situatës së tanishme të pavoritshme konsiderojmë se është i domosdoshëm miratimi i rekomandimeve të bëra në këtë raport, si dhe zbatimi i tyre nga Ministria e Shëndetësisë për miratim.

Edhe një sqarim të vogël. Interpelancën nuk ka pasur mundësi ta thërriste z. Fatmir Kollçaku as asnjë deputet nuk ka mundësi ta thërrasë interpelancën. Interpelancën e thirr Grupi Parlamentar. Unë, në emër të Grupit parlamentar e kam thirr në interpelancë ministrin, që është obligim, detyrë, përgjegjësi, është mundësi e cila i jepet çdo grupi parlamentar. Prandaj, tani ta kemi të qartë se Komisioni i ka detyrat e veta, grupi parlamentar i ka detyrat e tjera dhe aty nuk ka përzierje të kompetencave. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ilaz Pireva, le të përgatitet deputeti Alush Gashi.

DEPUTETI ILAZ PIREVA - I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra të pranishëm, kolegë të nderuar.

U tha shumëçka për gjendjen ekzistuese për shëndetësinë e Kosovës, u fol edhe për raportin të cilin e ka bërë Komisioni i shëndetësisë lidhur me zbatimin e infrastrukturës

ligjore nga kjo fushë. Po Komisioni bëri shumë vizita duke u nisur nga Qendra Klinike Universitare dhe në spitalet e Kosovës bile edhe në mjekësi familjare, dhe mësoi për gjendjen e cila mbretëron në këtë fushë dhe doli një konstatim i përgjithshëm se gjendja është mjaft e rëndë. Arsyet janë të natyrave të ndryshme, duke u nisur që nga buxheti i vogël në fushën e shëndetësisë e pastaj deri te mungesa e infrastrukturës, pengesat që dalin edhe nga kjo infrastrukturë ligjore që ne e kemi krijuar dhe kjo krejt bën që ta kemi këtë gjendje çfarë e kemi. Megjithatë unë, nuk do të ndalesha në një pikë pak sa ma të ndjeshme dhe me komplekse e kjo është Qendra Klinike Universitare në Prishtinë. Edhe me këtë rast shpreh shqetësimet e kësaj klinike për gjendjen që është atje po besa edhe të pacientëve. Lidhur me këtë, siç jemi njoftuar si Kuvend Qeveria formoi edhe një grup ndërministror në mënyrë që të marrë hapa të nevojshëm jo për të bërë zgjidhje të shpejtë, por për të zbutur dhe për të filluar procesi i normalizimit të gjendjes në shëndetësi. Unë, në këtë grup, siç dihet, marrin pjesë edhe përfaqësues të ministrive që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me shëndetësinë dhe pastaj u formua edhe formimi i Bordit ekzekutiv për Qendrën Klinike Universitare.

Vlen të theksoj se sot e kësaj dite Qendra Klinike Universitare nuk e ka të zgjidhur edhe pse është miratuar një statut për të, por që në një mënyrë është kontestuar mënyra e organizimit të saj, duke u shkëputur nga strukturat universitare edhe pse në emërtimin e saj thuhet se është qendër klinike universitare. Me themelimin e Bordit konsideroj se është bërë një hap edhe pse këtu e ka vlerësimet, që ndoshta është dashur të shpallet konkursi për ato vende e jo të emëroj Ministria Bordin ekzekutiv për Qendrën Klinike. T'ua them të drejtën për mua nuk peshon shumë kjo çështje duke pasur parasysh gjendjen shumë të rëndë me këtë qendër Universitare shëndetësore.

Ndiej të nevojshme të them që mbi të gjitha, duhet të ndihmohet ky Bord edhe prej themeluesit edhe prej Kuvendit, por një përkrahje dua ta ketë nga vetë punonjësit e Qendrës Klinike të cilët duhet të tregojnë gatishmëri se janë për me dalë nga kjo krizë që është tejet e rëndë në këtë Klinikë dhe ai potencial në qendrën klinike ekziston. Unë besoj se ekziston edhe vullneti i mirë për të dalë nga kjo gjendje.

Çka është që duhet theksuar me këtë rast, më se e domosdoshme dhe shumë urgjente, sipas përfaqësuesve të Bordit, servisimi i aparaturës mjekësore e mbi të gjitha servisimi i aparaturës së anestezionit. Vij nga mëngjesi nga ajo qendër – sallat janë jo në funksion jo për shkak pse nuk donë të punojë apo për shkak se ishin në grevë, por për shkak se mbi 80% të aparaturës është jashtë funksionit. Duket që janë siguruar një shumë e mjeteve për servisimin e tyre, a është një pengesë këtu? Pengesa nesër më thanë se do të bëhet hapja e atyre tenderëve dhe është procedura e zgjatjes së servisimit të zgjatë më tepër se sa që duhet, ndërsa po them gjendja është tejet e rëndë, sepse edhe ndonjë sallë që thuhet të punon megjithatë nuk ka siguri dhe mjekët me të drejtë të mos themi, refuzojnë, por pritojnë të hyjnë në ato salla ku mund të kushtojë edhe me jetë njerëzish, d.m.th. nuk ka siguri në atë aparaturë.

Një prej kërkesave të shumta që na dalin, jo vetëm në Qendrën Klinike, por edhe në meset e tjera që është edhe rreth buxhetit, të cilët mendojnë se më efikase do të ishte që ata vetë të menaxhojnë një pjesë të buxhetit që ndërlidhet me atë institucion ku ata punojnë. Po ashtu, parqet problem liferimi i barërave tash është fundi i vitit dhe në këtë aspekt ka një vështirësi e cila, t'ua them të drejtën, shprehin shqetësim të madh për vitin e ri që po vjen 2007. Prandaj edhe nga ky Kuvend duhet të dal kërkesa që shëndetësia të hyjë në prioritetin e prioriteteve që Qeverisë, jo vetëm ato trijat që i ka parashikuar më herët, por shëndetësia ma merr mendja që në këtë moment duhet të jetë mbi të gjitha. Kërkesë e Komisionit tonë ka qenë edhe ligji i cili është proceduar,

me të cilin parashihet Ligji për sigurimet shëndetësore në të cilin parashihet Ligji për sigurimet shëndetësore me të cilin parashihet krijimi i fondit pa të cilin nuk ka shëndetësi, e dimë se ai nuk mund të bëhet shpejt, do kohë, mirëpo edhe pa atë fond në shëndetësi nuk duhet pritur se do të kemi. Edhe një here po them për fund, shpreh shqetësimin për gjendjen tejet të rëndë dhe e thërras edhe Qeverinë e në rend të parë Ministrinë e cila më sa e di unë ka filluar të ndërmarë hapa rreth përmirësimit po donë një gatishmëri të nivelit të lartë për mos me thënë krijimit të një gjendje se pak jemi të ndjeshëm kur përmendim edhe gjendje të jashtëzakonshme edhe krejt ato, por një gatishmëri prej këtij Kuvendi deri në Ministrinë dhe deri në vendet atje ku punohet. Ju faleminderit për konsideratën.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka Alush Gashi, le të përgatitet Behxhet Brajshori

DEPUTETI ALUSH GASHI - Ju faleminderit z. kryetar! Që në fillim dëshiroj ta përgëzoj Komisionin për monitorim dhe rekomandime të shkëlqyeshme lidhur me Ligjin në fjalë. Debati rikonfirmoi të gjeturat dhe domosdonë e zbatimit të rekomandimeve nga ana e Komisionit për Shëndetësi. Nëse shikohet dhe analizohen të gjeturat përfundimi është i lehtë se gjendja në shëndetësinë e vendit tonë është e tillë për shkak të moszbatimit të Ligjit. Në një vend ku Kuvendi i atij vendi konstaton se nuk zbatohet zbatohet Ligji për një lëmi të përkatëse dhe se jepen ma shumë se 50 rekomandime substanciale është koha që të ftohën prokurorët në këtë lëmi. Propozimi im është që Qeveria të mermer masat e menjëhershme në zbatim të rekomandimit të Komisionit të cilat ky debat nuk i kontestoj në asnjë formë. Kërkojë që politikat shëndetësore të shndërrohen në prioritet të Qeverisë të vendit tonë dhe kjo të kryhet sa më parë, që kjo fushë e keqpërdorimit mos të shndërrohet në fushë të krimin. Ju faleminderit z. Kryetar!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit doktor! Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, diskutuesi i fundit.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI -Ju faleminderit kryetar i Kuvendit! Të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë – Po diskutojmë për një fushë tepër të rëndësishme të shoqërisë e që unë konsideroj se vërtet duhet me seriozitetin më të madh t'i qasemi, ashtu siç edhe po bëjmë përpjekje edhe ne këtu në Kuvend, natyrisht edhe në Qeverinë e Kosovës sipas obligimeve, kompetencave të marra. Që në fillim them se ministri Shatri me kënaqësi do t'i përgjigjej ftesës së Kuvendit për të qenë sot këtu, mirëpo ai është në udhëtim zyrtar që disa ditë dhe mendoj se do të ketë rastin përsëri që të ballafaqohemi bashkërisht me këtë çështje, prandaj mungesa e tij është e arsyeshme për shkak të udhëtimit zyrtar.

Unë do të bëjë përpjekje e jo për të dhënë përgjigje për interesimet e kolegëve ,sepse e ndajmë të njëjtin shqetësim edhe si deputet i Kuvendit të Kosovës, por për të bërë një përpjekje për të dalë nga gjendja me disa rekomandime , ndoshta do të na ndihmonin si Qeveri dhe si Parlament dhe të përmirësojmë në përgjithësi gjendjen në shëndetësinë e Kosovës. Rekomandimet e bëra nga Komisioni për Shëndetësi vërtet janë të qëlluara dhe nëse hyjmë në detaje dhe shohim se cila do të ishte mundësi që menjëherë të implementoheshin , del se një numër i madh i tyre mund të implementohen, sepse nuk ka

implikime financiare të caktuara dhe të theksuara shumë, vetëm nevojitet një angazhim, një zhuritet i Ministrisë së Shëndetësisë për të nxjerrë udhëzimet e caktuara administrative të cilat do ta rregullonin këtë fushë bazuar në Ligjin për shëndetësi dhe në ligjet e tjera që e rregullojnë në përgjithësi sektorin e shëndetësisë. Mirëpo, kemi disa rekomandime se nëse hyjmë thellësisht shihet se kanë implikime të caktuara buxhetore të cilat tani për tani në bazë të Kornizës buxhetore janë vështirë për t'u implementuar. Mirëpo nuk do të thotë se nuk duhet bërë përpjekje në këtë drejtim që vërtet të gjenden mundësi në kuadër të angazhimeve të përbashkëta që kjo të bëhet. Të gjitha urdhëresat, ose të gjitha ligjet që e rregullojnë fushën e menaxhimit të financave publike në përgjithësi janë bazuara në ligje, pra edhe në Ligjin mbi menaxhimin e financave publike i cili natyrisht në gjendjen në të cilën është tash siç është, nuk lejon mundësinë e krijimit të fondeve të caktuara. Kërkesa për themelimin e fondeve nuk është vetëm për shëndetësi, mirëpo kemi kërkesa edhe për themelimin e fondeve për rrugët. Bic fjala, fondet për bujqësi dhe fondeve të tjera të cilat sigurisht se nga natyra e çdonjërit prej tyre e kanë rëndësinë e vet. Mirëpo, ligji për sigurimet shëndetësore ka një kosto financiare e cila kosto, po them sipas parametrave buxhetore që janë ndërtuar, që i kemi miratuar vet në vitin e kaluar në buxhetin për vitin 2006 e tani jemi në prag që të kemi buxhetin për vitin 2007. Në Parlament vështirë do të ketë mundësi që të implementohet në tërësi. Megjithatë unë e them një propozim që ndoshta do të na ndihmonte të gjithë neve bashkërisht. Ka gatishmëri në këtë drejtim që të shihet mundësia e formimit të fondit, ndoshta me një bashkëbisedim brenda institucioneve të Kosovës, Kuvendit të Kosovës, ministrive përkatëse, Ministrisë për Shëndetësi dhe Ministrisë për Ekonomi dhe Financa. Natyrisht, duke respektuar procedurat dhe ligjet në fuqi, pra edhe me kërkesën për amendamentimet e ndryshme qoftë të Ligjit për menaxhimin e financave publike që tani është në amendamentim e sipër dhe së shpejti do ta kemi në Kuvendin e Kosovës qoftë edhe të urdhëresat të ndryshme, udhëzime administrative të cilat e kanë një procedurë të miratimit që prej Qeverisë së Kosovës nëpërmes të Këshillit Ekonomik fiskal pra deri te Përfaqësuesi Special si autoritet përfundimtar i cili i nënshkruan unë do të thosha të gjitha rregulloret që rregullojnë të gjitha fushat e administrimit civil në përgjithësi në Kosovë. Unë do të kisha një sugjerim të këtillë një rekomandim që në ditët në vijim të kemi një angazhim të përbashkët dhe një grup i përbashkët punues për të parë se çka në të vërtetë nuk do të hyjë në detaje se çka mund të ndryshohet, qoftë në kuptim të tarifave ose normave të ndryshme doganore fiskale etj., por natyrisht duke pasur parasysh gjithmonë ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare dhe buxhetore të vendit, dhe të Buxhetit të konsoliduar të Kosovës, i cili i atillë çfarë është bënë përpjekje që të financojë veprimtarinë e rregullore të institucioneve publike në Kosovë.

Një grup i këtillë punues do të thosha që do të merret me këto çështje dhe do të bënte rekomandime edhe për Qeverinë e Kosovës, pastaj edhe për Këshillin ekonomik fiskal, mendoj se do të mundë të bëjë edhe profesionistët do të nxirreshin analiza të caktuara që do të çonin procedurat e mëtejme. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave do ta kryejë obligimin e vet nga këndi i vet, për sa i përket në kuadër të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe të ligjeve tjera që e rregullojnë përgjegjësinë me menaxhimin e buxhetit publik në Kosovë. Ju faleminderit z. Kryetar!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Doktor Fehmi Vula e ka fjalën

DEPUTETI FEHMI VULA - Nuk desha të bëjë replikë me Ramadan Kelmendin për Mitrovicën fatkeqe, por desha vetëm ta jap një shpjegim: Na kemi qenë në Mitrovicë, i kemi vizituar të gjitha njësitë, jemi njoftuar për të gjitha të arriturat dhe kemi konstatuar se njësia ma aktive në gjithë shëndetësinë e Mitrovicës së Jugut është parku i makinave dhe vozitësit, të cilët duhet 30 herë në ditë me ardhë në Prishtinë. Natyrisht aty u njoftuam edhe për disa gjëra të tjera, sa para merr spitali i cili gjendet në Veri të Mitrovicës nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe çka u ngjanë punëtorëve shëndetësorë, të cilët pas luftës kanë vazhduar të shkojnë në vendet e tyre të punës. Ne nuk patëm fatin me e vizitue për arsye se na u tha: Kërkesë për vizitë spitalit në pjesën Veriore duhet bërë UNMIK-ut - e UNMIK-u t'ia bëjë kërkesën KFOR-it - KFOR-i t'ia bëjë drejtorisë së spitalit e ata ta pranojnë Komisionin e një institucioni më të lartë të cilin nuk e pranojnë, prandaj na vjen shumë keq, por këtë nuk mundem ta realizojë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. Agani

DEPUTETI FEHMI AGANI - Ju faleminderit z. kryetar, vetëm një koment në deklarimin e para disa minutave të kolegut Pireva nga Lidhja Demokratike në lidhje me atë që nuk çon peshë shumë se a emërohet një udhëheqës i institucionit më të lartë shëndetësor në Kosovë me konkurs apo pa konkurs, a shkelet ligji me këtë rast apo jo? Nuk është shumë e rëndësishme, gjendja është shumë e rëndë dhe kjo arsyeton mjetin. Mendoj se jemi në një moment kur jemi duke e ndërtuar shtetin e Kosovës, dëshirojmë ta ndërrojmë shtetin e Kosovës mbi bazat e ligjshmërisë dhe në qoftë se ne mendojmë se mund ta ndërrojmë shtetin e Kosovës duke e shkelur ligjin dhe në këtë mënyrë t'i arsyetojmë veprimet tona, atëherë unë mendoj se po shkojmë në një anarki dhe mendoj se kjo nuk është dëshira e askujt. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka ministri Sadik Idrizi

DEPUTETI ILAZ PIREVA - REPLIKË

Z. Agani jo pse jam unë për anarki dhe për shkelje besa jam prej atyre që kërkoj rendin, ligjin dhe konkursin. Mirëpo unë e thashë në kontest të gjendjes tejet serioze dhe tejet të rëndë për me mujt me e kapërcye, për mua nganjëherë janë disa të tjera që peshojnë më tepër sesa zvarritjet në emër të Ligjit ,apo të konkursit apo kë kësaj? Andaj ishte ajo që po them, unë ndoshta isha edhe pak me emocione ,sepse vij nga një qendre ku, që pjesë e asaj qendre je edhe ti vet, prandaj unë besoj se kemi forcë nga një here edhe në këtë mënyrë për t'i përballuar problemet të cilat janë tejet të rënda. Ju faleminderit! Urdhëroni z. ministër!

MINISTRI SADIK IDRIZI - Hvala predsedniče! Želim da se zahvalim Komisiji koja je uradila jedan doabar zatatak i posao i dala preporuke koje u navječem delu su na mjesu mada su neke od preporuke u medjuvremenu realizirane, ja ću kasnije kazati odprilike koje su. Mislim da je ovaj Parlament i kada je bila inetrpelacija rekao sam da ima mogućnosti gde može Parlament da utiče na Vladu posebno u nekim segmentima. U fazi je usvajanje budžeta koji će doći u Parlament verovatno ste dobili materijal i gde su stavke za zdravstvo u ovoj godini povećane od prilike za 2 miliona, 2 miliona i nešto u

koju ulazi jedan dug u koji je još od 2000 godine i na vamo. Takođe ovaj Parlament može zaista jer ja to nisam mogao ni na Vladi da se usvoji Zaion o zdravstvenom osiguranju koji predviđa formiranje fonda. I preporuka koja je data pod tom zakonu da treba fond da bude, da počne da radi od 1. 01. 2005. godine, je zaista nemoguća bila i onda, jer je ova Vlada počela da radi 8. decembra 2004. godine, Zakon nije bio usvojen a fond mora da bude, znači ovaj uspostavljen preko Zakona. I kada je Zakon procesuiran i kada je došao ovde na drugo čitanje zaustavljen je zbog toga što nije bilo moguće formiranje fonda. Da je zakon bio usvojen i u Vladi u 2004. godini, u samom zakonu stoji da poslovi na formiranju fonda da traju odprilike godinu dana, da donese statut i osala podzakonska akta, jer on ne može da funkcioniše bez infrastrukture i tako dalje. Mi smo kao ministarstvo za 2005. godinu, odvojili sredstva u budžetu od 360.000 € znači za početak infastrukture za formiranje fonda, i fond je zaustavljen u početku zbog drugih problema, bio je problem odnosno zakon, bio je problem porodiljstvo, odnosno nije za to što je 6 miliona bilo potrebno a kasnije i Zakon o menadžiranju javnim finansijama koji nije dozvoljavao formiranje fonda, međutim čujemo i danas od zamenika ministra da postoje određene mogućnosti da se to usvoji. Bez fonda zdravstveni sistem ne može da funkcioniše. Problem je u farmaceuti, u drugim oblastima su isključivo vezani zbog nepostojenja fonda. Ne može Ministarstvo da se bavi nabavkom lijekova ili da ima tender unutar aministrarstva ili prokurim, to mora da radi fond, on će ugovarati, on će vršiti ostale stvari.

Mislim da ovaj Izveštaj treba dostaviti ukoliko se usvoji Vladi sa određenim rokovima i zadacima i da Vlada i Ministarstvo Skupštini povratno daje informaciju od prilike koje će stvari uraditi u kom roku, jer nije samo Ministarstvo zdrvtva, jeste menadžiranje odnosno monitorisanje Zakonom o zdravstvu, ali je puno stvari koje su vezani za druga ministarstva. Ja moram napomenuti da jedan dobar deo znači vezan za Ministarstvu o financijama takođe ima stvari koje su upućuju na Ministarstvo obrazovanja, ČKUK nije statut realiziran zato što je onaj deo koji se odnosi na Ministarstvo obrazovanja prošle godine, zbog promene na Universitetu došlo je do kašnjenja i donošenja statuta u ovoj ustanovi. Takođe postoje stvari koje su vezane sa Ministarstvom za rad i socialnu politiku kada su u pitanju određene kategorije ljudi koji su oslobođeni i participacije i još nekih drugih stvari.

Nekoliko zakonskih akata koji su atrebali biti doneti u medjuvremenu i koji se pominju ovde kao preporuke, nama je sugerisano da to više ne pripada nama jer su formirana nova ministarstva, imamo Zakon o sudskoj medicini koji smo uradili kao draft nacrt i rečeno da taj Zakon po sudskoj medicini koji smo uradili kao draft i nacrt i rečeno da taj Zakon ne pripada nama nego to mora da bude u Ministarstvu pravde, takođe Zakon o vanrednim situacijama odnosno delovanju vanrednim situacijama ne pripada nama mada smo uradili draft, nego je rečeno da će to preći u Departament u Ministarstvu sada unutrašnjih poslova da će oni taj Zakon doneti a onaj deo koji se odnosi na zdravstvo da ćemo mi učestovati u tome, znači postoje određeni zakoni koji nisu upućeni nama, odnosno koji su izvan nas.

Najznačajniji problemi koji se ovde pominjaju, jesu problemi farmaceutik. Ja moram da kažem da je u toj oblasti, znači koji menadžiramo direktno iz Ministarstva u 2003. godini, bilo je izdvojeno 13, 5 miliona €, da je ove godine 2006. 6,9 miliona € i 2003. godine, i 2006. godine, samo za usluge preko KFK za deponiranje i ostale stvari izdvajali su oko 100. hiljada mjesečno, znači to je ugovor koji je zatečen. Ugovor je bio potpisan 2. septembra 2004. godine, na roku od 2 godine sa mogućnosti da se produži na godinu dana. Mi smo taj ugovor produžili samo do nove godine i u ovoj fazi

smo formirali i Komisiju koja radi na tome da daje, da iznadje alternativni plan, formirali smo i Komisiju koja radi na redukciji esencijalne liste. Esencijalna lista koja je kod nas ne može ni naj bogatije zemlje ne mogu da je pokriju i bog toga što ima, znači nema povratnih informacija posebno u primarnom zdravstvu. Mi ćemo izaći u najskorije znači sa budžetom koji imamo za 2007. godinu, ukoliko tako prodje od 9 miliona € za lijekove mi ćemo 4 kategorije znači: emergenciju, operacione sale, hemodializu i solinu obezbediti, ostalu esencijalnu listu ćemo napraviti spisak. Objavićemo spisak u novinama ovo može Ministarstvo da pokrije i obezbedjuje, ne možemo mi tražiti usluge. Takodje ćemo izvršiti redukciju onih koji su oslobođeni, ali tu imamo pritisak od kategorija koje su oslobođene, bilo da su to deca, studenti, starije osobe od 65. godina, invalidi rata, invalidi drugih kategorija i tako dalje, da ponekad i 70% populacije je oslobođeno plaćanja participacija i učešća u zdravstvu, znači to su stvari koje su povezane to je taj neki zakon spojenih sudova da ima negativno. Ne govorimo da ima i negativnosti i da ima zloupoteba, da ima ne baš najbolje menadžiranje kod nas u da su potrebe reforme i unutar sektora farmaceutike i unutar drugih sektora, mislim da ćete biti svedoci da ćemo preduzeti jake konkretne mere na tom planu. U nekim izveštajima, u raportima koji je dat ovde u preprukama stoji da mnoge institucije nisu obavestene o tome, nemaju to u zakonima. Mi smo do sada procesuirali 15 zakona od kojih je 8 prošlo, imamo zakone koje po 15 - 16 meseci i čekaju na potpis Specijalnog predstavnika. Doneli smo preko 40, to je za dve godine preko 40 administrativnih uputstava, ja ne govorim da je to dovoljno, ali smo mnogo više doneli nego što su neki drugi i mislim da bi bila dobra praksa, ovaj je početak da i drugi zakoni dodju ovde na red, da se vidi znači koliko su i druga ministarstva i druge oblasti obezbedili određenu zakonsku proceduru. Mi imamo jedan defekt na relaciji centralna vlast, lokalna vlast. Zakon o privatnoj praksi koji je donet i čiji smo implementaciju započeli, mada je ovde preporuka mi smo to započeli i već smo, već je apiciralo preko 600 aplikanata a svakim danom znači Bord radi, već smo izdali priličan broj privatnih licenci. Taj zakon je bio stagnirano u jednom momentu kada nam tri ključne opštine: Priština, Prizren i Podujevo nisu dali članove komisije jer su potrebni članovi komisije da bi se vršilo licenciranje, pa je moralo da se interveniše preko Ministarstva za lokalnu samoupravu da bih dali članove, tek nedavno nam je Priština dala svog člana u komisiji, znači postoji defekti na raznim relacijama pa takodje Ministarstvo za lokalnu samoupravu je, ima sovju ulogu i oko menadžiranja trenutno prema Zakonu primnog zdravstva koje menadžiraju opštine i koji direkto dobijaju sredstva preko granta opštine i mi nemamo, mi imamo samo, možda da ne kažem politiku, međjutim direktno ne utičemo i ne vodimo potpuno monitorisanje jer su odgovorni i direktore tih primarnih medicina, familjarne medicine i ostaloga tih centara biraju se na lokalnom nivou.

I prema programima za decentralizaciju od prilike ide se ka tome da se izvrši decentralizacija. ČKUK je nap naječi problem. Pokušavamo da napravimo decentralizaciju, međjutim kada je u pitanju ne samo ČKUK nego i sve regionalne bolnice, morate imati na umu da najvećim delom sredstava same menadžiraju. Imaju potpunu autonomiju osim lekova sa esencijalne liste budžet direktno dobijaju i direktno menadžiraju.

ČKUK ima 17-18 miliona ove godine u budžetu i on će menadžirati tim sredstvima. Ministarstvo zdravlja ne može menadžirati i nema uticaja na njihovo menadžiranje. Takodje odgovor da neke institucije nisu bile upoznate sa zakonskim aktima, pa mi imamo VEB stranicu na kojima su ne samo mi i Vlada ima VEB stranicu, Ministarstvo

zdravlja na kojoj su svi akti, svi zakoni, svi podzakonski akti objavljeni iako neki lekar ili direktor klinike kaže da nije dobio dokument, on je zaista danas u ovoj fazi kada je svaki zakon dostupan na VEB stranici našeg Ministarstva, medjutim to su ponekad i izgovori da neke stvari nisu radjeni.

Preporuke koje se odnose na banji i banjско lečenje, mi smo tražili da se ne izvrši privatizacija, medjutim AKPM ne dopušta i obe banje i Pećka i ova u Klokotu će biti privatizovane i to više ne može biti naša, opet naš delokrug poslova.

Još jednom zahvaljujem Komisiji koja je napravila ovaj Izveštaj i dala preporuke. Mi ćemo ih ozbiljno uzeti u razmatranje. Mislim da i Vlada treba da se pozabavi ovim preporukama, da se odredi ko šta pripada kojoj oblasti, ja ću izvestiti Parlament, budite ubedjeni u jednom reku šta smo uradili od ovoga ukoliko, znači mi se pruži takva prilika da izvestim Parlament.

Zahvalujem se poslanicima koji su zaista dali svoj doprinos i u današnjoj diskusiji, u diskusiji i bili su i na najvišem zadatku ljudi koji su zainteresovani i zabrinuti za stanje u zdravstvu. Još jednom hvala!

KRYESUESESI – GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit! E ka fjalën deputeti Behxhet Brajshori,

DEPUTETI – BEHXHET – BRAJSHORI - Zoti kryesues vetëm një sqarim të vogël do të doja. Unë thashë në pjesën e parë Ligji mbi menaxhimin e financave publike për momentin është si është, nuk lejon krijimin e fondeve të caktuara. Por e thash se është mirë që, Kuvendi, ministritë përkatëse, Qeveria të ulët, të shohim mundësinë çka mund të bëjë në kuptim të amendamentimit si në të ardhmen të rregullojmë disa fusha si nganjëherë po shihet që ka nevojë të rregullohen.

Ministria e financave do të bëjë angazhimin e vetë në këtë drejtim, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Kuvendin, për të ardhur deri te përfundimi që pastaj do ti rekomandohen Qeverisë, pra edhe Këshillit ekonomik – fiskal dhe mekanizmave tjerë vendimmarrës. Ky është një qartësim për të mos dalë se, d.m.th. kam thënë se ka mundësi fondi të bëhet sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike. M'u duk se ministri pak a shumë kështu e ka kuptuar, prandaj për qartësim jo për diçka tjetër, do ta bëjmë bashkërisht aq sa ka mundësi. Ju faleminderit!

KRYESUESESI – GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit! E ka fjalën deputeti Jakup Krasniqi,

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Zoti kryesues, të nderuar deputet edhe pse Partia Demokratike dhe grupi parlamentar i saj kanë marrë pjesë në hartimin e rekomandimeve të Komisionit dhe sot është paraqitë një diskutues. Duke e mbështetur raportin, ne jemi të vetëdijshëm se gjendja në shëndetësi është e rëndë dhe jo vetëm në shëndetësi, por si grup parlamentar duhet të them se ne do të abstenojmë për faktin se, kur debatohet kjo gjendje shumë e rëndë në shëndetësi, kur shihet qartë se ligji nuk është zbatuar, ka shumë parregullsi, kur përgjegjësinë për këtë e ka edhe Qeveria. Kohë më parë ka bërë një komision ndërqeveritar dhe nuk ka treguar arsyet pse është tërhequr anëtari i Komisionit, pse sot në këtë debat nuk merr pjesë edhe kryeministri, po nëse kryeministri është në udhëtim, pse nuk merr pjesë zëvendëskryeministri dhe ministrat e tjerë që do të duhej të ishin se pazbatueshmëria e ligjit nuk është vetëm në ministri, pazbatueshmëri të ligjit ka

në gjithë Qeverinë e Kosovës, në të gjitha ministrinë e saj. Prandaj ne mendojmë se është koha që të ndërpritet papërgjegjësia e drejtuesve të institucioneve të Kosovës edhe një arsye tjetër është që na bënë vërtetë ne të abstenojmë, konsiderojmë se vota në Parlament po bëhet me anime, ne në seancën e kaluar kemi ofruar dëshmi për parregullsitë e shumta, për dëmet e shumta që ART-ja i ka bërë buxhetit të Kosovës, bordi i ART-së. Ne mendojmë, se këto janë arsye që na detyrojnë të abstenojmë edhe pse po them gjendja në shëndetësi është e rëndë, gjendja në shëndetësi do një qasje tjetër. Kjo qasje duhet të ndryshojë nga i tërë kabineti qeveritar.

Ju faleminderit!

KRYESUESESI – GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit! Nuk ka të lajmëruar më për me e marrë fjalën, konsideroj se debati ka qenë gjithëpërfshirës dhe me këtë e përmbyllë këtë pikë të rendit të ditës. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, është pika e 11. Shqyrtim propozimi i vendimit për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit. Konstatimet hyrëse, Kryesia e Kuvendit pas konsultimeve me kryetarët e grupeve parlamentare, për fjalë u paraqiten tash tre deputet. E ka fjalën deputeti Naim Jerliu.

DEPUTETI NAIM JERLIU - Ju faleminderit zoti kryesues, qëllimi i vënies në diskutim të këtij raporti në seancë plenare ka qenë pikërisht përfundimet dhe rekomandimet që janë nxjerrë nga hulumtimi që është bërë lidhur me zbatimin e Ligjit për shëndetësi. Kërkoj që në përfundim të këtij debati, për raportin të nxirret në votim formal, miratimi i raportit i cili përmban rekomandime për Qeverinë në kuptim të krijimit të mundësive dhe të mbështetjes për Qeverinë që të shtohen përpjekjet për ndryshim të gjendjes në sektorin e shëndetësisë. Prandaj ju ftoj të kërkonti deklaram të Kuvendit në mbështetje të raportit.

KRYESUESESI – GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit!, Propozimi i deputetit është konkret. Mirëpo Rregullorja e punës e parasheh që në fund të diskutimeve propozuesi i projektligjit ose i mocionit përmbajtjesor ka të drejtë të përgjigjet dhe pastaj kryetari i Kuvendit e mbyll diskutimin. Në bazë të kësaj që kërkoi deputeti, hedh në votim formal rekomandimet e Komisionit. Në sallë janë 86 deputetë.

PËR	65
KUNDËR.....	0
ABSTENIM.....	21

Besoj se debati për këtë pikë të rendit të ditës është i përmbyllur. Kalojmë në pikën 11- Shqyrtimi i propozimit të vendimit për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit.

Konstatimet hyrëse, Kryesia e Kuvendit pas konsultimeve me kryetarët e grupeve parlamentare vendosi që Kuvendit t'i paraqesë për miratim propozim vendimin për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit.

Tekst-propozimi u është shpërndarë të gjithë deputetëve nëse ka të interesuar për diskutim le të lajmërohen me e marrë fjalën,

E ka fjalën deputeti Behxhet Brajshori

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Zotëri kryesues, të nderuar kolegë deputetë!

Ne para veti, për një kohë të shkurtër, i kemi dy vendime- që pretendojnë ta rregullojnë këtë fushë, vendimin e 30 majit dhe tash të 9 nëntorit 2006. Kam një propozim që marrja

e vendimit lidhur me këtë çështje të analizohet edhe më shumë dhe të shtyhet për një seancë të ardhshme, të shihet cila është praktika e vendeve të rajonit që rregullojnë këtë fushë dhe të ketë një normë të unifikuar brenda të gjitha institucioneve vetëqeverisëse të vendit. D.m.th edhe në Kuvend, edhe në qeveri të ndryshme, sepse kemi dallime në kuptim të normave të caktuara që rregullojnë këtë fushë. Sekretaria e Kuvendit do të mund të konsultohet, do të thosha edhe me parlamentet e vendeve tjera , edhe me Ministrinë tonë në këtë rast. Në mbledhjen e ardhshme do të kishim nxjerrë një vendim të tillë, i cili do të rregullonte në përafërsisht edhe në mënyrë unike udhëtimet zyrtare jashtë vendit për deputetët e Kuvendit të Kosovës në këtë rast.

Kërkoj nga kolegët të kenë mirëkuptim, sepse ka nevojë për t'i harmonizuar disa çështje brenda vendimit. Ju faleminderit!

KRYESUESESI – GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit! E hedh në votim propozimin e deputetit Brajshori. Kush është për që kjo pikë e rendit të shtyhet për një seancë të ardhshme.

PËR.....	86
KUDNËR.....	2
ABSTENIM.....	0

Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti

DEPUTETI SABRI HAMITI – Zotëri kryesues, kolegë deputetë të nderuar kemi marrë njoftimin që me propozim të Komisionit të Jashtëm Kuvendi i Shqipërisë do ta miratojë një rezolutë, me të cilën mbështet vullnetin politik të popullit të Kosovës, për Kosovën shtet të pavarur. Ne e mirëpresim këtë iniciativë dhe këtë qëndrim të tyre. Jam këtu para jush të ritheksoj që kjo është edhe në vazhden e bashkëpunimeve që kemi pasur me Komisionin homolog të Shqipërisë, një bashkëpunim që shpresojmë që do të bëhet edhe më i mirë në të ardhshmen

Ju faleminderit!

KRYESUESESI – GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit!

Konstatohet se seanca ka përfunduar. Kam edhe një informim, prej orës 13.00 deputetët mund t'i marrin lap-topët.